

Imigracioni:
si, ku, kur

*Udhëzues
për integrimin*



Ministero del Lavoro,
della Salute e delle Politiche Sociali

Udhëzuesi **Imigracioni: ku, si, kur** është realizuar nga
Ministria e Punës e Shëndetsisë dhe e Politikave Sociale – Drejtoria e
Përgjithshme e Imigracionit, në bashkëpunim me:



*Istituto Psicoanalitico
per le Ricerche Sociali*

Botimi i tretë i azhornuar në shtator 2009

Ky publikim është disponibël në internet në sitin
www.lavoro.gov.it

Ministria e Punës e Shëndetsisë dhe e Politikave Sociale – Drejtoria e Përgjithshme e Imigracionit nuk mban përgjegjësi në rast pasaktësish në përkthimin nga origjinali.



Mirëseerdhët Mirëseerdhët në Itali! në Itali!

Për të jetuar mirë dhe për t'u integruar në shoqërinë italiane, është e rëndësishme të njohësh rregullat dhe organizimin e jetës së saj.

Ky udhëzues është i vlefshëm si për personat që akoma nuk kanë ardhur në Itali dhe duhet të kuptojnë si mund të hyjnë në mënyrë të rregullt, ashtu edhe për ata që ndodhen në territorin italian. Por edhe punëdhënësit, italianë dhe të huaj mund të gjejnë këtu të dhënat e nevojshme për të ndihmuar punonjësën në rrugën e tij të integrit.

Është një udhëzues që mund të të ndihmojë edhe në zgjidhjen e problemeve të përditshme: nga kontrata e punës tek regjistrimi i femijëve në shkollë, nga njohja e patentës tek hapja e një llogarie bankare.

I mbështetur nga Ministria Punës, e Shëndetsisë dhe e Politikave Sociale, ky udhëzues është një mjet i nevojshëm, praktik, dhe i plotë, të cilin mund ta konsultosh në 8 gjuhë të ndryshme.

Lexim të këndshëm!



Përmbledhje

KUSHTETUTA E REPUBLIKËS ITALIANE *Art. 1-54* 9

HYRJA NË ITALI 25

Kufiri 27

Vizat 27

QËNDRIMI NË ITALI 37

Lejeqëndrimet (Permessi di soggiorno) 39

Lejeqëndrimi BE për banorët me afat të gjatë 46

Nënshtetësia italjane 49

Zona Schengen 50

PUNA 53

Puna në Itali 55

Punë e varur 55

Punë pjesërisht e varur (p.sh kontratë me projekt) 62

Punë e pavarur 62

Hyrja në tregun e punës në Itali 64

Fillimi i një raporti pune 71

Shërbimet për punësim 74

SISTEMI I PËRKRAHJES SHOQËRORE DHE I SIGURIMEVE 81

INPS dhe INAIL 83

Sistemi i përkrahjes shoqërore (INPS) 84

Sistemi i sigurimeve (INAIL) 90

ZYRA E GJENDJES CIVILE 97

Informacione të përgjithshme 99

Rregjistrimi 101

Shërbimet e gjendjes civile 103



STREHIMI	117
Garancia e vendbanimit	109
Qeraja e banesës	110
Blerja e banesës	112
Qëndrat e pritjes (centri di accoglienza)	114
SHËNDETËSIA	117
Rregjistrimi në Shërbimin Shëndetësor Kombëtar (SSN)	119
Libreza shëndetësore	121
Shërbimet shëndetësore	122
I huaj përkohësisht në territorin italian (STP)	128
ARSIMI	129
Shkollimi dhe formimi: e drejtë dhe detyrim	131
Çerdhja	131
Kopshti	132
Cikli i parë	132
Cikli i dytë	133
Universiteti	135
Shkollimi dhe formimi teknik i lartë	137
Njohja titujve të studimeve	138
Njohja e titujve profesionalë	139
MBROJTJA E TE DREJTAVE DHE DISKRIMINIMI	141
TUTELIMI I TË DREJTAVE	143
DISKRIMINIMI	144
DEKLARATA E TË ARDHURAVE	147
Informacione të përgjithshme	149
KUDI	149
Modeli 730	150
Modeli Unik	152
Modeli 770	154
Red, ICI, ISEE	154



BANKA	157
Shërbimet bankare	159
<hr/>	
SHËRBIME TË TJERA	163
Parathënie	165
Kodi fiskal	165
Drejtimi dhe makinat	166
<hr/>	
SHOQATAT	169
E drejta për t'u bashkuar në një shoqatë	171
Si të themelosh një shoqatë	171
Disa lloje shoqatash	174



KUSHTETUTA E REPUBLIKËS ITALIANE

(Artt. 1-54)



KRYETARI I PËRKOHSHËM I SHTETIT

Duke konsideruar vendimin e Asemblesë Kushtetuese që në mbledhjen e 22 dhjetorit 1947 aprovoi Kushtetutën e Republikës Italiane;
Duke konsideruar vendimin e XVIII përfundimtar të Kushtetutës

FIRMOS

Kushtetutën e Republikës Italiane me tekstin e mëposhtëm:

PARIMET THEMELORE

Neni 1

Italia është Republikë demokratike e bazuar në punën. Sovraniteti i takon popullit, që e ushtron në formën dhe brenda kufijve të Kushtetutës.

Neni 2

Republika njeh dhe garanton të drejtat e padhunueshme të njeriut, qoftë si individ, qoftë në grupime sociale ku zhvillohet personaliteti i tij dhe kërkon përmbushjen e detyrave të domosdoshme të solidaritetit politik, ekonomik dhe social.

Neni 3

Të gjithë qytetarët kanë të njëjtin dinjitet social dhe janë të barabartë para ligjit, pa dallim race, gjuhe, feje, opinioni publik, të kushteve personale e sociale. Është detyrë e Republikës të shmangë pengesat e tipit ekonomik dhe social, që, duke kufizuar në fakt lirinë dhe barazinë e qytetarëve, pengojnë zhvillimin e plotë të njeriut dhe pjesmarrjen efektive të të gjithë punonjësve në organizimet politike, ekonomike e sociale të vendit.



Neni 4

Republika i njeh të gjithë qytetarëve të drejtën për punë dhe krijon kushtet që bëjnë efektive këtë të drejtë. Çdo qytetar ka detyrë të kryejë, sipas mundësive dhe zgjedhjes personale, një aktivitet ose një funksion që ndihmon në progresin material ose shpirtëror të shoqërisë.

Neni 5

Republika, një dhe e pandashme, njeh dhe inkurajon autonomitë lokale; zbaton në shërbimet që varen nga Shteti, decentralizimin më të gjërë ekonomik; ia përshtat parimet dhe metodat e legjislacionit të tij, kërkesave të autonomisë dhe të decentralizimit.

Neni 6

Republika tutelon me norma të veçanta pakicat gjuhësore.

Neni 7

Shteti dhe Kisha katolike, secili në urdhërin e vet, janë të pavarur dhe sovranë. Raportet midis tyre rregullohen nga Paktet Lateranense. Modifikimet e Pakteve, të pranuar nga të dyja palët, nuk kërkojnë një procedurë të rishtimit të Kushtetutës.

Neni 8

Të gjithë besimet fetare janë njëlloj të lira para ligjit. Besimet fetare, të ndryshme nga ajo katolike, kanë të drejtë të organizohen sipas statuteve të tyre, me kusht që të mos jenë në kundërshtim me Sistemin juridik italian. Raportet e tyre me shtetin janë të vendosura me ligj në bazë të marrëveshjeve të bëra me përfaqësitë përkatëse.



Neni 9

Republika inkurajon zhvillimin e kulturës dhe të punës kërkimore shkencore e teknike. Tutelon ambjentin dhe pasurinë historike e artistike të Kombit.

Neni 10

Sistemi juridik italian i përmbahet normave të së drejtës ndërkombëtare të aprovuara në linja të përgjithshme. Pozita juridike e të huajve është vendosur nga ligji, në përputhje me normat dhe traktatet internacionale. I huaji, të cilit i është ndaluar të ushtrojë në vëndin e tij liritë demokratike të garantuara nga Kushtetuta italiane, ka të drejtën e azilit në territorin e Republikës, sipas kushteve të përcaktuara nga ligji. Nuk lejohet ekstradimi i të huajve për krime politike.

Neni 11

Italia mohon luftën si një instrument të fyerjes së ushtrimit të lirisë të popujve të tjerë dhe si mjet të zgjidhjes së mosmarrëveshjeve internacionale; lejon, në kushte barazie me Shtetet e tjera, duke ju përmbajtur kufizimeve të sovranitetit të nevojshme për një sistem që siguron paqen dhe drejtësinë midis Kombeve; inkurajon dhe favorizon organizatat ndërkombëtare që kanë këtë qëllim.

Neni 12

Flamuri i Republikës është trengjyrëshi italian: jeshil, i bardhë dhe i kuq, me tre rripa vertikale me përmasa të barabarta.



PJESA E PARË

TË DREJTAT DHE DETYRAT E QYTETARËVE

TITULLI I

Marëdhëniet civile

Neni 13

Liria personale është e padhunueshme. Nuk është e lejueshme asnjë formë e burgimit, e inspektimit apo e kontrollit personal, dhe asnjë formë e kufizimit të lirisë personale, me përjashtim të akteve të motivuara nga autoritetet gjyqësore dhe vetëm në rastet dhe mënyrat e parashikuara nga ligji.

Në raste të veçanta të nevojës dhe të urgjencës, të parashikuara në mënyrë rigorose nga ligji, autoriteti i sigurimit publik mund të aprovojë vendime të përkohëshme, që duhet t'i komunikohen brenda dyzet e tetë orëve autoriteteve gjyqësore dhe, në qoftë se ky nuk i miraton brenda 48 orëve në vazhdim, konsiderohen të anuluar dhe mbesin pa asnjë efekt. Ndëshkohet çdo dhunë fizike e morale mbi personat që i nënshtrohen heqjes së lirisë. Ligji përcakton kufijtë maksimalë të burgimit paraprak.

Neni 14

Banesa është e padhunueshme. Nuk mund të kryhen inspektime, kontrole apo sekuestrime, me përjashtim të rasteve dhe të mënyrave të parashikuara për tutelën dhe lirinë personale. Kontrollat dhe inspektimet për motive shëndetësore dhe të sigurisë shoqërore ose me qëllime ekonomike dhe fiskale, janë të drejtuara nga ligje speciale.

Neni 15

Liria dhe fshehtësia e letërkëmbimeve dhe e çdo forme tjetër të komunikimit janë të padhunueshme. Kufizimi i tyre mund të ndodhë vetëm nëpërmjet një akti të motivuar të autoriteteve gjyqësore me garancitë e përcaktuara nga ligji.



Neni 16

Çdo qytetar mund të qarkullojë dhe të banojë lirisht në çdo pjesë të territorit kombëtar, me përjashtim të kufizimeve që ligji përcakton në vija të përgjithshme për motive shëndetësore ose të sigurisë. Asnjë kufizim nuk mund të përcaktohet nga arësye politike. Çdo qytetar është i lirë të dalë nga territori i Republikës dhe të rihyjë, në përputhje me detyrimet e ligjit.

Neni 17

Qytetarët kanë të drejtë të bashkohen në mënyrë paqësore dhe pa armë. Për mbledhjet, edhe në vende të hapura publike, nuk kërkohet paralajmërim. Për mbledhjet në vende publike duhet të paralajmërohen autoritetet, që mund t'i ndalojnë vetëm për motive të justifikuara të sigurisë shoqërore.

Neni 18

Qytetarët kanë të drejtë të organizohen lirisht, pa autorizim, për qëllime që nuk u ndalohen personave nga ligji penal. Janë të ndaluara shoqatat sekrete dhe ato që ndjekin, edhe indirekt, qëllime politike nëpërmjet organizimeve të karakterit ushtarak.

Neni 19

Të gjithë kanë të drejtë të shpallin lirisht besimin e vet fetar në çdo formë, personale apo të organizuar, të bëjnë propagandë dhe të ushtrojnë privatisht apo në publik besimin, me kusht që të mos jenë rite në kundërshtim me moralin qytetar.



Neni 20

Karakteri ekleziastik dhe qëllimi fetar apo besimtar i një shoqate apo institucioni, nuk mund të jenë shkaku i kufizimeve speciale ligjësore, dhe as i tatimeve speciale fiskale për kostituimin e tij, kapacitetin juridik dhe për çdo formë aktiviteti.

Neni 21

Të gjithë kanë të drejtë të shprehin lirisht mendimin personal me fjalë, me shkrim apo me çdo mjet tjetër të komunikimit. Shtypi nuk mund të jetë objekt i autorizimeve apo i çensurimeve. Mund të ndërmerret sekuestrimi vetëm për aktet e motivuara nga autoritetet gjyqësore në raste krimesh, për të cilët ligji mbi shtypin shprehet në mënyrë të veçantë, ose në raste të shkeljes së normave për të cilat vetë ligji parashikonte identifikimin e përgjegjësve. Në këto raste, kur ekziston urgjenza absolute dhe nuk është e mundur ndërhyrja e shpejtë e autoritetit gjyqësor, sekuestrimi i shtypit periodik mund të kryhet nga oficerë të policisë gjyqësore, që duhet menjëherë, dhe asnjëherë pas 24 orësh, të denoncojnë autoritetet gjyqësore. N.q.s. kjo nuk e miraton në 24 orët në vazhdim, sekuestrimi konsiderohet i shfuqizuar dhe pa asnjë efekt. Ligji mund të përcaktojë, me norma të karakterit të përgjithshëm, që të bëhen të ditur të gjitha mjetet e financimit të shtypit periodik. Janë të ndaluara publikimet në shtyp, shfaqjet dhe të gjitha manifestimet të tjera në kundërshtim me moralin. Ligji përcakton vendime të përshtatshme për të parashikuar dhe shtypur shkeljet.

Neni 22

Askujt nuk mund t'i mohohet për motive politike, të aftësisë juridike apo të shtetësisë, emri.



Neni 23

Asnjë veprim personal apo mbi pasurinë nuk mund të imponohet, n.q.s. nuk është në përputhje me ligjin.

Neni 24

Të gjithë mund të veprojnë me vetëdije për të tuteluar të drejtat dhe interesat e veta dhe të drejtat e ligjshme. Mbrojtja është e drejtë e padhunueshme në çdo stad dhe gradë të procedurave. I sigurohen të varfërve me vendime të posaçme, mjetet për të vepruar dhe për t'u mbrojtur përpara çdo juridiksioni. Ligji përcakton kushtet dhe mënyrat për korrigjimin e gabimeve gjyqësore.

Neni 25

Askush nuk mund të privohet nga gjykatësi natyral i përcaktuar me ligj. Askush nuk mund të ndëshkohet në mungesë të një ligji që ka hyrë në fuqi përpara fajit të kryer. Askush nuk mund t'i nënshtrohet masave të sigurisë, vetëm në rastet e parashikuara nga ligji.

Neni 26

Ekstradimi i qytetarëve mund të lejohet vetëm kur është parashikuar shprehimisht nga konventat ndërkombëtare. Nuk mundet në asnjë rast të aplikohet për faje politike.

Neni 27

Përgjegjësia penale është personale. I padituri nuk konsiderohet fajtor deri në dënimin përfundimtar.

Dënimet nuk mund të konsistojnë në trajtime në kundërshtim me sensin njerëzor dhe duhet të tentojnë riedukimin e të dënuarit. Nuk është i lejuar dënimi me vdekje, me përjashtim të rasteve të parashikuara nga ligjet ushtarake të luftës.



Neni 28

Funksionarët dhe nëpunësit e shtetit dhe të enteve publike janë direkt të përgjegjshëm, sipas ligjeve penale, civile dhe administrative, të akteve të kryera në shkelje të të drejtave. Në të tilla raste, përgjegjësia civile shtrihet edhe ndaj shtetit dhe enteve publike.

TITULLI II

Marrëdhëniet Etike – Sociale

Neni 29

Republika njeh të drejtat e familjes si shoqëri e natyrshme e bazuar në martesën. Martesa është e vendosur mbi barazinë morale dhe juridike të bashkëshortëve, me kufij të përcaktuar nga ligji për të garantuar unitetin familjar.

Neni 30

Është detyrë dhe e drejtë e prindërve të mbajnë, arsimojnë dhe edukojnë fëmijët, edhe n.q.s. kanë lindur jasht martesës. Në rast të paaftësisë së prindërve, ligji parashikon që të përmbushen detyrat e tyre. Ligji i siguron fëmijëve të lindur jasht martese çdo tutelë juridike dhe sociale, në përputhje me të drejtat e familjes së ligjshme. Ligji dikton normat dhe kufijtë për të kërkuar atësinë.

Neni 31

Republika lehtëson me masa ekonomike dhe me ndihma të tjera formimin e familjes dhe përmbushjen e detyrave respektive, me përparësi të veçantë familjeve me shumë pjesëtarë. Ruan mëmësinë, fëmijërinë dhe rininë, duke favorizuar institutet e nevojshme për këtë qëllim.



Neni 32

Republika tutelon shëndetin si e drejtë themelore e individit dhe e interesit të kolektivit dhe u garanton kura falas të varfërve. Askush nuk mund të detyrohet të kryejë një trajtim të përcaktuar shëndetësor, me përjashtim të vendimeve me ligj. Ligji nuk mundet në asnjë rast të shkelë kufizimet e imponuara të respektit të personit.

Neni 33

Arti dhe shkenca janë të lira dhe e lirë është mësimdhënia. Republika diktton norma të përgjithshme mbi arësimin dhe krijon shkolla shtetërore për të gjitha urdhërat dhe nivelet. Entet private kanë të drejtë të krijojnë shkolla dhe institute arësimi, pa detyrime për shtetin. Ligji, duke fiksuar të drejtat dhe detyrimet për shkollat jo shtetërore që kërkojnë barazi, duhet t'u sigurojë atyre liri të plotë dhe nxënësve të tyre një trajtim shkollor të barabartë me ato të nxënësve të shkollave shtetërore. Është parashikuar një provim Shteti për pranimin në urdhërat dhe nivelet e ndryshme të shkollave ose për përfundimin e tyre dhe për aftësimin për ushtrimin e profesionit. Institucionet e kulturës së lartë, universitetet dhe akademitë, kanë të drejtë të kenë një rregullore autonome brënda kufijve të përcaktuara nga ligjet e Shtetit.



Neni 34

Shkolla është e hapur për të gjithë. Shkolla fillore, e përbërë nga të paktën 8 vjet, është e detyrueshme dhe falas. Të aftët dhe ata që e meritojnë, edhe pse pa mjete ekonomike, kanë të drejtë të arrijnë nivelet më të larta të studimit. Republika e bën të mundur këtë të drejtë me bursa studimi, çek familjeve dhe ndihma të tjera që duhet të jepen me konkurim.

TITULLI III

Marëdhëniet Ekonomike

Neni 35

Republika tutelon punën në të gjitha format dhe aplikimet e saj. Përkujdeset për përgatitjen dhe ngritjen profesionale të punonjësve. Nxiti dhe favorizon akordet dhe organizmat ndërkombëtare që kanë për qëllim të shpallin dhe të hartojnë të drejtat e punës. Një të drejtën e emigrimit, me përjashtim të detyrimeve të përcaktuara nga ligji në interesin e përgjithshëm dhe mbron punën e italianëve jasht shtetit.

Neni 36

Punonjësi ka të drejtë për një pagesë në proporcion me sasinë dhe cilësinë e punës së tij dhe, në çdo rast, të mjaftueshme për të siguruar për vetveten dhe për familjen një ekzistencë të lirë dhe dinjitoze. Zgjatja maksimale e ditës së punës është e përcaktuar me ligj. Punonjësi ka të drejtën e pushimit javor dhe vjetor të paguar, dhe nuk mund të heqë dorë.



Neni 37

Gruaja punonjëse ka të njejtat të drejta dhe për punë të barabartë, të njejtën pagesë që i takojnë punonjësve. Kushtet e punës duhet të lejojnë përmbushjen e funksionit të saj kryesor në familje dhe t'i sigurojnë nënës dhe fëmijës një mbrojtje speciale të përshtatshme. Ligji përcakton kufijtë minimale të moshës për punën e paguar. Republika tutelon punën e të miturve me norma speciale dhe i garanton atyre, për punë të barabartë, të drejtën për pagesë të barabartë.

Neni 38

Çdo qytetar i paaftë për punë dhe i zhveshur nga mjetet e nevojshme për të jetuar, ka të drejtë për ndihmë dhe mbështetje sociale. Punonjësit kanë të drejtë që t'u jenë parashikuar dhe siguruar mjetet e nevojshme për nevojat e tyre të jetës në rast aksidenti, sëmundjeje, invaliditeti, pleqëri e papunësi e padëshirueshme.

Të paaftët dhe të gjymtuarit kanë të drejtë për arësim dhe futje në punë. Me detyrat e parashikuara në këtë nen, merren organet dhe institutet e ngritura apo të integruara nga shteti. Asistenca private është e lirë.

Neni 39

Organizimi sindakalist është i lirë. Sindakatave nuk mund t'u vihen detyrime të tjera përveç regjistrimit të tyre pranë zyrave lokale ose qendrore, sipas normave të ligjit. Është kusht për regjistrimin që statutet e sindakatave të sanksionojnë një rregull të brendshëm me bazë demokratike. Sindakatat e regjistruara janë person juridik. Mundet që, po të jenë të përfaqësuar bashkërisht në proporcion me të regjistruarit e tyre, të nënshkruajnë kontrata kolektive pune me përfitim të detyrueshëm për të gjithë ata që i përkasin kategorive të cilave i referohet kontrata.



Neni 40

E drejta për grevë ushtrohet brënda ligjeve që e parashikojnë.

Neni 41

Iniciativa ekonomike private është e lirë. Nuk mund të kryhet në kundërshtim me dobishmërinë sociale ose në ndonjë mënyrë që i shkakton dëme sigurisë, lirisë dhe dinjitetit njerëzor. Ligji përcakton programet dhe kontrollet e nevojshme që aktiviteti ekonomik, publik dhe privat të mund të drejtohet dhe të koordinohet për qëllime sociale.

Neni 42

Prona është shoqërore ose private. Të mirat ekonomike i përkasin Shtetit, enteve apo privatëve. Prona private njihet dhe garantohet nga ligji, i cili përcakton mënyrat e blerjes, të shfrytëzimit dhe kufijtë me qëllim që të sigurojë funksionin social dhe për t'ia bërë të lejuar të gjithëve.

Prona private mundet që, në rastet e parashikuara nga ligji, dhe duke u dëmshpërblyer, të shpronësohet për motive të interesit të përgjithshëm. Ligji përcakton normat dhe kufizimet e vazhdimësisë së ligjshme dhe me testament të të drejtave të Shtetit mbi trashëgiminë.

Neni 43

Duke mbajtur parasysh interesin e përgjithshëm, ligji mund të rezervojë në origjinë ose të transferojë, nëpërmjet shpronësimit dhe pasi të jetë dëmshpërblyer, Shtetit, enteve publike ose komuniteteve të punonjësve ose të konsumatorëve, sipërmarrje të përcaktuara ose kategori ndërmarrjesh, që i referohen shërbimeve publike thelbësore ose burimeve të energjisë ose situatave të monopolit dhe që kanë karakter të spikatur për interesin e përgjithshëm.



Neni 44.

Me qëllim që të realizojë një shfrytëzim racional të truallit dhe që të vendosë raporte të barabarta sociale, ligji i imponon detyrime dhe kufizime pronës private mbi tokën, fikson kufijtë e shtrirjes së saj sipas rajoneve dhe zonave bujqësore, nxit dhe imponon bonifikimin e tokave, transformimin e tokave bujqësore dhe rindërtimin e njësive prodhuese; ndihmon pronën e vogël dhe të mesme. Ligji merr vendime në favor të zonave malore.

Neni 45

Republika njeh funksionin social të kooperimit me karakter kreditor dhe pa qëllime të spekulimit privat. Ligji nxit dhe favorizon zgjerimin e tij me mjetet më të përshtatshme dhe siguron, me kontrollin e nevojshme, karakterin dhe qëllimin. Ligji parashikon tutelën dhe zhvillimin e artizanatit.

Neni 46

Me qëllim të zhvillimit ekonomik dhe social të punës dhe në harmoni me kërkesat e prodhimit, Republika i njeh të drejtën punonjësit për të bashkëpunuar me mënyrat dhe kufijtë e përcaktuara nga ligji, në drejtimin e ndërmarrjeve.

Neni 47

Republika inkurajon dhe tutelon kursimin në të gjitha format e tij, disiplinon, koordinon dhe kontrollon ushtrimin e kreditë. Favorizon përdorimin e kursimeve popullore për blerjen e banesës, të pronës direkte me qëllim kultivimi dhe investimi direkt dhe indirekt me aksione në kompanitë dhe mëdha prodhuese të vëndit.



TITULLI IV

Marëdhëniet Politike

Neni 48

Janë zgjedhës të gjithë qytetarët, burra e gra, që kanë mbushur moshën 18 vjeç. Vota është personale dhe e barabartë, e lirë dhe sekrete. Ushtrimi i saj është e drejtë qytetare. Ligji përcakton kushtet dhe mënyrat për ushtrimin e së drejtës së votës për qytetarët që banojnë jasht shtetit dhe siguron efektivitetin. Për këtë qëllim është krijuar një zonë zgjedhore për banorët jasht shtetit për zgjedhjen e Komisioneve Parlamentare, së cilës i janë dhënë një numër vendesh në Parlament të vendosur nga norma kushtetuese e sipas kriterëve të përcaktuara nga ligji. E drejta e votës nuk mund të kufizohet, vetëm për paafësi civile ose për efekt të vendimeve penale të prera ose në rastet e padenjësisë morale të përcaktuara nga ligji.

Neni 49

Të gjithë qytetarët kanë të drejtë të organizohen lirisht në parti për të kontribuar me metoda demokratike në përcaktimin e politikës kombëtare.

Neni 50

Të gjithë qytetarët mund t'i drejtojnë peticion Parlamentit për të kërkuar vendime legjislative ose për të paraqitur nevoja të përbashkëta.

Neni 51

Të gjithë qytetarët, të një gjinie apo një tjetër, mund të raportojnë me zyrat publike dhe me autoritetet e zgjedhura në kushte të barabarta, sipas kërkesave të përcaktuara nga ligji. Ligji mundet që përsa i përket raportimit me zyrat publike apo me autoritetet e zgjedhura të barazojë me qytetarët, italianët të cilët nuk i përkasin Republikës. Ai që thirret në funksionet publike të zgjedhura, ka të drejtë të disponojë të gjithë kohën e nevojshme për



përbushjen e tyre dhe të ruajë vendin e tij të punës.

Neni 52

Mbrojtja e Atdheut është detyrë e shenjtë e qytetarit. Shërbimi ushtarak është i detyrueshëm në kufijtë dhe mënyrat e përcaktuara nga ligji. Përbushja e tyre nuk paragjykon pozitën e punës së qytetarit dhe as ushtrimin e të drejtave politike. Urdhëri i Forcave Ushtarake informohet me shpirtin demokratik të Republikës.

Neni 53

Të gjithë janë të detyruar të kontribuojnë në shpenzimet shoqërore në përpjestim me aftësinë e tyre kontributive. Sistemi i taksave ndërtohet me kritere progresiviteti.

Neni 54

Të gjithë qytetarët kanë për detyrë t'i jenë besnikë Republikës dhe të respektojnë Kushtetutën dhe ligjet. Qytetarët, të cilëve u janë besuar funksione shoqërore, kanë detyrë t'i përbushin me disiplinë dhe ndershmeri, duke u betuar në rastet e parashikuara nga ligji.



hyrja në Itali
hyrja në Itali

Kufiri

Çfarë ndodh në kufirin italian?

Të huajt, në kufi, i nënshtrohen kontrolleve doganore, valutore dhe shëndetësore. Pasi kalon kontrollet, autoritetet doganore vulosin pasaportën ku përcaktohen data dhe vendi i kalimit.

Kush nuk pranohet të hyjë në Itali?

Të huaj të cilët paraqiten në kufi dhe nuk plotësojnë kushtet për hyrje në Itali dëbohen nga policia.

Të huaj të cilët kanë hyrë në Itali pa ju nënshtuar kontrolleve kufitare por janë ndaluar në hyrje ose menjëherë mbas, si edhe ata që janë pranuar përkohësisht në Itali për ndihmë, dëbohen me shoqërim në kufi.

Kush nuk dëbohet në kufi?

Nuk mund të dëbohen të huajt megjithëse nuk kanë dokumenta apo nuk plotësojnë kushtet për të hyrë në Itali të cilët:

- kërkojnë strehim politik;
- gëzojnë statusin e refugjatit;
- janë të mitur nën moshën 18-vjeç, me përjashtim të rasteve kur duhet të ndjekin prindërit ose personin që i shoqëron në rast dëbimi;
- mbrohen përkohësisht për motive humanitare.

Vizat

Çfarë është viza e hyrjes?

Viza është autorizimi i lëshuar nga Konsullata apo nga Përfaqësia Diplomatike kompetente që i lejon të huajt të hyjnë në Hapsirën Shengen apo në territorin italian; vihet në pasaportë apo në një dokument tjetër të barasvlefshëm me të.

Kush ka nevojë për vizë?

Të gjithë qytetarët të cilët konsiderohen të huaj:

- qytetarët e vendeve jokomunitare;
- personat pakombësi apo paatdhe.



Kush nuk ka nevojë për vizë?

Janë të autorizuar të hyjnë në Itali pa patur nevojë për pashaportë apo vizë:

- qytetarët e të gjitha Vendeve të Bashkimit Evropian dhe të hapsirës Ekonomike Evropiane: Austrisë, Belgjikës, Qipros, Danimarkës, Estonisë, Finlandës, Francës, Gjermanisë, Greqisë, Irlandës, Islandës, Italisë, Letonisë, Lituanisë, Lihteshtejnit, Luksemburgut, Maltës, Norvegjisë, Vëndeve të Ulta, Polonisë, Republikës çeke, Portugalisë, Anglisë, Sllovakisë, Sllovenisë, Spanjës, Suedisë, Hungarisë, Rumanisë dhe Bullgarisë;
- qytetarët e San Marinos, Selisë së Shenjtë dhe Svicrës.

Mundet gjithashtu të hyjnë në Itali pa patur nevojë për të kërkuar vizë:

- të huajt që kur dalin nga Italia, kanë me vete përvec pashaportes, lejes së qëndrimit të vlefshme dhe/ose lejen e e qëndrimit BE për banorët me afat të gjatë;
- qytetarët e Vendeve në vijim: Andorës, Argjentinës, Australisë, Brazilit, Bruneit, Kanadasë, Kilit, Koresë së Jugut, Kosta Rikës, Kroacisë, El Salvadorit, Japonisë, Guatemalës, Hondurasit, Izraelit, Malezisë, Meksikës, Monakos, Nikaraguas, Zelandës së Re, Panamasë, Paraguajit, Singaporit, Shteteve të Bashkuara, Uruguajit, Venezuelës, por vetëm në rastet e qëndrimeve me kohë të shkurtër (kohëzgjatja maksimale 90 ditë) për turizëm, mision, biznes, ftesë dhe gara sportive.

Vini re: Për qëndrimin me kohë të gjatë (më shumë se 90 ditë), të gjithë të huajt duhet të pajisen gjithmonë me vizë. Viza e hyrjes nuk është e nevojshme për të huajt që zotërojnë leje qëndrimi BE për banorët me afat të gjatë, të dhënë nga Shteti anëtar i prejardhjes. Viza nuk është gjithashtu e nevojshme në rastet e të huajve që janë titullarë të një leje qëndrimi për studim, të lëshuar nga një Shtet tjetër anëtar (duke përfshirë Anglinë, Irlandën dhe Danimarkën), nëse janë të regjistruar në një kurs universitar ose në një institut studimi superior, që me kushte të caktuara, transferohet në Itali për të vazhduar studimet e filluara në një Shtet tjetër anëtar ose për t'u përfshirë në një program studimi që lidhet me to.

Kujt nuk i jepet viza?

Të huajve që janë dëbuar nga Italia ose nga njëri prej vendeve të Bashkimit Evropian, ose të huajve të cilët përbëjnë kërcënim për rendin publik dhe për sigurinë e Italisë dhe të Vendeve të tjera të Bashkimit Evropian në bazë të marrëveshjeve ndërkombëtare.



Cilat janë motivet për të cilat mund të kërkoj vizë?

Birësim, biznes, kura mjeksore, motive diplomatike, motive familjare, gara sportive, ftesë, punë (e varur, stinore, e pavarur), mision, motive fetare, rihyrje, vendbanim i zgjedhur, bashkim familjar, studim, tranzit, turizëm.

Si duhet të veprojmë për të marrë vizën?

Duhet të paraqesësh kërkesën pranë Konsullatës apo Ambasadës italiane në Vendin tënd të rezidencës. Në kërkesë duhet të përcaktosh:

- të dhënat e tua personale (emri, mbiemri, datëlindja, vendbanimi, shtetësia) dhe ato të familjarëve të tu;
- të dhënat e pasaportës apo të një dokumenti tjetër të barasvlefshëm me të;
- motivin e udhëtimit;
- mjetet e transportit që do të përdorësh;
- vendin ku do të qëndrosh;
- mjetet financiare për udhëtimin dhe qëndrimin.

Vini re: Në rast se paraqet dëshmi apo dokumenta të rreme, ndëshkohesh me përgjegjësi penale si edhe kërkesa jote nuk do të pranohet.

Sa kohë duhet zgjasë praktika e marrjes së vizës?

Viza mund të lëshohet apo të mohohet brenda 90 ditësh nga paraqitja e kërkesës; ndërsa për punë të varur duhen 30 ditë dhe për punë të pavarur 120 ditë.

Çfarë dokumentash duhet të paraqes për të kërkuar vizë?

Për dokumentat që duhet të paraqesësh të bashkëlidhura me kërkesën sipas llojit të vizës mund të konsultosh siton e Ministrisë së Jashtme www.esteri.it/visti, i cili të ofron edhe një model të formularit me të cilin mund të bësh kërkesën për vizë.

Kur duhet të marr vizë për rihyrje?

Viza e rihyrjes lëshohet nga përfaqësia diplomatike apo konsullore italiane në Vendin e origjinës në këto raste:

- kur ke një dokument një lejeqëndrimi apo lejeqëndrimi BE per banoret me afat te gjate, të skaduar prej më shumë se 60 ditësh, me kusht që të para-



qesësh edhe dokumentin e skaduar;

- kur nuk e ke më dokumentin e qëndrimit, sepse e ke humbur apo ta kanë vjedhur, me kusht që paraqesësh kopjen e denoncimit të vjedhjes apo të humbjes.

Çfarë kushtesh duhet të plotësoj për të marr vizën për turizëm?

- Dokumentacion që dëshmon pronësinë e mjeteve financiare të nevojshme për qëndrimin tënd në Itali (kartë kredie, fideiuzione bankare, kontratë sigurimi, etj.);
 - bileta vajtje-ardhje ose prenotim i saj;
 - dokumenti që dëshmon disponueshmërinë e një vendbanimi (prenotim i një hoteli, deklaratë nga dikush që të garanton vendbanimin, etj.);
 - ftesa, e nënshkruar nga një qytetar italian ose i huaj i cili qëndron rregullisht në Itali, dhe që garanton për qëndrimin tënd në Itali.
- Sigurim mjekësor që mbulon shpenzime me vlerë jo më pak se 30.000 euro.

Çfarë kërkesash duhet të plotësoj për të marrë vizën për motive studimi?

- Formular me kërkesën, bashkë me një fotografi;
- pasaportë e vlefshme për të paktën 90 ditë pas skadencës së Vizës, me fotokopje të faqeve me të dhënat personale;
- moshë më të madhe se 14 vjeç (në rast të të miturve ndërmjet 14 dhe 17 vjeç, është e nevojshme një deklaratë e të dy prindërve apo e tutorit të cilët e miratojnë, e përkthyer dhe e legalizuar);
- për kurset e studimit apo të formimit profesional, kërkohet çertifikata e regjistrimit në kurs apo në aktivitetin kulturor që dëshiron të ndjekësh;
- mjete të mjaftueshme ekonomike;
- librezë sigurimi;
- disponueshmëri e një banese;
- biletë aereoplani vajtje - ardhje (për Vizat Schengen: shiko poshtë), ose biletën e vajtjes dhe të tregosh që ke mjete ekonomike të cilat sigurojnë kthimin (për Vizat Kombëtare: shiko poshtë);
- kur studentët janë në ngarkim të prindërve, deklaratë mbi punësimin dhe të ardhurat e tyre si edhe adresa e numrat e telefonave;
- pagesa e të drejtave kosullore.



Kujt mund ti lëshohet viza për studime?

Viza për studime mund ti lëshohet të huajit i cili dëshiron të ndjek kurse universitare, studimi ose formimi profesional pranë instituteve të njohura dhe të kualifikuara, si edhe të huajit i cili kryen aktivitete kulturore dhe studimi. Mundet gjithashtu të hyjnë dhe banojnë në territorin e Shtetit për motiv studimi:

- maxhorenët e pranuar për të frekuentuar kurse të shkollimit dytësor superior (gjimnaz) dhe kurse të shkollimit dhe formimit teknik superior;
- personat që janë pranuar për të frekuentuar kurse të formimit profesional dhe praktika profesionale, të përfshirë në kuotat vjetore të përcaktuara nga Ministria e Punës, e Shëndetësisë dhe e Politikave Sociale;
- te miturit jo më pak se pesëmbëdhjete vjec i pajisur me format e duhura të tutelimit;
- te miturit nën katërmbëdhjetë vjec që marrin pjesë në projektet e shkëmbimit ose iniciativa kulturore të aprovuara nga Ministria e Arsimit, e Universitetit dhe e punës kërkimore –shkencore ose nga Ministria për Pasuritë dhe Aktivitetet Kulturore.

Ku mund të kërkoj vizë për motive studimi?

Duhet ta kërkohësh personalisht pranë përfaqësisë diplomatike apo konsullore në vendin tënd të rezidencës. Në rastin e fundit, duhet të tregosh lejqendrimit në vendin ku kërkon Vizë.

Si të veproj për të hyrë në Itali me një vizë për motive studimi?

Viza për studim mund të jetë dy llojesh:

- vizë Shengen me afat të shkurtër, më pak se 90 ditë brenda një periudhe prej prej 6 muajsh; në këtë rast duhet të deklarohet prania në territor ose autoriteteve të kufirit ,ose Kuestorit të provincës në të cilën ndodhesh brenda 8 ditësh nga hyrja në Itali;
- vizë kombëtare me afat të gjatë, për qëndrime që i kalojnë 90 ditët, por megjithatë me afat të përcaktuar; në këtë rast duhet kërkuar leje qëndrimi për studim, duke dërguar kit-in përkatës në zyrën e postës gjithnjë brenda 8 ditësh pune nga hyrja juaj në Itali.



Kam nje leje qendrimi ne nje vend tjetër te Bashkimit European. Duhet te kerkoj vize per te vazhduar studimet e mia ne Itali ose per te frekuentuar nje kurs që i pershtatet studimeve te mia?

Jo, me kusht që ti të plotësosh kushtet e kërkuara nga ligji italian, merr pjesë në një projekt shkëmbimesh komunitare ose bilaterale me Shtetin e origjinës ose je i autorizuar për të banuar në një vend tjetër të Bashkimit European për të paktën dy vjet dhe i bashkangjit kërkesës për leje qëndrimi dokumentat e lëshuara nga autoritetet akademike të vendeve të BE ku ke kryer studimet, nga ku rezulton që programi i studimeve që duhet të kryesh në Itali të jetë plotësues i atyre që ke kryer.

Mund të marr vizën për motive studimi pa njohur gjuhën italiane?

Jo: kërkohet njohja fillestare e gjuhës italiane, e cila testohet gjatë bisedës pranë përfaqësisë diplomatike konsullore italiane.

Çfarë kushtesh duhet të plotësoj për të marr vizën për kura mjekësore?

- Deklaratë e strukturës shëndetësore të përzgjedhur, ku të tregohet edhe lloji i mjekimit;
- data e fillimit, kohëzgjatja dhe shpenzimet në total të kurës;
- deklaratë e strukturës shëndetësore ku pranohet që ti ke depozituar të paktën 30% të shpenzimeve të kurës;
- burime ekonomike të mjaftueshme për pagesën e shpenzimeve të mbetura;
- bileta e udhëtimit;
- autorizimi i Ministrisë së Punës, Shëndetsisë dhe Politikave Sociale, ose vendim i veçantë Rajonal për kurat e parashikuara në kuadrin e ndërhyrjeve humanitare.

Çfarë kushtesh duhet të plotësoj për të marr vizën për motive fetare?

Mund të marrin këtë lloj vize fetarët që marrin pjesë në manifestime fetare apo që ushtrojnë funksione fetare, pastorale ose kishtarë.

Kushtet që duhet të plotësojë janë:



- dokumenta që dëshmojnë gjëndjen tënde si fetar;
- garanci të dokumentuara rreth karakterit fetar të manifestimit ku do të marrësh pjesë;
- bileta e udhëtimit;
- mjete të jetesës ose, në rast se shpenzimet e qëndrimit janë në ngarkim të një enti fetar, një deklaratë nga ky ent.

Çfarë kushtesh duhet të plotësoj për të marr vizën për motive pune?

Varet nga lloji i punës. Në Itali raporti i punës mund të jetë dy llojesh:

- punë e varur me kohë të caktuar, të pacaktuar ose stinore;
- punë e pavarur.

Çfarë kushtesh duhet të plotësoj për të marr vizën për bashkim familjar me bashkeshortin jasht shtetit?

Duhet të kesh një familjar me lejeqëndrim të rregullt te pakten për një vit, i cili të paraqesë kërkesën për leje (nulla osta) pranë Sportelit Unik duke provuar që disponon:

- mjetet ekonomike të mjaftueshme, nëpërmjet deklaratës tënde të të ardhurave;
- një banesë të përshtatshme me çertifikatë të përshtatshmërisë e lëshuar nga Bashkia ku banon dhe një çertifikatë e përshtatshmërisë higjienike dhe shëndetsore e lëshuar nga ASL (Ndërmarrje shëndetsore lokale) kompetent për territorin.

Vini re: autorizimi (nulla osta) nuk është i nevojshem për familjarët e huaj të qytetarit italian ose të qytetarëve të Bashkimit Europian.

I huaji, i cili ndodhet në Itali, për cilët prej familjarëve të tij mund të kërkoj vizë për bashkim familjar?

- Bashkëshorti, që të mos jetë i ndarë me ligj dhe me moshë jo më pak se 18 vjeç;
- Të miturit, edhe ato të bashkëshortit ose të lindur jasht martesës, të pamtuar me kusht që prindi tjetër, në rast se jeton, të ketë dhënë pëlqimin e tij;



- Fëmijët në moshë madhore te pamartuar që i ka në ngarkim, në rast se ata vetë nuk mund të përkujdesen për nevojat e tyre të domosdoshme të jetës për arsye të gjendjes shëndetsore (invaliditeti i plotë);
- Prindërit në ngarkim, me kusht që të mos kenë fëmijë të tjerë në Vendin e origjinës ose të prejardhjes, ose prindër mbi 65 vjec, me kusht që fëmijët e tjerë të mos kenë mundësi t'i mbajnë, për motive të rënda shëndeti, por të dokumentuara.

Nuk lejohet bashkimi familjar i bashkëshortit apo i prindit, kur familjari për të cilin kërkohet bashkimi është i martuar me një qytetar të huaj që banon rregullisht me bashkëshortin tjetër në territorin kombëtar.

Ndërsa lejohet hyrja për të bërë bashkim familjar me fëmijën në moshë të mitur, që banon rregullisht në Itali me prindin tjetër, prindit natyror që vërteton disponibilitetin e banesës dhe të të ardhurave. Sigurisht mbahet në konsideratë fakti që këto kushte duhet t'i plotesojë bashkëshorti që jeton në Itali.

Autorizimi (nulla osta) jepet nga Sporteli Unik brenda 180 ditësh nga data e kërkesës.

Çfarë dokumentash duhen për bashkim familjar?

- Kërkesa për nulla ostën (autorizimin) për bashkimin familjar që duhet t'i paraqitet sportelit unik;
- Kërkesë me pullë;
- pashaportë dhe fotokopja e saj;
- lejeqëndrimi dhe fotokopja e tij;
- pashaportë e familjarëve me të cilët dëshiron të bashkohesh dhe fotokopjen;
- deklaratë e punëdhënësit ku të përcaktohet raporti i punës dhe pagesa mujore;
- letërnjoftimi i punëdhënësit dhe fotokopja;
- kontrata e qirasë, ose deklaratë nga noteri mbi shtëpinë ku ti banon. Në rast se jeton pranë punëdhënësit, ky i fundit duhet të deklarojë që është i gatshëm të mbajë me kohë të pacaktuar familjarët e vartësit e tij;
- çertifikata e martesës, përkthyer dhe noterizuar nga përfaqësia italiane kompetente, në rastin e bashkimit familjar me bashkëshortin apo bashkëshorten;
- çertifikatë lindjeje e të miturit, përkthyer dhe noterizuar nga përfaqësia ita-



liane kompetente, dhe në rast se njëri prej prindërve banon jashtë shtetit, një deklaratë ku miraton lëvizjen jashtë vendit të të miturit;

- certifikata e gjendjes familjare;
- disponueshmëria e një banese konform me kushtet higjieno – shëndetësore, si dhe të përshtatshmërisë së banesës, e provuar respektivisht nga gjykimi i përshtatshmërisë së kushteve higjienike dhe sanitare e lëshuar nga Qendra Shëndetësore Vendore kompetente për territorin e nga dhe nga certifikata e përshtatshmërisë së banesës e lëshuar nga Bashkia; Në rastin e një fëmije nën 14 vjeç që shoqëron një nga prindërit, është e mjaftueshme leja e titullarit të banesës në të cilën i mituri do të banojë efektivisht;
- të ardhurat vjetore, sipas ligjit.

Vini re: dokumentat që vërtetojnë lidhjen fisnore:

- Çertifikata e martesës e përkthyer nga Përfaqësia Diplomatike Konsullore Italgjane kompetente, në rastin e bashkimit familjar me bashkëshortin/en;
- Çertifikatën e lindjes të fëmijës, të përkthyer nga Përfaqësia Diplomatike Konsullore Italgjane kompetente, dhe nëse një nga prindërit jeton jashtë shtetit, një deklaratë e lejimit të daljes jashtë shtetit.

Duhet të paraqiten, sëbashku me autorizimin (nulla osta) direkt në konsullatën italgjane.

Nëse nuk ekziston çertifikata e lëshuar nga autoriteti kompetent i huaj, ose nëse ekzistojnë dyshime mbi vërtetësinë e dokumentit në fjalë, përfaqësitë konsullore e japin dokumentin në bazë të provës së DNA (acid desosirionukleik) të kryer me shpenzimet e të interesuarit.



qëndrimi në Itali
qëndrimi në Itali

Lejeqëndrimet

Çfarë është lejeqëndrimi?

Është një autorizim që lëshohet nga Kuestori dhe lejon qëndrimin e të huajit në territorin e Shtetit. Mund të jetë me kohë të caktuar apo të pacaktuar.

Kur dhe ku mund ta kërkoj?

Lejeqëndrimi duhet t'i kërkohet detyrimisht brenda 8 ditë pune nga hyrja jote në Itali ose në njërin prej Shteteve Shengen (me përjashtim të rasteve të hyrjes dhe qëndrimit në territorin italian për vizitë, biznes, turizëm dhe studim me afat jo më të gjatë se 3 muaj, për të cilat është e mjaftueshme deklarata e pranisë që duhet dhënë në kufi ose Kuestorit të provincës në të cilën ndodhesh):

1. në Zyrat postare të aktivizuara, duke përdorur një paketë të disponueshme pranë të gjitha Zyrave të postës, Sindakatave dhe Bashkive të aktivizuara.
2. direkt Kuestorit të Provincës ku jeton, vetëm në rastet e kërkesës së një leje qëndrimi për:

- azil politik (kërkese – dhënie);
- kura mjekësore;
- gara sportive;
- drejtësi;
- integrim i të miturve;
- motive humanitare;
- kërkese e statusit apolid (dhënie);
- pushime pune;
- motive familjare në rastin e martesës së qytetarit të huaj me qytetar italian (neni 19 D. Lgjs 286/98);
- kartë qëndrimi për familjarët e huaj të një qytetari italian ose të BE.

Vini re: kërkesa për dhënie e lejes së parë të qëndrimit për punë të varur, si dhe të lejes së qëndrimit për bashkim familjar, përpilohet dhe stampohet direkt në Sportelin Unik për Imigracionin, që ka dhënë ndërkohë autorizimin dhe dorëzohet në momentin e nënshkrimit të kontratës së qëndrimit së bashku me zarfin që duhet përdorur për t'ia përcjellë zyrës Postare.

Çfarë dokumentash duhet të paraqes për të marrë lejeqëndrimin?

Pasaportën tënde me vizën e hyrjes. Në formularin që do të të japin duhet të shkruash: të dhënat e tua dhe në rast se me vete ke edhe fëmijë nën moshën



18 vjeç edhe të dhënat e tyre, vëndin dhe arsyen e qëndrimit. Formularit duhet t'i bashkëngjitesh 4 fotografi me permasa të posaçme (si për librezë).

Kuestura mban një kopje të të gjithë dokumentave që ke paraqitur. Ndërsa një kopje tjetër të lëshohet ty si vërtetim dhe duhet të përmbajë: vulën e zyrës ku ti ke paraqitur kërkesën, firmën e funksionarit të ngarkuar, datën e paraqitjes së kërkesës, ditën e tërheqjes së lejeqëndrimit.

Vini re: Të huajt që bën kërkesë për lejeqëndrim i merren shenjat e gishtërinjve.

Çfarë është Marrëveshja e integritit?

Është një marrëveshje midis qytetarit imigrant dhe shtetit italian që përcakton udhëzimet për një bashkëjetesë më të mirë në Itali. Në këtë marrëveshje - për të cilën do të thirresh ta nënshkruash në muajt në vazhdim – përcaktohen objektivat që duhet të ndjekësh gjatë periudhes së vlefshmërisë të lejes tënde të qëndrimit, secili nga të cilët të shton pikët. Nënshkrimi i kësaj marrëveshje përfaqson kusht të nevojshëm për dhënien e lejes së qëndrimit. Humbja e të gjitha pikëve të kushton tërheqjen e lejes së qëndrimit dhe përjashtimin nga territori i shtetit, me përjashtim të titullarëve të lejeve të qëndrimit për azil politik, kërkesë për azil, tutelë mbrojtëse, për motive humanitare, familjare, leje qëndrimi BE për një periudhë të gjatë, me kartë qëndrimi për familjarin e huaj të qytetarit të BE.

Sa është kohëzgjatja e lejeqëndrimit?

Kjo varet nga shkaku për të cilin ti kërkon lejeqëndrimin.

Për motive pune:

Kohëzgjatja e lejeqëndrimit përkon me atë të kontratës së qëndrimit të nënshkruar midis një punëdhënësi italian ose të huaj, i cili qëndron në mënyrë të rregullt në Itali dhe një punëtori të huaj. Në çdo rast nuk mund të kalojë:

- afatin e përgjithshëm prej 9 muajsh, në rastin e një ose më shumë kontratave për punë stinore;
- afatin prej 1 viti, në rastin e një kontrate për punë të varur me kohë të caktuar;
- afatin prej 2 vjetësh, në rastin e një kontrate për punë të varur me kohë të pacaktuar;
- afatin prej 2 vjetësh; në rastin e punës së pavarur.

Për motive të tjera:

Kohëzgjatja e lejeqëndrimit përkon me atë të vizës së hyrjes dhe në çdo rast



nuk mund të kalojë:

- 1 vit sipas kohëzgjatjes së kursit të studimeve që duhet të ndjekësh; leje-qëndrimi është i rinovueshëm çdo vit për kurset më të gjata se një vit;
- 3 muaj për vizita, biznes dhe turizëm;
- përkon me kohën e procedurave të dhënies apo të njohjes për:
 - marrjen e shtetësisë;
 - pa atdhe, pa shtetësi;
 - refugjat politik;
 - emigracion në një vend tjetër.
- një kohë të caktuar në bazë të nevojave që mund të kesh, të dokumentuara, në të gjitha rastet e tjera.

Në rastet e bashkimit familjar dhe të punës së pavarur, kohëzgjatja e lejes së qëndrimit nuk mund të jetë më shumë se 2 vjet.

Vini re: Nëse demonstron (duke paraqitur pashaportën ose një dokument tjetër ku rezulton data e nisjes nga Italia në përfundim të lejes së mëparshme për punë stinore) që ke ardhur në Itali për të paktën 2 vjet rradhazi për punë stinore, në rastin kur flitet për impenjim sistematik, punëdhënësi yt mund të kërkojë dhënien e autorizimit për punë shumëvjeçare në favorin tënd. Dhënia e autorizimit për punë shumëvjeçare (e vlefshme për një periudhë maksimumi 3 vjet) realizohet brenda kufijve të kuotave të hyrjes të përcaktuara cdo vit për punë stinore.

Autorizimi për punë shumëvjeçare në fakt të jep mundësinë të hysh në Itali për 3 vite rradhazi për të kryer, gjithnjë për të njejtën kohëzgjatje (maksimumi 9 muaj) një punë stinore të përcaktuar me një punëdhënësi të përcaktuar pa patur nevojë të ndjekësh cdo vit procedurën e flukseve të hyrjes. Mbi bazën e autorizimit shumëvjeçar të lëshohet në fakt një lejeqëndrimi për punë stinore shumëvjeçare, e cila nuk të përjashton nga detyrimi për të kërkuar cdo vit vizën e hyrjes në përfaqsinë diplomatike apo konsullore, duke paraqitur propozimin për kontratën e qëndrimit për punë stinore, të tranzmetuar nga punëdhënësi, punonjësit ekstrakomunitar.

Cdo vit pra, brenda 8 ditësh nga hyrja në Itali, duhet të paraqitesh në Sportelin Unik për të nënshkruar kontratën e qëndrimit për punë.

Si mund të rinovoj lejen e qëndrimit?

Duhet të paraqesësh kërkesën për rinovimin e lejeqëndrimit pranë Kuestorit të Provincës në të cilën banon, ose duke dërguar kit-in përkatës postar të pak-



tën 60 ditë para skadimit. Rinovimi i nënshtrohet verifikimit të kushteve të parashikuara për lëshimin dhe të kushteve të tjera të parashikuara nga ligji.

Sa është kohëzgjatja e lejeqëndrimit të rinovuar?

Kohëzgjatja e lejeqëndrimit të rinovuar përkon me atë të lejeqëndrimit të parë.

Kur nuk mund të rinovoj lejeqëndrimin?

Lejeqëndrimi nuk mund të rinovohet apo të zgjatet në rast se nuk ke qëndruar në Itali për një periudhë më të gjatë se 6 muaj, apo më të gjatë se gjysma e periudhës gjatë të cilës është i vlefshëm lejeqëndrimi. Mund të rinovohet kur ke arsye të rëndësishme (shërbimi ushtarak ose arsye të tjera të këtij lloji).

Kam një lejeqëndrimi për turizëm. Mund ta rinovoj?

Po, por vetëm për arsye serioze, si për shembull humanitare apo për detyrime kushtetuese dhe ndërkombëtare.

Mund të ndërroj lejeqëndrimin për studime në lejeqëndrim për punë?

Po, përpara se të skadojë dhe brenda kuotave vjetore, për punë të varur ose autonome, të rezervuara pikërisht për këtë qëllim për qytetarët e huaj:

- në rastin e punës së varur me kohë të pacaktuar ose të përcaktuar, duhet të paraqesësh dokumentat të cilat vertetojnë ekzistencën e raportit të punës;
- në rastin e punës së pavarur duhet të paraqesësh dokumentat në lidhje me aktivitetin që mendon të kryesh si edhe dokumentat që provojnë disponibilitetin tënd financiar të nevojshëm për ushtrimin e aktivitetit.

Nëse ke kryer në Itali doktoratin ose master universitar të gradës së dytë, në përfundim të lejes së qëndrimit për motive studimi, mund të regjistrohesh në listën e personave në kërkim të punës, për një periudhë jo më të gjatë se dymbëdhjetë muaj, dhe, duke plotësuar kushtet e parashikuara nga ligji, mund të kërkosh konvertimin në leje qëndrimi për motiv pune.

Vini re: për konvertimin e lejes së qëndrimit të të miturve që mbushin moshën madhore në Itali dhe të atyre që diplomohen në Itali, nuk ka nevojë të verifikohet disponibiliteti i kuotave.

Mund të ndërroj lejeqëndrimin tim për punë stinore në një lejeqëndrim për punë të varur me kohë të caktuar apo të pacaktuar?

- Po, në se ke punuar si punëtor stinor vitin e mëparshëm dhe ke hyrë për herë të dytë.
- nëse hyn për herë të parë në Itali, mund të ndërrosh punëdhënësin brenda periudhës së vlefshmerisë së lejes së qëndrimit (9 muaj), por gjithnjë për një



raport pune stinor; në përfundim të raportit të punës duhet të kthehesh në vendin tënd dhe të kërkohet të drejtën e përparësisë për vitin e ardhshëm.

Mund të përdor lejeqëndrimin tim për punë të varur, autonome ose për motive familjare për të kryer aktivitete të tjera?

Po, për gjithë kohëzgjatjen e lejeqëndrimit, edhe pa e konvertuar ose rati-fikuar atë. Për shembull:

- lejeqëndrimi për punë të varur me kohë të përcaktuar ose të pacaktuar (jo stinore) të lejon të kryesh punë të pavarur apo si një ortak i punësuar në një kooperativë;
- lejeqëndrimi për punë të pavarur të lejon të kryesh punë të varur me kohë të përcaktuar ose të pacaktuar, duke respektuar komunikimet e detyrueshme të parashikuara nga ligji, nepermjet modelit të unifikuar; në këtë rast, punëdhënësi duhet të vërë në dijeni edhe Sportelin Unik për Imigracionin (Sportello Unico per l'Immigrazione) pranë Zyrës Territoriale të Qeverisë (Ufficio Territoriale del Governo) – Prefektura duke i derguar kontraten e qëndrimit për punë të varur;
- lejeqëndrimi për bashkim familjar të lejon të kryesh punë të varur me kohë të përcaktuar ose të pacaktuar ose punë të pavarur;
- lejeqëndrimi për studime ose formim të lejon të kryesh punë të varur me kohë të përcaktuar ose të pacaktuar deri në 20 orë në javë, ose të mbledhura në 52 javë, dhe sidoqoftë jo më shumë se 1.040 orë në vit. Kjo lejeqëndrimi mund të konvertohet në lejeqëndrim për motive pune, brenda kuotave vjetore, të parashikuara për këtë qëllim.

Vini re: për ndërrimin e lejes së qëndrimit të të miturve që mbushin moshën madhore në Itali dhe të atyre që diplomohen në Itali, s'ka nevojë të verifikohet disponibiliteti i kuotave.

Mund të mos ma japin ose të ma heqin lejeqëndrimin?

Lejeqëndrimi mund të të hiqet në rast se të mungojnë kërkesat e parashikuara nga ligji për qëndrimin në Itali, por jo në rast se ekzistojnë motive serioze: humanitare për shembull, ose motive të kushtëzuara nga detyrime kushtetuese ose ndërkombëtare.

Çfarë mund të bëj në rast se më refuzojnë ose më heqin lejeqëndrimin?

Brenda 60 ditëve nga lajmërimi i masës, mund të paraqesësh ankesë në T.A.R. (Gjykata Administrative Rajonale) kompetente për Kuesturën që ka nxjerrë urd-



hërin në se mosdhënia ose heqja e lejeqëndrimit ka të bëjë me motive pune. Në se mosdhënia ose heqja e lejeqëndrimit ka të bëjë me motive familiare, mund të ankoresh pranë Gjykatës civile.

Kam një lejeqëndrim për motive studimi. Mund ta ndërroj në një lejeqëndrim për punë të pavarur?

Po, vetëm brenda kuotave të hyrjes të parashikuara nga Dekreti i flukseve si edhe aktiviteti që mendon të ndërmarrësh të mos ndalohej me ligj, të disponosh mjetet ekonomike dhe banesën.

Kam një lejeqëndrim për punë të varur dhe dëshiroj të ndërmarr një aktivitet pune të pavarur: duhet ta ndërroj në një lejeqëndrim për punë të pavarur?

Jo, mund të ndërmarrësh një aktivitet të pavarur. Në momentin e rinovimit të lejeqëndrimit mund të kërkohesh një lejeqëndrim për punë të pavarur.

Vini re: për ndërrimin e lejes së qëndrimit të të miturve që mbushin mos-hën madhore në Itali dhe të atyre që diplomohen në Itali, s'ka nevojë të verifikohet disponibiliteti i kuotave.

Cilat janë të drejtat që unë gëzoj kur kam lejeqëndrim?

- Mund të rregjistrohesh në Zyrat e Punës dhe të kesh skedën tënde profesionale;
- mund të rregjistrohesh në Shërbimin Shëndetësor Kombëtar;
- mund të rregullosh pozicionin tënd me INPS (Instituti Kombëtar për Sigurimin Shoqëror);
- mund të rregullosh pozicionin tënd me INAIL (Instituti Kombëtar për Akcidentet në Punë);
- mund të kërkohesh rregjistrimin në Gjendjen civile pranë Komunës ku banon;
- mund të kërkohesh rregjistrimin në shkollë (sistemi shkollor i detyruar) për të miturit;
- mund të marrësh pjesë ose të krijosh një shoqatë;
- mund të rregjistrohesh në sindakatë.

Cilat janë detyrimet e mia kur kam lejeqëndrim?

Je i detyruar të tregosh lejeqëndrimin sëbashku me, pashaportën ose një dokument tjetër identifikimi në këto raste:

- punonjëseve të administratës publike, në rast se kërkon licenca të ndryshme, autorizime, rregjistrime, etj;



- sa herë të kërkohet nga punonjësit e sigurimit publik; në rast se refuzon, ndëshkohesh me me arrestim deri në një vit dhe me një gjobë deri në 2.000 euro. Punonjësit e sigurimit publik, kur ekziston një motiv i vlefshëm, mund të të kërkojnë edhe informacione dhe prova të dokumentuara mbi të ardhurat (nga puna apo nga një burim tjetër i ligjshëm), të mjaftueshme për ty si dhe për familjarët që bashkëjetojnë me ty në Itali.

Je i detyruar, gjithashtu, ti komunikosh Kuestorit kompetent për territorin ndryshimet e mundshme të vendbanimit, brenda 15 ditësh.

Për dhënien ose rinovimin e lejes së qëndrimit duhet të pagoj ndonjë kontribut?

Kërkesa për dhënien ose rinovimin e lejes së qëndrimit i nënshtrohet pagesës së një kontributi, shumën e të cilit do të jetë nga një minimum prej 80 euro, në një maksimum prej 200 euro. Nuk kërkohet pagesa e kontributit për dhënien ose rinovimin e lejes së qëndrimit për azil politik, për kërkesë për azil, për tutelë mbrojtëse, për motive humanitare.

Në rast se humbas vendin e punës, humbas edhe lejeqëndrimin?

Jo, kur punëtori i huaj humbet vendin e punës, punëdhënësi që e ka punësuar, është i detyruar t'i komunikojë Qendrës për Punësim kompetent brenda 5 ditësh, pushimin nga puna. Qendra për Punësim Vini re! et për inserimin e punëtorit në listat e punësimit, ose rinovon pozicionin e tij në rast se është i regjistruar. Punëtori e ruan rregjistrimin për gjithë periudhën e vlefshmërisë së lejeqëndrimit dhe sidoqoftë, me përjashtim të punëtorëve stinorë, për një periudhë jo më të shkurtër se 6 muaj.

Çfarë ndodh nëse hyj apo qëndroj në Itali pa leje qëndrimi apo me leje të skaduar?

Në këtë mënyrë kryej një krim dhe ndëshkohem me një gjobe nga 5.000 euro deri në 10.000 euro.



Lejeqëndrimi BE për banorët me afat të gjatë

Çfarë është lejeqëndrimi BE për banorët me afat të gjatë?

Është një dokument që të lejon qëndrimin në kohë të pacaktuar në Itali.

Cilat janë kërkesat që duhet të plotësoj për të marrë lejeqëndrimin BE për banorët me afat të gjatë?

Mund të marrësh lejeqëndrimin BE për banorët me afat të gjatë në qoftë se:

- je i huaj që banon rregullisht në Itali prej të paktën 5 vitesh dhe ke një leje qëndrimi të vlefshme (me përjashtim të lejeve të qëndrimit për studim, formim profesional, azil, mbrojtje të perkohëshme, motive humanitare)
- je një i huaj, bashkëshort/bashkëshorte, fëmij i mitur apo prind që bashkëjeton me një qytetar italian apo të njërit prej Vendeve të Bashkimit Evropian rezident në Itali;
- je një i huaj bashkëshort; fëmijë i mitur edhe i bashkëshortit apo edhe i lindur jasht martesës, i pa martuar, me kusht që prindi tjetër të ketë dhënë lejen e tij; fëmijë në moshë madhore në ngarkim në rast se nuk mund të përkujdesesh për nevojat e tua të domosdoshme të jetës për arsye shëndetsore (invalid i plotë) prind në ngarkim që nuk disponon një mbështetje të përshtatshme familjare në vendlindje ose në vendin nga ku vjen, i një qytetari të huaj që është titullar i një leje qëndrimi BE për banorët me një afat të gjatë që mund të vërtetojnë të kenë të ardhura të mjaftueshme.

Të kalosh provimin e njohjes së gjuhës italiane.

Ku mund t'a kërkoj?

Kërkesa paraqitet duke përdorur Kit-in postar të posacëm pranë Bashkive ose zyrave të Sindakatave që ofrojnë këtë shërbim.

Sa është kohëzgjatja e lejeqëndrimit BE për banuesit me afat të gjatë?

Lejeqëndrimi BE për banuesit me afat të gjatë është me kohë të pacaktuar.

Lejeqëndrimi BE për banorët me afat të gjatë është e rinovueshme?

Po, me kërkesën e të interesuarit; duhet të shoqërohet edhe me fotografi.

Lejeqëndrimi BE për banuesit me afat të gjatë është e vlefshme si doku-



ment identifikimi për jo më shumë se 5 vjet nga data e lëshimit apo e rinovimit.

Çfarë dokumentash duhet të paraqes për të marrë lejeqëndrimin BE për banorët me afat të gjatë?

Duhet të bësh kërkesën, nëpërmjet formularit të Ministrisë së Brendëshme. Në kërkesë duhet të përcaktosh:

- të dhënat e tua të plota;
- vëndet ku ke banuar në Itali në 5 vitet e fundit;
- burimet e të ardhurave (duke përcaktuar shumën);
- vendin ku je rezident;
- fotografi të njëjta, në format të posaçëm, (si në librezë);
- lejeqëndrim + fotokopje;
- pasaportë + fotokopje;
- fotokopje e kodit fiskal;
- çertifikatë nga kartoteka e gjykatës si edhe çertifikatën e hetimeve apo të proceseve në vazhdim e sipër;
- kopje e deklaratës të fundit të të ardhurave;
- çertifikatë e gjendjes familjare ose autoçertifikatë;
- 1 pullë.

Në veçanti:

Në rast se ke një kontratë pune të varur:

- deklaratë e punëdhënësit (person fizik ose shoqëri) + fotokopjen e letërnjoftimit të atij që firmos;
- kopje e dokumentit të fundit të rrogës (busta paga);
- kopje e kontratës së punës;
- kopje e pagesave të INPS (për punëtorët e shtëpisë);
- deklaratë mbi të ardhurat.

Në rast se je punëtor i pavarur:

- kopje e çertifikatës së regjistrimit pranë Dhomës së Tregëtisë, Industrisë dhe Artizanatit apo në regjistra ose urdhëra profesionale si edhe të tregosh origjinalen;
- kopje e numrit të TVSH (Partita IVA) dhe të tregosh origjinalen;
- kopje e deklaratës së të ardhurave të vitit të fundit si edhe pagesat e taksave.



Çfarë dokumentash duhet të paraqes në mënyrë që edhe familjarët e mi të marrin lejeqëndrimin BE për banorët me afat të gjatë?

Përveç dokumentave që sapo rradhitem, duhet të paraqesësh për secilin prej familjarëve edhe dokumentat që dëshmojnë:

- certifikatë martese (bashkëshorti/bashkëshortja) e vlefshme apo certifikatë lindjeje për të miturit (certifikatat duhet të përkthehen dhe të notifikohen nga konsullata italiane në vendin e origjinës);
- disponueshmërinë e një banese, të shoqëruar nga një certifikatë që dëshmon kushtet e përshtatshme higjienike dhe sanitare, të lëshuar nga Qendra Shëndetësore Vendore kompetente për territorin e nga komuna;
- të ardhurat vjetore, të cilat nuk duhet të jenë më të ulta se parametrat e vendosura nga ligji.

Cilat janë të drejtat që unë gëzoj kur kam lejeqëndrimin BE për banorët me afat të gjatë?

- Mund të hysh e të dalësh nga Italia pa patur nevojë për vizë;
- mund të ushtrosh çdo lloj aktiviteti të ligjshëm i cili nuk i ndalohet shprehimisht qytetarëve të huaj apo i rezervohet vetëm qytetarëve italianë;
- mund të përfitosh nga shërbimet që ofron administrata publike;
- mund të përfitosh nga ndihmat ekonomike për invalidët civil (përfshirë edhe të miturit e regjistruar në lejeqëndrimi BE për banorët me afat të gjatë të prindit);
- mund të përfitosh çekun për nënat;
- mund të përfitosh çekun social; Duke u nisur nga 1 janari 2009, për të përfituar çekun social, duhet të kesh banuar në mënyrë të ligjshme dhe pa ndërprerje për të paktën dhjetë vjet në territorin kombëtar;
- mund të punosh dhe studiosh pa kërkuar vizë në vendet e Bashkimit Europjan që kanë pranuar direktivën mbi lejet e qëndrimit BE për periudhë të gjatë.

Mund të ma refuzojne apo të ma heqin lejeqëndrimin BE për banorët me afat të gjatë?

Mund të refuzohet leja e qëndrimit BE për banuesit me afat të gjatë nëse kërkuesi është dënua për një nga krimet e parashikuara nga neni 380 i kodit të procedurës penale, dhe vetëm për krimet jo me paramendim, nga neni 381 edhe nëse është dhënë gjykimi i dënimit;



(edhe pse jo i formës përfundimtare) për të cilin nuk është kërkuar rehabilitimi. Leja e qëndrimit me afat të gjatë mund të refuzohet edhe nëse je larguar nga Italia për një periudhë pa ndërprerje prej më shumë se tre muajsh ose për një periudhë totale prej 10 muajsh gjatë 5 viteve të qëndrimit të kërkuara; gjithashtu mund të refuzohet për motive të rregullit publik dhe të sigurimit të shtetit. Kuestori vendos anulimin nëse merret një vendim dënimi edhe pse jo përfundimtar; nëse përkundrazi rehabilitohesh, mund ta marrësh përsëri. Mund të anulohet nëse largohesh nga territori i BE për një periudhë më të gjatë se 12 muaj për motive të rregullit publik dhe të sigurimit të Shtetit. Në marrjen e vendimeve të anulimit duhet mbajtur gjithsesi parasysh mosha e të interesuarit, afati i qëndrimit në territorin kombëtar, ekzistenca e lidhjeve familjare dhe sociale në territorin kombëtar dhe të mungesës së lidhjeve të tilla me vendin e originës.

Çfarë mund të bëj në rast se më refuzojnë ose më mohojnë lejqëndrimin BE për banorët me afat të gjatë?

Mund të paraqesësh ankesë në TAR (Gjykata Administrative Rajonale) kompetente.

Nënshtetësia italjane

Si mund të përfitoj nënshtetësinë italjane?

Në mënyrë automatike: për prejardhje nga qytetar/e italian, kur të njihet atësia ose mëmësia ndërkoqë që je akoma i mitur, për adoptim, për lindje në territorin italian vetëm në raste të jashtzakonshme.

Për zgjedhje, nga mosha 18 deri në 19 vjec, nëse ke lindur në territorin italian dhe banon aty në mënyrë të ligjshme dhe të pandërprerë që nga lindja deri në arritjen e moshës madhore.

Duke bërë kërkesë:

- **për martesë** me qytetar/e italian/e kur, pas martesës, banon ligjërisht në Itali prej të paktën dy vjetesh, ose nëse banon jasht, pas tre vjetesh nga data e martesës, me kusht që të mos ketë ndodhur ndërkohe zgjidhja, anulimi apo ndalimi i efekteve civile të martesës. Koha përgjysmohet në prani të fëmijëve të lindur apo të adoptuar nga bashkëshortët.
- **për banim** nëse:



- ke lindur në Itali dhe banon rregullisht prej të paktën tre vitesh;
- je bir apo nip në linjë direkte i qytetarëve italjane për lindje dhe banon ligjërisht në Itali prej të paktën 3 vitesh;
- je në moshë madhore, i adoptuar nga qytetar italkan dhe banon rregullisht në Itali prej të paktën 5 vitesh pas adoptimit;
- ke punuar për të paktën 5 vjet, edhe jasht shtetit, në shërbim të Shtetit Italkan;
- je qytetar i Bashkimit Europjan dhe banon ligjërisht në Itali prej të paktën 4 vitesh;
- je pa nënshtetësi apo refugjat dhe banon rregullisht në Itali prej të paktën 5 vitesh;
- je qytetar jo komunitar dhe banon rregullisht në Itali prej të paktën 10 vitesh.

Përfitimi i nënshtetësisë italjane nuk sjell refuzimin e nënshtetësisë së origjinës, vetëm në rast se humbja është e parashikuar shprehimisht nga ligjet e Vendit të origjinës.

Për kërkesën e nënshtetësisë italjane duhet të derdh një kontribut?

Kërkesat apo deklaratat e zgjedhjes, përfitimit, ripërfitimit, heqjes dorë apo dhënies së nënshtetësisë, i nënshtrohen pagesës së një kontributi me vlerë 200 euro.

Zona Schengen

Çfarë është zona Schengen?

Është një hapsirë e përbashkët e qarkullimit të lirë të qytetarëve të vendeve që marrin pjesë. Të gjitha vendet e zonës Schengen (Austria, Belgjika, Qipro, Danimarka, Estonia, Finlanda, Franca, Gjermania, Greqia, Irlanda, Islanda, Italia, Letonia, Lituania, Lihteshtejni, Luksemburgu, Malta, Norvegjia, Vendet e Ulta, Polonia, Republika Ceke, Portugalia, Anglia, Sllovakia, Sllovenia, Spanja, Suedia, Hungaria, Rumania dhe Bullgaria) kanë eliminuar kontrollet në kufijtë e përbashkët dhe kanë krijuar një sistem unik vizash dhe hyrjesh.

Si mund të sillm unë në zonën Schengen?

Në rast se je i huaj dhe ke me vete pashaportën, lejeqëndrimin apo kartën e qëndrimit të vlefshme në Itali, mund të qarkulloshëm lirshëm si edhe të kalosh



një periudhë maksimale prej 3 muajsh në zonën Schengen. Gjatë kësaj periudhe nuk mund të punosh dhe, duhet të kthehesh në Itali sapo të kalojnë 3 muaj. Nëse je titullar i një leje qëndrimi mund të qarkullosh dhe të qëndrosh në vendet e hapsires Schengen që kanë pranuar direktivat mbi banorët e BE me afat të gjatë me një kohezgjatje mbi 90 ditë për:

- punë (e varur ose e pavarur);
- studim dhe formim profesional;
- banim (duke demonstruar disa të dhëna).

Vini re: Letërnjoftimi (karta e identitetit) i lëshuar nga Bashkia ku ti je rezident nuk është dokument i vlefshëm për largimin nga territori i Shtetit, kështu që për të qarkulluar në vendet Schengen duhet të kesh me vete pasaportën përndryshe rrezikon dëbimin.

Jam duke pritur rinovimin e lejes së qëndrimit: mund të tranzitoj në një nga vendet Schengen?

Nëse je në fazën e rinovimit të lejes së parë të qëndrimit, të lejohet të tranzitosh në vendet e zonës Schengen, me kusht që të demonstrosh dokumentet e kërkesës së rinovimit dhe në mënyrë të vecantë:

- pasaportën ose dokument tjetër identiteti i ngjashëm, i vlefshëm për të shkuar jashtë shtetit;
- origjinalen ose fotokopjen lejes së vjetër të qëndrimit;
- origjinalen ose fotokopjen e kuponit të kërkesës së rinovimit të lejes së qëndrimit.

Vini re: Ministria e Brendshme përcakton me rregullore periodike – të publikuara edhe në sito-n www.interno.it, periodhat në të cilat është e mundur të tranzitohet në zonën Schengen në fazën e rinovimit të lejes së qëndrimit, duke demonstruar kuponin e kërkesës.

Jam në pritje të lëshimit të lejes së parë të qëndrimit: mund të tranzitoj në një vend Schengen?

Nëse je duke pritur lëshimin e lejes së parë të qëndrimit, nuk mund të tranzitosh në një vend Schengen; vetëm nëse ke një autorizim nga Ministria kompetente; mund të dalësh dhe të hysh në Itali duke demonstruar fotokopjen e modelit të kërkesës së lejes së qëndrimit të lëshuar nga Sporteli Unik për Imigracionin dhe kopjen e kuponit të prezantimit të kërkesës.



puna
puna

Puna në Itali

Raporti i punës në Itali mund të jetë dy llojesh:

- punë e varur me kohë të pacaktuar, të caktuar, ose stinore;
- punë pjesërisht e varur (psh. kontrate me projekt);
- punë e pavarur.

Punëtori, i cili ka punuar në shërbim të një punëdhënësi, ka të drejtë të shpërblehet; shpërblimi duhet të kryhet në bazë të sasisë dhe cilësisë së punës. Shpërblimi duhet të jetë i mjaftueshëm që punëtori dhe familja e tij të jetojnë në mënyrë dinjitoze dhe të lirë.

Nivelet bazë të shpërblimit për punë të varur janë të përcaktuara në kontratat kolektive të punës (në nivel kombëtar, rajonal, provincial) të cilat duhen respektuar në çdo rast. Punëdhënësi garanton respektimin e sa më sipër në momentin e kërkesës së dokumentave me qëllim hyrjen dhe qëndrimin në Itali të punëtorit. Pjesa më e madhe e respektimit të të drejtave të punëtorit, në kuadrin e raportit të punës, parashikohet pikërisht nga kontratat kolektive të punës të cilave u nënshtrohet punëdhënësi pranë të cilit je punësuar.

Punë e varur

Çfarë është puna e varur?

Është një raport pune, i rregulluar nga një kontratë, në bazë të së cilës punëtori impenjohet të punojë për llogari të punëdhënësit dhe punëdhënësi impenjohet t'i shpërblejë punën nëpërmjet pagës.

Çfarë është kontrata e qëndrimit për punë të varur?

Është një kontratë e cila rregullon raportin e punës ndërmjet punëdhënësit dhe një punëtori jekomunitar. Në kontratën e qëndrimit për punë të varur punëdhënësi garanton disponueshmërinë e një banese për punëtorin dhe pagesën e shpenzimeve të udhëtimit për kthimin në atdhe të punëtorit duke mundësuar në këtë mënyrë lëshimin e lejeqëndrimit.

Cilat janë detyrimet e punëtorit të varur?

Punëtori ndjek direktivat, respekton hierarkinë dhe i nënshtrohet kontrollit të punëdhënësit, i cili përcakton modalitetet e punës.



Çfarë pune mund të kryejë punëtori i varur?

Punët mund të jenë të ndryshme. Bashkësia e detyrave dhe e veprimeve konkrete që punëtori duhet të kryejë quhen “mansione” dhe përcaktohen në kontratën e punës.

Sa kohë duhet të punojë punëtori?

Orari normal i punës është fiksuar në 40 orë në javë, gjithmonë sipas kontratave kolektive të punës, në nivel kombëtar ose në varësi të sektorit; punëtori mund të punojë edhe jashtë orarit por gjithmonë sipas rregullave.

Punëtori ka të drejtë të pushojë 11 orë në vazhdim çdo 24 orë si edhe një periudhë pushimi prej të paktën 24 orësh në vazhdim, zakonisht ditën e djelë, çdo shtatë ditë.

Pushimet vjetore, të paguara, duhet të zgjatën të paktën katër javë dhe duhen kryer në çdo rast.

Ku punon punëtori?

Punëtori duhet të kryejë punën e tij në vendin e përcaktuar, nga të dyja palët, në kontratën e punës ose, në mungesë, në vendin ku puna duhet të paraqitet.

Punëtori nuk mund të transferohet nga një vend në një tjetër përveçse për motive konkrete teknike, organizative dhe prodhuese.

Përveç aktivitetit të punës çfarë i kërkohet tjetër punëtorit të varur?

Punëtori i varur duhet të jetë i vëmendshëm, të ndjekë rregullat, mbi disiplinën dhe kryerjen e punës, të vendosura nga punëdhënësi dhe bashkëpunëtorët e tij si edhe të sillt ndershmërisht ndaj punëdhënësit duke mos përhapur të dhëna sekrete dhe duke mos i bërë konkurrencë atij.

Çfarë të drejtash patrimoniale gëzon punëtori i varur?

- Të drejtën e shpërblimit, i cili mund të jetë në bazë të kohës (në bazë të orarit të punës), në bazë të sasisë (në bazë të rendimentit të punëtorit) ose të marrë pjesë në kapitalet e shoqërisë, etj.;
- të drejtën e trajtimit në përfundim të raportit të punës;
- të drejta në raste të veçanta.



Çfarë të drejtash personale gëzon punëtori i varur?

- Të drejtën e integritetit fizik dhe të shëndetit (pushimin javor, ditor, pushimet vjetore, etj.);
- lirinë e mendimit dhe mbrojtjen e jetës private dhe të dinjitetit;
- të drejtën e studimit për punëtorët studentë;
- të drejtën e aktiviteteve kulturore, rikreative dhe shoqërore.

Çfarë të drejtash sindakale gëzon punëtori i varur?

- Lirinë e organizimit dhe të aktiviteteve sindakale;
- të drejtën e grevës;
- të drejta të tjera sindakale (të drejtën e vendosjes së manifesteve, të shfrytëzimit të lokaleve të shoqërisë për zhvillimin e aktiviteteve sindakale, etj.).

Çfarë është sindikata?

Është një shoqatë punëtorësh për mbrojtjen e të drejtave dhe interesave të punëtorëve në vendin e punës dhe në shoqëri. Sindakatat mund të përfaqësojnë punëtorët të cilët janë rregjistruar në këto të fundit si edhe të firmosin kontrata kolektive të punës të cilat duhet të respektohen nga të gjithë pjesëtarët e kategorive të cilave i drejtohet kontrata.

Çfarë është puna me kohë të pacaktuar?

Është një raport pune e varur e rregulluar nga një kontratë, e cila nuk parashtikon një skadencë kohore. Ky raport pune zgjidhet në rast vdekjeje të punëtorit, me pëlqimin e të dyja palëve, në rast dorëheqje të punëtorit ose në rast pushimi nga puna nga ana e punëdhënësit.

Çfarë është puna me kohë të përcaktuar?

Është një kontratë pune e varur e cila ka një afat mbarimi. Mund të bëjë pjesë në këtë kategori edhe raporti i punës që ka për qëllim kryerjen e një aktiviteti të caktuar, përmbajtja e të cilit përcaktohet në kontratë, si edhe kohëzgjatja e kontratës të përkohshme me përfundimin e aktivitetit.

Çfarë është puna stinore?

Është një punë e varur me kohë të përcaktuar dhe që kryhet vetëm në disa periudha të vitit (p.sh. puna në sektorin bujqësor apo në sektorin e turizmit



dhe të hotelerisë). Ligji mbi imigracionin parashikon kushte të veçanta për punëtorët stinorë jekomunitarë të cilët dëshirojnë të hyjnë në Itali për punë stinore (p.sh. kuota të veçanta për punën stinore, të drejtën e përparësisë në rast se ke hyrë një herë në Itali për të njëjtin motiv, etj.).

A duhet të jetë domosdoshmërisht e shkruar kontrata?

Po, përfundimi i kontratës nuk ka efekt në rast se nuk është përcaktuar në kontratë në formë të shkruar.

Kopja e kontratës i duhet dhënë punonjësit brenda 5 ditëve nga fillimi i punës. Ajo duhet të përmbajë arsyet për të cilat punëdhënësi kërkon punë me kohë të përcaktuar.

Vini re: Nuk është e nevojshme të shkruhet kontrata në se bëhet fjalë për raporte pune të përkohshme me kohëzgjatje jo më shumë se 12 ditë.

Si formalizohet kontrata e punës?

Në momentin e punësimit, punëdhënësi duhet t'i japë punëtorit një deklaratë të shkruar me të dhënat e mëposhtme të regjistrimit:

- të dhënat tuaja;
- vendin e punës;
- datën e fillimit të punës;
- kohëzgjatja e punës;
- kohëzgjatja e periudhës së provës, në se parashikohet;
- profili profesional dhe niveli i inkuadrimit të punonjësit;
- paga;
- kohëzgjatja e pushimeve;
- orari i punës;
- afati i paralajmërimit në rast mbarimi para kohe të kontratës.

Cila është kohëzgjatja maksimale e kontratës me kohë të përcaktuar?

Kohëzgjatja është tërësisht e lirë për tu përcaktuar.



Në se kam një kontratë me kohë të caktuar a kam të njëjtin trajtim në punë në krahasim me punëtorët e tjerë që kanë kontrata me kohë të papërcaktuar?

Për sa i përket parimit të diskriminimit, punëtorët e punësuar me kontratë me kohë të përcaktuar nuk duhet të trajtohen ndryshe nga të tjerët që bëjnë të njëjtën punë si ata. Pra, ke të drejtën e pushimeve, të shpërblimit të Krish-tlindjeve, të pagës së 13-të (dhe 14^o në se parashikohet në kontratë) si edhe të trajtimit financiar në përfundim të punës, si edhe çdo lloj tjetër trajtimi që ndërmarrja i bën punëtorëve të saj pavarësisht nga lloji i kontratës.

Kontrata ime e punës është duke mbaruar. A mund ta zgjas?

Po, punëdhënësi mund të shtyjë kontratën e punës porse shtyrja është e prarueshme vetëm në rastet e mëposhtme:

- vetëm një herë;
- me miratimin e punonjësit;
- në se kontrata e punës është më e vogël se 3 vjet, shtyrja e kontratës nuk mund të jetë më e madhe se 3 vjet;
- për të njëjtën punë;
- në se ka arsye objektive.

Kontrata ime e punës me kohë të përcaktuar ka përfunduar, por jam duke punuar akoma për të njëjtin punëdhënësi. Është e paligjshme?

Jo; mund të ndodhë që edhe pas mbarimit të kontratës punonjësi të vazhdojë punën. Në këto raste të takon një rritje rroge në përpjestimet e mëposhtme:

- 20% më shumë për çdo ditë vazhdimi deri në ditën e 10-të;
- 40% për çdo ditë pas ditës së 10.

Gjithësesi janë parashikuar kufi, përtej të cilëve raporti i punës bëhet me kohë të papërcaktuar.

A mund të rinovohet kontrata e punës me kohë të përcaktuar?

Po, porse sipas kushteve të mëposhtme:

- pas të paktën 10 ditësh në se kontrata e parë kishte kohëzgjatje deri në 6 muaj;



- pas të paktën 20 ditësh në se kontrata e parë kohëzgjatje më të madhe se 6 muaj.

Cila është diferenca midis rinovimit dhe shtyrjes?

Në rastin e shtyrjes kontrata “e vjetër” zgjatet përtej kufirit të fiksuar në fillim; në rastin e rinovimit, punëdhënësi punëson punonjësin me kontratë të re pune.

Punëdhënësi im më ka rinovuar kontratën e punës me kohë të përcaktuar pa respektuar datën e skadimit. A është e vlefshme kontrata ime me kohë të përcaktuar?

Jo, në rast se punëdhënësi nuk respekton afatet e përshkruara më sipër, kontrata e re e punës konsiderohet me kohë të papërcaktuar.

Punëdhënësi im mund t'a përfundojë para kohe kontratën?

Jo, punëdhënësi mund të ndërpresë raportin e punës vetëm për motive të rënda (giusta causa).

Jam pushuar nga puna pa arsye. A mund të bëj diçka?

Mund të kërkosh dëmshpërblim për dëmin, dhe rifutjen në vendin e punës nëse ndërmarrja ka në varësi më shumë se 15 punonjes.

A mund të përfundoj para kohe kontratën?

Jo, ashtu si edhe punëdhënësi, punonjësi nuk mund të ndërpresë raportin e punës. Në rast të kundërt, do të të zbritet nga rroga shuma e përcaktuar për mungesë paralajmërimi.



STAZH PUNE

Çfarë është stazhi formativ dhe për çfarë shërben?

Stazhi është një formë e përkohshme e futjes në tregun e punës të rinjve, e cila mund të shkojë nga një minimum prej 4 muajsh deri në një maksimum prej dy vjetësh. Stazhi nuk është punësim: shërben për tu orientuar dhe për të pasur një eksperiencë pune. Përveç kësaj, aktiviteti gjatë stazhit konsiderohet si pjesë e formimit dhe mund ta cilësosh si të tillë në Curriculum-in tënd.

Unë i ri, a mund të bëj një stazh? Për sa kohë?

Po, në rast se ke mbauar shkollën e detyrueshme dhe hyn në një prej këtyre grupeve:

- studentë që frekuentojnë shkollën e mesme: kohëzgjatja maksimale 4 muaj;
- punëtorë të papunë: kohëzgjatja maksimale 6 muaj;
- nxënës të shkollave profesionale shtetërore dhe të kurseve profesionale: kohëzgjatja maksimale 6 muaj;
- studente universitare: kohëzgjatja maksimale 12 muaj;
- persona nevojtare (invalidë, drogëmarrës, alkoolistë, etj): kohëzgjatja maksimale 12 muaj;
- persona me aftësi të kufizuara: kohëzgjatja maksimale 24 muaj.

Si stazhier, a gëzoj të drejtën e pagës?

Jo, si stazhier punon përkohësisht, kështu që ligji nuk parashikon asnjë formë pagese mbi aktivitetet që kryhen, por punëdhënësi mund të vendosë të mbulojë shpenzimet e tua nëpërmjet ndihme, cmimi, burse studimi, etj.

Vini re: Nëse je në Itali me leje qëndrimi të rregullt (p.sh. për motive studimi), mund të kryesh një stazh formativ pa patur nevojë të verifikosh disponibilitetin e kuotave. Por, nëse gjendesh jash shtetit, nuk kërkohet një autorizim (nulla osta) për punë, por duhet të kërkosh një vizë hyrjeje për motive studimi ose formacion, direkt përfaqsisë diplomatike-konsullore italiane në vendin tënd, pas aprovimit nga ana e Rajonit ku zhvillohet stazhi, të projektit formativ të redaktuar nga ai që e pro-



pozon dhe bën ftesën. Vizat lejohen brenda kufijve të një kontingjenti vjetor të përcaktuar.

Punë pjesërisht e varur (p.sh kontratë me projekt)

Çfarë është puna pjesërisht e varur?

Është një raport pune për të cilin një bashkëpunëtor, kryen aktivitetin e tij në favor të një punëdhënësi (që e koordinon), në mënyrë autonome dhe pa kufizimet e punës së varur. Me një kontratë të posaçme përcaktohen kushtet e punës dhe pagesa. Kjo kontratë, e ashtuquajtur kontratë me projekt, duhet të ketë një kohëzgjatje të përcaktuar dhe duhet të përmbajë përshkrimin e hollësishëm të projektit (apo të një faze të tij), të cilin bashkëpunëtori angazhohet ta realizojë.

Çfarë lloj leje qëndrimi të jepet nëse je një punonjës pjesërisht i varur?

Një leje qëndrimi për punë të pavarur.

Punë e pavarur

Çfarë është puna e pavarur?

Është një raport pune në të cilin një person impenjohet, kundrejt një pagese, të kryejë një shërbim në mënyrë të pavarur nga punëdhënësi. Puna e pavarur mund të ushtrohet me ose pa TVSH.

Si punon një punëtor i pavarur?

Punëtori i pavarur e organizon aktivitetin e tij në mënyrë të pavarur, duke qënë përgjegjës për kohën e harxhuar dhe vendin ku punon (natyrisht duhen respektuar kufijtë e përcaktuara në kontratë si edhe në lidhje me natyrën e aktivitetit).

PUNË E PAVARUR ME TVSH

Ku duhet të drejtohem për të hapur numrin e TVSH-së?

Duhet ti drejtoheni Zyres së Taksave kompetente për zonën në të cilën banojnë, brenda 30 ditëve nga fillimi i aktivitetit ose nga krijimi i shoqërisë. Hapja e TVSH është gratis.



NDIHMË PËR FILLIMIN E NJË AKTIVITETI TË PAVARUR

A mund të përfitoj ndonjë lehtësi?

Po, në sajë të këtyre ligjeve:

Dekreti Legjislativ 185/2000

Parashikon lehtësime për të papunët prej 6 muajsh nga data e paraqitjes së kërkesës, të cilët duan të ndërmarrin aktivitete të pavarura (individuale, në formën e mikro-ndërmarrjes ose me franchising) në sektorët e prodhimit të të mirave materiale, në shërbime dhe në tregti.

Përjashtohen këto aktivitete:

- prodhimi dhe tregëtimi i artikujve bujqësorë;
- transporti (me mjete që transportojnë më shumë 9 persona).

Informacione më të hollësishme mund të gjesh në faqen internet www.sviluppitalia.it.

Ligji 215/1992

Është krijuar për të zhvilluar ndërmarrje femërore në sektorë të ndryshëm:

- bujqësi;
- artizanat;
- tregëti, turizëm dhe shërbime.

Për të bërë kërkesën për këto lehtësime, duhet të paraqesësh dokumentat e mëposhtme:

- formularin, me të dhëna dhe informacione në lidhje me ndërmarrjen dhe programin e investimeve;
- skedën teknike, me përshkrimin e detajuar të iniciativës që propozon si dhe të dhënat ekonomiko-financiare;
- çertifikatën e regjistrimit në regjistrin e ndërmarrjeve të Dhomës kompetente të Tregtisë.

Informacione më të hollësishme mund të gjesh në faqen internet www.215.it.

Ligji 488/1992

Ligji 488 favorizon ndërmarrjet e sektorit prodhues, të shërbimeve, të ndërtimit dhe turistike të cilat duan të shtojnë investimet e tyre.

Mund të financohen të gjithë investimet në të mira materiale dhe jomateriale që ndërmarrja duhet të bëjë, që prej ditës kur bëhet paraqitja e kërkesës.



Informacione më të hollësishme mund të gjesh në faqen internet www.legge488.it.

Instrumenta Krahinorë dhe Provinciale

Janë instrumenta të organizuara nga Rajonet dhe Provinca, me qëllim financimin e projekteve dhe nismave në nivel lokal. Për informacione më të hollësishme mund të drejtohesh në sportelet e informacionit të Rajoneve ose Provincave ose në faqet e tyre në internet.

Hyrja në tregun e punës në Itali

Si mund të hyj në tregun e punës italian?

Nëpërmjet dy mënyrave:

- drejtpërdrejtë në Itali (duke respektuar saktësisht kërkesat ligjore);
- nga jashtë, nëpërmjet thirrjes individuale ose numerike.

Vini re: është e rëndësishme të mbahet në konsideratë situata familjare, p.sh. në se je një qytetar jokomunitar i martuar me një person prindërit e të cilit janë qytetarë komunitarë, ke të drejtë të punosh në Itali dhe nuk është e nevojshme të kryhet praktika e kërkesës së lejes për punë. Pra, qytetarët që ndodhen në kushte të tilla mund të fillojnë punë menjëherë në Itali. Në këtë rast, është e nevojshme marrja e një lejeqëndrimi (lejeqëndrimi BE për banorët me afat të gjatë) por ky i fundit nuk është kusht për fillimin e punës.

PËR QYTETARËT QË NDODHEN NË ITALI

A duhet të kem lejeqëndrim për të punuar në Itali?

Po: për të punuar apo për t'u rregjistruar në listat e punës me qëllim gjetjen e një pune për një punëtor të pushuar nga puna, që ka dhënë dorëheqjen apo është invalid, duhet të kesh lejeqëndrimi të lëshuar për një prej motiveve të mëposhtëm:

- punë e varur;
- punë e pavarur;
- motive familiare dhe bashkim familjar;



- azil politik;
 - mbrojtje sociale;
 - shkollim dhe formim profesional (në këtë rast mund të punosh deri në 20 orë në javë, 52 javë për një maksimum prej 1040 orë në vit);
 - pritje të punësimit në rast se i huaji është rregjistruar në listat e punësimit (attesa occupazione);
 - asistim i të miturit (prindi që asiston fëmijnë e sëmure);
- Nuk mund të punosh në rast se leja e qëndrimit është për:
- turizëm;
 - motive fetare;
 - kura mjeksore;
 - moshë të mitur;
 - kërkesë për strehim politik;
 - biznes;
 - drejtësi/paraqitje në gjyq.

Kujdes: për azilkërkuesit, në rastin kur kërkesa për azil nuk shqyrtohet brenda 6 muajve nga data e kërkesës për motive që nuk lidhen me azilkërkuesin, lejeqëndrimi i tij rinovohet për 6 muaj të tjerë duke i lejuar të huajit të kryejë një punë të varur deri në momentin e përfundimit të praktikës së tij për azil.

PËR QYTETARËT QË VIJNË NË ITALI

Si mund të hyj në tregun e punës italjan?

Hyrja në tregun e punës italjan e qytetarëve të huaj me vendbanim jashtë, bëhet çdo vit në kuadrin e “kuotave” të vendosura nga Dekreti i Flukseve i cili përcakton numrin maksimal të të huajve jokomunitarë që mund të hyjnë në Itali për punë të varur (edhe stinore) ose për punë të pavarur. Në raste të veçanta, të parashikuara nga ligji, mund të hyjet për punë në Itali edhe jashtë kuotave.

Si mund të hyj në Itali për punë varur?

Nëpërmjet një punëdhënësi në Itali i cili dëshiron të punësojë punëtorë të huaj, të cilët janë rezident në vendin e origjinës, për punë të varur, me kohë të përcaktuar, të pacaktuar apo stinore.

Sipas ligjit italjan, mund të hyjnë në Itali jashtë kuotave për punë të pavarur dhe të varur:



- drejtues/personel me kualifikime shumë të larta profesionale;
- lektorë univeristarë;
- përkthyes;
- profesorë universiteti të destinuar për të kryer në Itali një rol akademik;
- të huaj në zotërim të një titulli studimi të lartë, që e lejon në vendin e origjinës, të kryejë programe doktorature, programe studimi, në bazë të një kërkesë nga një Institut studimesh, i regjistruar në listën e Ministrisë së Arësimit, të Universitetit dhe të Punës kërkimore-shkencore;
- përkthyes
- të huaj nga 20 deri në 30 vjec, të pranuar për të marrë pjesë në programe vullnetarie pranë enteve ekleziastike të njohura nga shoqëria civile, organizata jo shtetërore dhe shoqata të promovimit social, në prezencë të një marrëveshjeje midis të huajit dhe organizatës pritëse.

Vetëm për punë të varur kategoritë e mëposhtme:

- bashkëpunëtorë familjarë që punojnë jashtë shtetit për më shumë se një vit, pranë qytetarëve italianë ose komunitarë të cilët transferohen në Itali;
- të huajt, të cilët ndjekin kurse formimi profesional, dhe që bëjnë praktikën pranë punëdhënësve italianë duke patur edhe marrëdhënie pune të varur;
- punonjës pranë organizatave ose ndërmarrjeve që punojnë në territorin italian;
- marinarët;
- punonjës pranë punëdhënësve rezidentë jashtë shtetit, që për motive pune transferohen në Itali dhe me të cilët kanë kontrata pune;
- artistët e cirkut ose të tjerë që udhëtojnë për spektakle të ndryshme;
- personel i spektakleve artistike, teknike për spektakle lirike, teatrale, koncertore dhe balet;
- balerinë, artistë, muzikantë, që punojnë pranë lokaleve të ndryshme;
- artistë që punojnë pranë enteve muzikore, teatrale dhe kinematografike, pranë radiove dhe televizioneve, me qëllim manifestime kulturore dhe folkloristike;
- sportistë profesionistë;
- gazetarë/korrespondentë zyrtarisht të njohur dhe të akredituar pranë organeve të shtypit dhe televizionit;
- persona që kryejnë kërkime në kuadrin e bashkëpunimeve të ndryshme;
- infermierë profesionistë të punësuar pranë strukturave sanitare publike ose private.



Kam gjetur një punëdhënës i cili është i gatshëm të punësojë punëtorë të huaj: si duhet të veproj?

Punëdhënësi duhet të paraqesë një kërkesë pranë Sportelit Unik për Imigracionin, ku kryhet i plotë procesi i punësimit të punëtorëve të huaj për punë të varur me kohë të caktuar dhe të pacaktuar, i ngritur pranë prefekturës -zyra territoriale e Qeverisë- të provincës ku ai është rezident, ose ku ka qëndrën ligjore të aktivitetit, ose në zonën ku do të punohet. Dokumenti duhet të përmbajë kërkesën nominative për lejen e punës – në se ka gjetur një punëtor të caktuar - ose numerike – në se nuk e njeh drejtëpërdrejtë punëtorin mund të kërkojë lejen për njërin apo më shumë punëtorë të rregjistruar në listat të pranishme pranë Përfaqsisë Diplomatike apo Konsullore italiane që përmbajnë emrat dhe skedat e te huajve që kërkojnë të punojnë në Itali.

Kërkesa duhet të përmbajë:

- Të dhënat e punëdhënësit, të titullarit apo të përfaqësuesit ligjor të shoqërisë, të vetë shoqërisë, motivin e themelimit, vendodhjen si edhe adresën e vendit të punës;
- në rastin e kërkesës nominative, të dhënat e punëtorit të huaj që punëdhënësi kërkon të punësojë si edhe adresën në vendin e origjinës ndërsa në rastin e një kërkesë numerike, numrin e punëtorëve që kërkon të punësojë;
- pagesën dhe sigurimin, ashtu si e parashikon ligji;
- impenjimin për dhënien e një banese të përshtatshme sipas kushteve për banim, higjienike dhe sanitare të parashikuara nga ligji;
- deklaratë ku punëdhënësi impenjohet të komunikojë çdo ndryshim të raportit të punës;
- deklaratë ku punëdhënësi impenjohet të përballojë shpenzimet e riatdhesimit. Me procedurën e re të informatizuar, kërkeses nuk i bashkangjitet asnjë dokument. Propozimi i kontratës së qendrimit, është pjesë integruese e kërkesës që behet nepermjet internetit Sportelit Unik për Imigracionin.

Po më pas, çfarë ndodh? Sa duhet të pres?

- Sporteli i vetëm për imigracionin i komunikon kërkesën qëndrës për punësim kompetente në provincën e vendqendrimit, e vendbanimit apo të qëndrës ligjore të kërkuarit, me përjashtim të kërkesave nominative për punëtorët stinorë;



- qëndra për punësim brenda 20 ditëve verifikon disponueshmërinë e punëtorëve italianë, komunitarë ose të huaj të cilët janë të pajisur me lejeqëndrim dhe këto të dhëna ia komunikon si sportelit të vetëm, ashtu edhe punëdhënësit të interesuar;
- kuestura verifikon në se ekzistojnë motive në drejtim të punëdhënësit apo të punëtorit të huaj të cilat pengojnë lëshimin e lejes së punës;
- Sporteli Unik brenda 40 ditësh nga paraqitja e kërkesës, pasi merr nga DPL (drejtoria provinciale e punës) aprovimin mbi kushtet kontratale të aplikueshme dhe mbi kapacitetin ekonomik të ndërmarrjes, sikurse dhe mbi konsistencën e kuotave dhe të profesioneve, dhe pasi merr aprovimin e Kuesturës, thërret punëdhënësin dhe i komunikon lëshimin e lejes, e cila është e vlefshme për një periudhë jo më të gjatë se 6 muaj nga data e lëshimit;
- vetëm pas kësaj, punëtori i huaj duhet të bëjë kërkesën për vizë pranë zyrave konsullore të vendit të tij. Konsullata i komunikon të huajit propozimin e kontratës së qëndrimit për motive pune dhe i lëshon këtij të fundit brenda 30 ditëve nga kërkesa, vizën e hyrjes dhe i komunikon kodin fiskal. Nga momenti që merr vizën, punëtori mund të hyjë në Itali;
- brenda 8 ditëve pune nga hyrja në Itali, punëtori i huaj duhet të paraqitet pranë sportelit të vetëm kompetent i cili verifikon dokumentat, dhe i lëshon të huajit çertifikatën e njohjes së kodit fiskal. punëtori i huaj, nënshkruan kontratën e qëndrimit për punë, pa bërë modifikime të reja. kontrata e qëndrimit ruhet pranë sportelit të vetëm;
- sporteli i vetëm kujdeset gjithashtu që i huaji të nënshkruaj formularin e kërkesës të lejeqëndrimit i cili i nisat kuesturës kompetente nëpërmjet përcjelljes së kit-it përkatës në një Zyre Poste.

Vini re: mund të punosh dhe të përfitosh nga të gjitha të drejtat – regjistrim anagrafik, ndryshim residence, dhënie dhe rinovim i kartës së identitetit, regjistrim në Shërbimin Shëndetsor Kombëtar (SSN), dhënia e kodit fiskal, sëmundje, lindje, shërbime ne ndihme te te ardhurave (te uleta) sikurse edhe ata që janë në pritje të rinovimit të lejes së qëndrimit – edhe n.q.s. je në pritje të lejes së qëndrimit, mjafton të kesh paraqitur kërkesen e dhënies së lejes së qëndrimit në Sportelin Unik për Imigracionin brenda 8 ditësh nga hyrja jote në territorin kombëtar dhe që të kesh nënshkruar kontratën e qëndrimit. Duhet të demonstrosh kopjen e modelit të kërkesës së lejes së qëndrimit të



lëshuar nga Sporteli Unik për Imigracionin dhe modulën e Postës që vërteton faktin që kërkesa është paraqitur.

Vini re: punëdhënësi është i detyruar t'i komunikojë Sportelit Unik brenda 5 ditësh:

- fillimin e punës;
- datën e mbylljes së raportit të punës;
- transferimin e punëtorit të huaj (në rast se transferohet).

Punëdhënësi ka gjithashtu për detyrë t'i bëjë një komunikim të detyrueshëm Zyrës së Punësimit për marrjen në punë të paktën një ditë para fillimit të raportit të punës. Me inserimin e komunikimit unik, komunikimi që i bëhet Zyrës së Punësimit vlen edhe për regjistrimin në INPS dhe INAIL. Vetëm për punonjësit shtëpijakë komunikimi i bëhet Inps-it nëpërmjet një moduli të posaçëm që shkarkohet nga www.inps.it.

Si hyjet në Itali për punë stinore?

Punëdhënësi duhet të ndjekë të njëjtën praktikë sikurse për punën e varur. Sporteli Unik lëshon lejen jo më gjatë se 20 ditë nga data e paraqitjes së kërkesës për punësim nga punëdhënësi. Në këtë rast leja ka vlerë nga 20 ditë deri në 9 muaj nga data e nënshkrimit të kontratës së qëndrimit.

Jam një punëtor stinor: mund të vij përsëri në Itali vitin e ardhshëm?

Po, si punëtor stinor ke të drejtën e përparësisë për të ardhur përsëri në Itali vitin e ardhshëm, për punë stinore në dallim nga punëtorët e tjerë, të cilët vijnë nga vendi yt për herë të parë në Itali.

Si hyhet në Itali për punë të pavarur?

Mund të hyhet nëpërmjet kuotave ose jashtë kuotave, megjithëse mundësia e fundit është shumë e kufizuar në praktikë.

Për të ushtruar një aktivitet jo të rastësishëm pune të pavarur, duhet të pajisesh me vizë për punë të pavarur. Duhet të provosh, gjithashtu që ke mjete financiare të përshtatshme për këtë aktivitet si edhe që aktiviteti që dëshiron të ushtrosh nuk parashikohet me ligj vetëm për qytetarët italianë apo komunitarë.



Vini re: sëbashku me dekretin e flukseve përcaktohen kategoritë e punonjësve autonomë që mund të hyjnë në Itali. Në vitet e fundit janë parashikuar këto lloje: profesionistë të lirë, sipërmarrës që kryejnë aktivitete me interes kombëtar, ortakë të shoqërive jo kooperative të krijuara prej të paktën 3 vitesh, artistë me famë të ndritur ndërkombëtare dhe punonjës shkencorë.

Si duhet të veprojmë për të marrë vizën për punë të pavarur?

Në rast se mendon të ushtrosh në Itali një aktivitet pune të pavarur jo të rastësishme si edhe në se bën pjesë në kuotat e parashikuara për punë të pavarur nga dekreti i flukseve në fuqi, duhet të paraqesësh pranë Kuesturës kompetente, me qëllim marrjen e lejes provizore të punës që të lejon hyrjen në Itali, dokumentat në vijim:

- deklaratë mbi mungesën e pengesave në dhënien e lejes së lëshuar nga administrata kompetente;
- deklaratë mbi parametrat e referimit, e lëshuar nga Dhoma e Tregëtisë, Industrisë, Artizanatit dhe e Agrikulturës apo nga Urdhëri Profesional kompetent në zonën ku do të kryhet aktiviteti i pavarur, ose pranë urdhërit profesional kompetent, çertifikatën që dëshmon disponueshmërinë e burimeve financiare të nevojshme për aktivitetin. I huaji, i cili është i interesuar për fillimin e një aktiviteti të pavarur, duhet të disponojë një shumë të hollash, në bazë vjetore, jo më të vogël se çeku social;
- deklaratë mbi përgjegjësitë, e lëshuar nga Inspektoriat i kompetent i punës (në rastin e hyrjes në bazë të një kontratë me projekt);
- deklaratë e atij që të jep punën, i cili të siguron një pagesë më të lartë se minimumi i parashikuar për mbulimin e shpenzimeve shëndetësore;
- kopje e bilancit të fundit të paraqitur në rregjistrin e shoqërive;
- disponueshmëri e një banese të përshtatshme;
- leja nga Kuestura kompetente.

Nëse banon jasht shtetit mund të delegosh (me një dokument të përkthyer e të legalizuar) një person tëndin të besuar për të kërkuar dokumentat e nevojshme. Pasi të kesh marrë çertifikatën që dëshmon disponueshmërinë e burimeve financiare të nevojshme për ushtrimin e aktivitetit, mund të bësh kërkesë për marrë vizë hyrjeje për punë të pavarur, pranë autoriteteve diplomatike dhe konsullore kompetente sipas kombësisë apo rezidencës. Viza lëshohet brenda 120 ditësh nga paraqitja e kërkesës dhe duhet të përdoret brenda 180 ditësh.



A mund të më refuzohet viza nga ana e autoriteteve diplomatike italjane?

Po. Lëshimi i vizës mbetet në diskrecionin e autoriteteve diplomatike-konsullore. Refuzimi duhet të jete gjithmonë i shkruar dhe i motivuar. Në rastin e kërkesës së vizës së hyrjes që nuk është për punë, bashkim familjar apo studim, refuzimi per arsye te sigurimit apo te rendit publik, mund të mos jetë i motivuar.

Pasi kam hyrë në Itali me vizë për punë të pavarur, si duhet të veproj?

Duhet të marrësh lejeqëndrimin për punë të pavarur, në të njëjtën mënyrë si një punëtor i varur, brenda 8 ditë pune prej hyrjes në Itali duke dërguar Kit-in e posacëm në Zyrën e Postës..

Me lejeqëndrimin a mund të kryej çdo lloj pune të pavarur?

Lejohet çdo lloj aktiviteti jo i rastësishëm dhe i pavarur me kusht që të mos i takojë me ligj vetëm qytetarëve italianë ose të BE-së. Në çdo rast, i huaji duhet të tregojë që ka burime ekonomike të mjaftueshme për aktivitetin që dëshiron të fillojë në Itali.

Me një lejeqëndrim për punë të pavarur punëtori mund të kryej dhe një aktivitet pune të varur duke u punësuar në këtë mënyrë nga një punëdhënës, pa patur nevojë të shfrytëzojë sistemin e kuotave të hyrjes.

Çfarë vlefshmërie ka lejeqëndrimi?

Lejeqëndrimi ka një vlefshmëri maksimale prej 2 vjetësh.

A mund të rinovohet lejeqëndrimi?

Po, në rast se vërteton se ka prodhuar të ardhura të mjaftueshme gjatë periudhës në të cilën ka qënë i vlefshëm lejeqëndrimi dhe gjatë të cilës ka ushtruar aktivitet pune të pavarur.

Fillimi i një raporti pune

KONTRATA E PUNËS

Si punonjës i huaj, në momentin e punësimit ke të drejtë të informohesh në lidhje me kushtet e punës, të cilat duhet të përcaktohen në një dokument të shkruar:



- cili është punonjësi;
 - cili është punëdhënësi;
 - ku ndodhet vendi i punës;
 - sa është kohëzgjatja e punës;
 - sa është kohëzgjatja e periudhës së provës;
 - cili është orari i punës;
 - pozicioni i punës, niveli dhe kualifikimi i punëtorit;
 - sa është paga;
 - sa është kohëzgjatja e pushimeve të paguara;
 - cilët janë kufijtë kohorë brenda të cilëve mund të ndërpritet raporti i punës.
- Vini re:** Në momentin e përzgjedhjes, punëdhënësi nuk mund të të drejtojë pyetje mbi bindjet e tua politike, fetare, gjendje shtatzanie apo sieropozitiviteti (principi i mos diskriminimit).

PËRFUNDIMI I NJË RAPORTI PUNE

HIPOTEZA 1: DORËHEQJA

Si duhet të veproj për të dhënë dorëheqjen nga puna?

Duke respektuar gjithmonë periudhën e paralajmërimit, duhet të paraqesësh në formë të shkruar dorëheqjen tënde, nëpërmjet një letre në dy kopje, ku duhet të pëcaktohen:

- të dhënat mbi shoqërinë të cilës i drejtohet letra;
- vendi dhe data;
- firma jote;
- firma e punëdhënësit.

Duhet të respektoj me doemos periudhën e paralajmërimit?

Periudha e paralajmërimit përcaktohet në fillim të raportit të punës ose parashi-kohet në kontratën kolektive. Në se nuk e respekton, duhet të paguash një gjobë të barasvlefshme me pagën që do të merrje gjatë periudhës së paralajmërimit.

Punëdhënësi mund të mos e pranojë paralajmërimin?

Po, në këtë rast mund të pranosh tërheqjen e menjëheshme me të drejtën e dëmshpërblimit.



Në rast se punëdhënësi nuk i ka përmbushur detyrimet e tij (giusta causa), a jam i detyruar të respektoj periudhën e paralajmërimit?

Në këtë rast, mund të ndërpresësh menjëherë punën, pa respektuar periudhën e paralajmërimit, pasi ekziston një motiv i fortë (giusta causa).

HIPOTEZA 2: PUSHIMI NGA PUNA

Në se jam i punësuar pranë një ndërrmarjeje të vogël dhe pushohem nga puna pa të drejtë, kam të drejtë të dëmshpërblehem?

Po. Në ndërrmarje të vogla punëdhënësi mund të zgjedhi ndërmjet punësitimit përsëri të punonjësit, i cili është pushua nga puna pa të drejtë, brenda 3 ditëve, ose të paguaj një dëmshpërblim nga një minimum prej 2,5 deri në një maksimum prej 6 pagash mujore.

Në se jam i punësuar pranë një ndërrmarjeje të madhe dhe pushohem nga puna pa të drejtë, kam të drejtë të dëmshpërblehem?

Po. Në ndërrmarje të mëdha (me më shumë se 15 vartës në të njëjtën komunë ose me më shumë se 60 vartës në përgjithësi), punonjësi, në rast pushimi nga puna të paligjshëm, ka të drejtë të rifillojë punën si edhe të dëmshpërblehet me të paktën 5 paga mujore.

Si të veproj për të kundërshtuar pushimin tim nga puna?

Duhet të paraqesësh një dokument të shkruar që sqaron vullnetin tënd për të kundërshtuar pushimin nga puna, psh një kërkesë për të filluar procedurën e detyruar të pajtimit.

Brenda çfarë afati kohor duhet të kundërshtoj pushimin tim nga puna kur konsiderohet i paligjshëm?

Në se e konsideron të paligjshëm pushimin nga puna, duhet ta kundërshtosh brenda 60 ditëve nga dita që të është komunikuar pushimi nga puna, përndryshe e humbet të drejtën e mbrojtjes që të garanton ligji.

A mund të më pushojë nga puna punëdhënësi për fakte që ndodhin jashtë punës?

Mund ta bëjë këtë gjë vetëm në rast se këto fakte janë të lidhura ngushtësisht me punën.



Në cilat raste është i lejuar pushimi “i menjëhershëm” nga puna (pa paralajmërim)?

Vetëm atëherë kur verifikohet një arsye e drejtë (giusta causa), dmth kur ndodh një gjë shumë e rëndë që bllokoi raportin e punës.

Shërbimet për punësim

Çfarë janë shërbimet e punës dhe për çfarë shërbejnë?

Shërbimet e punës janë struktura publike që kanë zëvendësuar zyrat e punës (uffici di collocamento). Janë kjuar për të ndihmuar kryqëzimin e kërkesës dhe ofertës për punë, për të parandaluar papunësinë dhe për të ndihmuar hyrjen në tregun e punës të personave që rrezikojnë të mbeten të papunë.

Si mund të përfitoj nga këto shërbime?

Duhet të regjistrohesh në të ashtuquajturën “lista e emrave” që ka zëvendësuar “listat e vjetra të punës”. Të dhënat e tua do të përmbliidhen në:

- një skedë ku do përfshihen së bashku me të dhënat e tua edhe ato të familjes, diplomat e studimit dhe gjendja jote e punësimit;
- një skedë profesionale (“libreza e punës” e mëparshme), me informacione mbi eksperiencat e tua formative dhe profesionale, disponueshmëria jote dhe çertifikimi i kompetencave të tua profesionale.

KËRKIMI I PUNËS

Çfarë është “gjendja e papunësisë”?

Është gjendja në të cilën ndodhet një person i cili nuk ka punë por që është në kërkim të saj dhe i disponueshëm për të punuar.

Si mund të përfitoj gjendjen e papunësisë?

Duhet të paraqitesh në Zyrën e Punës të qytetit në të cilin banon dhe të bësh një deklaratë që vërteton:

- punët që ke bërë më parë;
- disponueshmërinë tënde të menjëhershme për të punuar.



Në rast se humbas vendin e punës ose jap dorëheqjen, a humbas edhe regjistrimin në listën e emrave?

Në se ke një lejeqëndrim për punë të varur dhe humbet punën, ose jep dorëheqje, e ruan regjistrimin për gjithë kohëmbetjen e lejeqëndrimit tënd. Madje, në bazë të ligjit mbi imigracionin, ke të drejtë të kërkosh punë, si i papunë, për një periudhë jo më të shkurtër se 6 muaj (d.m.th. edhe kur të skadojë lejeqëndrimi). Në se, në përfundim edhe të këtij të fundit, nuk ke mundur të punësohesh, duhet të kthehesh në vendin tënd.

Kam një lejeqëndrim të rregullt dhe kërkoj punë. Kujt mund ti drejtohem në mënyrë që të vihem në kontakt me ndërmarrjet që duan të punësojnë personel?

Ligji ju garanton punëtorëve të huaj që banojnë rregullisht në Itali si edhe familjeve të tyre, të njëjtin trajtim dhe të drejta si edhe punëtorëve italianë. Dmth ashtu si edhe italianët, të huajt mund ti drejtohen:

- shërbimeve Publike për Punësim (Qëndrat e Punës, Komunat, Universitetet, Dhomat e Tregëtisë);
- ose Shërbimeve private për Punësim (Agjensive për punë dhe operatorëve të tjerë).

Çfarë janë Qëndrat e Punës, ku ndodhen dhe çfarë shërbimesh ofrojnë?

Qëndrat e punës janë struktura publike dhe gjenden në gjithë Italinë. Ofrojnë shërbime të tipeve të ndryshme:

- pritje, informacione dhe orientim për ata që kërkojnë punë;
- ndërmjetësim midis kërkesës dhe ofertës së punës;
- konsulencë për ndërmarrjet.

Ku ti gjej oraret dhe adresat e Qëndrave për punë në Krahinën time?

Mund ti drejtohesh zyrave të Provinces ku banon, ose internetit.

Çfarë janë agjensitë e punës?

Këto agjensi janë struktura private të autorizuara që merren me kërkimin dhe seleksionimin e personelit, ndërmjetësojnë midis kërkesës dhe ofertës për punë, gjejnë fuqinë punëtoare, etj.



Punëtorët dhe ndërmarrjet a mund të shkëmbejnë oferta dhe kërkesa pa ndërmjetësinë e të tjerëve?

Po, nëpërmjet Bursës së Punës: një sistem informimi për kryqëzimin e kërkesës dhe ofertës, sistem i cili mund të kontrollohet si nga ndërmarrjet ashtu edhe nga punëtorët. Për më shumë informacion, shiko faqen në internet *www.welfare.gov.it*



Usare la testa, si deve.



Evitare la croce, si può.



SICUREZZA. DOVERE ASSOLUTO, DIRITTO INTOCCABILE.

IO LAVORO SICURO.

La sicurezza è un diritto che ogni datore di lavoro ha l'obbligo di garantire ai suoi lavoratori. E tu lavoratore pretendi gli strumenti di protezione, usali sempre, e denuncia chi mette a repentaglio la tua vita. Perché gli incidenti li puoi evitare, a te e agli altri.

**PUBBLICITÀ
P
PROGRESSO**
Fondazione per la
Comunicazione Sociale

Per saperne di più vai su www.iolavorosicuro.it



IO LAVORO SICURO.

10 PUNTI FERMI PER LA SICUREZZA SUL LAVORO.

**PUBBLICITÀ
P
PROGRESSO**
Fondazione per la
Comunicazione Sociale

CON IL PATROCINIO DI



Ministero del Lavoro, della Salute e delle Politiche Sociali

Pagina a cura dell'*INAIL*

e

PUBBLICITÀ PROGRESSO



1 SIGURIA NË PUNË ËSHTË DETYRË PËR TË GJITHË.

Normativa në fuqi parashikon një sistem të organizuar për parandalimin dhe aksidenteve dhe për sigurinë në punë, që nitë pjesëmarrjen aktive të punonjësve dhe bashkëpunimin e të gjithë subjekteve që marrin pjesë (**punëdhënësin, shërbimin për parandalimin dhe mbrojtjen, punonjësin, mjekun përkatës, përfaqësuesin e punonjësve për sigurinë**).

2 TË PUNOSH NË TË ZEZË NUK DO TË THOTË SE PUNON NË MËNYRË TË SIGURT.

Kush punon në të zezë nuk mund të marrë një formim dhe kualifikim të rrishtatshëm. Nuk është e mundur të regjistrojë historinë e aktivitetit të tij në punë; pra të kontrollojë që të jenë vënë në jetë të gjitha masat për mbrojtjen e integritetit të tij.

3 ËSHTË E DOMOSDOSHMË TË PËRCAKTOJMË DHE VLERËSOJMË PARAPRAKISHT RREZIQET E AMBIENTIT TË PUNËS DHE TË PUNIMEVE TË VEÇANTA.

Punëdhënësi (me ndihmën e "Shërbimit të parandalimit dhe mbrojtjes") vlerëson rreziqet në vendin e punës dhe të detyrave që kryhen nga punonjësit, duke i informuar në lidhje me rreziqet që u kanosen atyre. **Punonjësi** njihë këstu rreziqet në lidhje me aktivitetin e tij të punës dhe modalitetet korrekte të përdorimit të instrumenteve, të veglave dhe të makinerive që përdor për të kryer punën e tij.

4 ËSHTË E DETYRUESHME TË VIHEN NË JETË MASAT PËR TË ELIMINUAR OSE PËR TË ZVOGËLUAR RREZIQET.

Punëdhënësi përdor masat e duhura të sigurisë për parandalimin dhe aksidenteve dhe të fatkeqësive në vendin e punës, përfshirë iniciativat organizative dhe të administrimit. Atje ku rreziku i punimeve është objektivisht i pamundur që të eliminohet, punëdhënësi është i detyruar që ta zvogëlojë atë sa më shumë që jetë e mundur.

5 FORMIMI ËSHTË NJË E DREJTË PËR PUNONJËSIN DHE NJË DETYRË PËR PUNËDHËNËSIN.

Formimi i punonjësve është në ngarkim të punëdhënësit dhe duhet t'i referohet vendit të punës dhe profesionit. Veçanërisht duhet të bëhet me rastin e:

- punësimi;
- transferimit ose ndërrimit të detyrave;
- futjes së instrumenteve të ri për punë, përdorimin e substancave të reja ose të preparateve të rrezikshme.

Formimi duhet të bëhet periodikisht dhe sa herë që ka një evolucion të rrezikëve ose paraqitje të rrezikëve të reja.

6 NË VENDET E PUNËS DUHET TË JENË TË PRANISHËM DHE TË EKSPOZOHEN NË MËNYRË KORREKTE TË GJITHA SINJALET E NEVOJËSHME TË SIGURISË.

Punëdhënësi ka detyrë të përdorë sinjalizimet e sigurisë sa herë që gjendet përballë rrezikëve që nuk mund të shmangen ose të eliminohen në mënyrë të menjpueshme. Punëdhënësi merr masa që punonjësit të jenë të informuar dhe të formohen në lidhje me kuptimin e tabelave dhe në lidhje me veprimet që duhet të bëhen. Sinjalet e sigurisë ndahen në:

- sinjalet ndaluese (tregojnë qëndrime të rrezikshme), me ngjyrë të kuqe;
- sinjalet përshkuese (tregojnë qëndrime ose veprime që duhen marrë), me ngjyrë bojë qielli;
- sinjalet paralajmëruese (tregojnë kujdes, vëmendje), me ngjyrë të verdhë ose portokalli;
- sinjalet të shpëtimit dhe të ndihmës së shpejtë (tregojnë dyer, dalje, rrugëdalje, materiale, pozicione), me ngjyrë jeshile;
- sinjalet kundra zjarrit (tregojnë vendet ku janë të vendosur materialet dhe pajisjet kundra zjarrit);
- sinjalet me gjeste (shërbejnë për të drejtuar personat dhe për të bërë manovrat e caktuara).

7 PUNËDHËNËSI DUHET T'I FURNIZOJË PUNONJËSIT, TË CILËT KANË PËR DETYRË T'I PËRDORIN, ME PAJISJET PËR MBROJTJEN INDIVIDUALE PMI (DISPOSITIVI DI PROTEZIONE INDIVIDUALE - DPI).

DPI (PMI) janë pajisje të ndërtuara për t'u përdorur dhe mbajtur nga punonjësit me qëllim që t'i mbrojnë ata kundra rrezikëve që kërcënojnë shëndetin e tyre dhe sigurinë gjatë punës. Tipologjitë dhe karakteristikat ndryshojnë sipas tipit të aktivitetit që zhvillohet dhe të rrezikut në lidhje me të. Ato që përdoren më shumë janë: helmela (kaska), rripi i sigurimit, këpuçet me majë që nuk shpohet dhe majë celiku, doreza, veshje të veçanta sipas nevojës (kundra motit të keq, kundra zjarrit, ftoreshte, etj.), syze, maska me nivele të ndryshme mbrojtëse për rrugët e frymëmarrjes sipas substancave të pranishme në vendin e punës, maska për fytyrën, kujtje për të mbrojtur dëgjimin; Pajisjet e mbrojtjes individuale (DPI) duhet të vihen në dispozicion të punëdhënësit. Punëdhënësi merr masa për ushtrimin e punonjësve në lidhje me përdorimin korrekt të vetë pajisjeve mbrojtëse individuale (DPI); Punonjësit kanë për detyrë t'i përdorin pajisjet mbrojtëse individuale DPI, dhe të mos i bëjnë me iniciativën e tyre modifikime, për të mos vënë në rrezik shëndetin dhe sigurinë e tyre dhe të personave të tjerë.

8 ËSHTË E DOMOSDOSHMË TË DJMË PARAPRAKISHT KUJT T'I DREJTOHEMI NË RAST EMERJENCE DHE ÇFARË VEPRIMESH DUHET TË BËJMË.

Punonjësit duhet të njohin emrat e **personave të ngarkuar për ndihmë e parë, të atyre që janë caktuar për emergjencat** dhe për parandalimin e zjarreve, të "**përgjegjësit të shërbimit të parandalimit dhe mbrojtjes**" dhe të "**mjekut përkatës**". Punonjësit duhet të jenë të informuar dhe të formohen në lidhje me veprimet që duhet të bëjnë në situatat e mundshme të rrezikut dhe të emergjencës.

9 ASNJERI NUK DUHET TË VEJË NË RREZIK JETËN E TIJ OSE JETËN E TË TJERËVE ME SJELLJET E TIJA TË PAPERJEGJËSHME.

Përveç respektimit të detyrimeve ligjore, sjellja korrekte e punëdhënësit dhe e punonjësit do të kontribuojë që të përmirësojë kushtet e përgjithshme të sigurisë. Përveç kësaj punonjësi duhet të njohë dhe të respektojë të gjitha procedurat për të mos vejë në rrezik shëndetin e tij dhe të tjerëve. Shmangia e aksidenteve është një detyrë për të gjithë.

10 KUSHTET E SIGURISË NË VENDIN E PUNËS DHE EFEKTSHMËRIA E MASAVE MBROJTËSE DUHET TË KONTROLLOHEN NË MËNYRË PERIODIKE.

Respektimi i kushteve të sigurisë në punë është një e drejtë-detyrë e të gjithë punonjësve dhe një detyrim i domosdoshëm për punëdhënësit. Kontrolli i respektimit të normave që kanë qëllim mbrojtjen e shëndetit dhe sigurinë në vendet e punës (vizitat mjekësore që bëhen rregullisht, makineritë dhe vegjat sipas normave ligjore, formimi, sinjalizimet, pajisjet e përshkueshme për mbrojtjen individuale, etj.) është një e drejtë që mundet dhe duhet të ushtrohet gjithmonë.

sistemi
përkrahjes shoqërore
dhe i sigurimeve

sistemi
përkrahjes shoqërore
dhe i sigurimeve

INPS dhe INAIL

Çdo qytetari, e për pasojë edhe të huajve që punojnë në Itali, u garantohen mjetet e jetesës në rast sëmundjesh, aksidenti në punë, invaliditeti, pleqërie, dhe papunësie të pavarur.

Subjektet që kryejnë këto funksione janë INPS dhe INAIL. Të dyja subjektet mbulojnë shërbime si pensionin, dëmshpërblime dhe kontribute të tjerë financiarë për aksidentime, sëmundje ose mbarim të raporteve të punës si pasojë e pleqërisë apo invaliditetit. Edhe familjarët marrin përkrahje shoqërore në rastin e vdekjes së punonjësit të siguar. Të huajt mund të marrin ndihmë shoqërore edhe për sëmundje ose për aksidente në punë.

Çfarë është INPS?

Instituti Kombëtar i Përkrahjes Shoqërore siguron gati të gjithë punonjësit e varur të sektorit privat, pjesën më të madhe të punonjësve të pavarur, punonjësit para të varur, si dhe disa punonjës të sektorit publik.

Aktiviteti kryesor i Institutit është likuidimi dhe pagesa e pensioneve në kuadër të përkrahjes shoqërore dhe ekzistencës.

Të parat janë:

- pensioni i pleqërisë;
- pensioni i vjetërsisë;
- pensioni për të mbijetuarit;
- pensioni për paaftësi;
- çeku për invaliditet;
- pensioni për punën e kryer jashtë vendit të origjinës, sipas konventave ndërkombëtare.

Të dytat janë:

- çeku social;
- çeku për bërthamën familjare;
- invaliditeti civil.

Instituti kryen edhe shërbime në mbështetje të të ardhurave (për papunësi, sëmundje, shtatëzani, arkën e integritetit të fitimeve, lëvizshmëri dhe trajtim në fund të raportit të punës) dhe mundëson vizitat mjeksore me qëllim shqyrtimin e invaliditetit dhe të paaftësisë për punë.



Edhe nëse je në fazë të rinovimit të lejes së qëndrimit, ose në pritje të lëshimit të lejes së parë të qëndrimit, ke të drejtë të ushtrosh rregullisht aktivitetin e punës dhe të përfitosh nga shërbimet e lidhura me të (sëmundje, shtatzani, shërbime në mbështetje të të ardhurave) me kusht që të zotërosh dokumentet e duhura që demostrojnë që të kesh kërkuar rinovimin apo dhënien brenda kushteve të përcaktuara me ligj (kopjen e lejes së vjetër të qëndrimit dhe të kuponit të kërkesës së rinovimit në rastin e parë; ose kopjen e modelit të kërkesës së lejes së qëndrimit të lëshuar nga Sporteli Unik për Imigracionin dhe kopja e kuponit të paraqitjes së kërkesës në rastin e dytë).

Çfarë është INAIL?

Instituti Kombëtar për Ndhimën ndaj Aksidenteve në Punë dhe Sëmundjeve Profesionale merret me sigurimin e detyrueshëm, në dobi të punonjësit, kundër aksidenteve në punë dhe sëmundjeve profesionale.

Në veçanti INAIL merret me:

- garantimin e shërbimeve ekonomike, shëndetësore dhe integrative;
- informimin dhe formimin, për ndërmarrjet e mesme dhe të vogla, mbi parandalimin e aksidenteve në vendet e punës;
- sigurimin e riaftësimit dhe rifillimin e punës nga ana e punonjësit.

Sistemi i përkrahjes shoqërore (INPS)

KONTRIBUTET

Si llogariten kontributet?

INPS i përballon shërbimet që kryen në sajë të kontributeve që derdhen në të. Mënyrat e llogaritjes, shumat dhe subjektet që duhet ta derdhin atë si edhe kufijtë kohorë të pagesës së kontributeve ndryshojnë sipas llojit të punësimit: punë e varur apo e pavarur.

Cilat janë subjektet ku duhen derdhur kontributet?

INPS për shërbimet e përkrahjes sociale.

INAIL për sigurimin kundër aksidenteve dhe sëmundjeve profesionale.

Ka edhe subjekte të tjera për përkrahjen sociale të kategorive të veçanta të



punonjësve (psh. Instituti Kombëtar i Përkrahjes për Vartësit e Administratës Publike – INPDAP).

Cilat janë periudhat kohore që përfshihen automatikisht në kontributet e vjetërsisë në punë?

Periudhat kohore që përfshihen automatikisht në kontributet e vjetërsisë në punë me kërkesën e të interesuarit janë:

- shërbimi ushtarak;
- leja e lindjes;
- sëmundjet dhe aksidentimi;
- shërbimi civil;
- leja për periudhat e largimit nga puna për të kryer funksione sindakale;
- leja për periudhat e largimit nga puna për të kryer funksione publike.

Periudhat kohore që përfshihen automatikisht në kontributet e vjetërsisë janë për:

- papunësi të paguar (disoccupazione indennizzata);
- rregjistrim në arkën e integritit të fitimeve (cassa integrazione guadagni);
- lëvizshmëri (konsulto seksionin: Puna);
- tuberkuloz.

Çfarë është përkrahja shtesë?

Përkrahja shtesë apo përkrahja plotësuese është kontributi i cili pagohet në bazë vullnetare apo së bashku me pjesën e sigurimeve të detyrueshme duke i lejuar, në këtë mënyrë, punonjësit një pension më të përshtatshëm për kushtet dhe kërkesat e jetës së tij. Për pasojë pensioni i tij është më i lartë.

PENSIONI

Kush ka të drejtë të përfitojë pension?

Të gjithë punonjësit me kontratë pune të varur pa dallim seksi dhe kombësie.

Punëdhënësit duhet të derdhin kontributet shoqërore për pensionin e punonjësve.



Çfarë moshe duhet të kem për të marrë pension?

Pensioni i pleqërisë merret pasi të jetë mbushur mosha e parashikuar me ligj e cila aktualisht është 65 vjeç për burrat dhe 60 për gratë dhe duhet të jenë derdhur kontribute për të paktën 20 vjet.

Pensioni i pleqërisë, sipas sistemit kontributiv, mund të merret edhe në moshën 57 vjeçare, si për burrat ashtu edhe për gratë, të cilët kanë paguar kontribute për të paktën 5 vjet, kjo në rast se pensioni nuk është më i ulët se çeku social i rritur në masën 20%. Kjo nuk vlen për punonjësit që kanë mbushur të paktën 65 vjeç.

Pensioni i vjetërsisë mund të merret përpara se të jetë mbushur mosha për pension. Aktualisht këkesat janë 35 vjet kontribute dhe mosha 57 vjeç. Në se personi nuk ka mbushur ende 57 vjeç mund të marrë pensionin e vjetërsisë në rast se ka derdhur kontribute për të paktën 38 vjet.

Si llogaritet pensioni?

- Në sistemin e pagesës pensioni përbëhet nga dy elementa:
- pagesa e llogaritur në bazë të të mesmes të pagesave të javëve të fundit përpara pensionit dhe vjetërsisë të punës sipas kontributeve;
- në sistemin kontributiv pensioni përbëhet nga shuma e kontributeve të derdhura, të rivlerësuara. Shuma individuale e kontributeve shumëzohet me koeficientin e transformimit relativ duke konsideruar moshën e personit të siguruar si edhe datën e pensionit.

A mund të dal në pension para kohe?

Po, në rast se raporti i punës përfundon për arsye shëndetësore.

Në këtë rast mund të kërkohet pensioni i invaliditetit dhe çeku i invaliditetit.

Vini re: Pensioni i parakohshëm mund të kërkohet vetëm nga titullarët e lejqëndrimit BE për banorët me afat të gjatë.

Nga se është i përbërë pensioni?

Pensionet që derdh INPS janë të përbërë nga pensioni bazë, nga çeku për bërthamë familjare në se është i nevojshëm dhe nga pagesa e 13-të e vitit. Pensionet që derdhen nga subjekte të tjerë publikë përbëhen nga pensioni bazë, nga kontributet integrative speciale, nga kuotat familjare për bashkës-



hortin dhe çdo fëmijë apo prind në ngarkim në se është e nevojshme si edhe nga pagesa e 13 e vitit.

Çfarë është pensioni për të mbijetuarit?

Është pensioni që rastin e vdekjes së punonjësit të siguruar apo të pensionistit i kalon personave që kanë të drejtë ta gëzojnë atë.

Të mbijetuarve i takon:

- pensioni i tejtkthyer në rastin kur personi që nuk jeton më ishte pensionist;
- pensioni indirekt në rastin kur personi, në momentin e vdekjes, punonte. Në këtë rast, personi që nuk jeton më duhet të ketë derdhur kontribute për të paktën 15 vjetose duhet të jetë i siguruar prej të paktën 5 vjetësh prej të cilave 3 vjet në pesëvjeçarin përpara vdekjes.

PAaftësia për punë

Çfarë është pensioni për paaftësi për punë?

Është një pension që u takon punonjësve të varur apo të pavarur, të cilët vuajnë nga një sëmundje fizike ose mendore dhe kanë derdhur kontribute për të paktën 5 vjet (260 javë kontribute), prej të cilave kontributet e 3 vjetëve (156 javë) të jenë derdhur në 5 vjet përpara kërkesës për pension për paaftësi. Paaftësia fizike ose mendore duhet të shqyrtohet nga mjekët e INPS-it dhe duhet të jetë e tillë që të provokojë një paaftësi absolute dhe të përhershme për kryerjen e çdo lloj pune.

Çfarë është çeku i invaliditetit?

Është një çek që u takon punonjësve të varur apo të pavarur, të cilët vuajnë nga një sëmundje fizike ose mendore dhe kanë derdhur kontribute për të paktën 5 vjet (260 javë kontribute), prej të cilave kontributet e 3 vjetëve (156 javë) të jenë derdhur në 5 vjet përpara kërkesës për pension për paaftësi.

Paaftësia fizike ose mendore duhet të shqyrtohet nga mjekët e INPS-it dhe duhet të jetë e tillë që të provokojë një paaftësi absolute dhe të përhershme për kryerjen e çdo lloj pune.



Çeku i invaliditetit mund t'i jepet edhe personave që vazhdojnë të punojnë.

Si duhet të veprojmë për të m'u njohur invaliditeti?

Duhet të bësh kërkesën pranë Qendrës Shëndetësore Vendore (ASL) në zonës e rezidencës.

Në rast se gjendja shëndetësore ose dëmtimi përkeqësohen, i interesuari mund të paraqesë kërkesë të re pranë Qendrës Shëndetësore Vendore.

Ekzistojnë shkallë të ndryshme invaliditeti?

Po, në bazë të shkallës së invaliditetit përfiton të drejtat e mëposhtme:

- pagesë mujore të asistencës ose të drejtën për shoqërim (drejtohu në INPS); Kjo e drejte i jepet edhe titullarëve të një leje qëndrimi që demonstron karakterin jo periodik dhe jo me afat të shkurtër të vetë lejes;
- nuk paguan ticket shëndetësor (drejtohu në ASL);
- pagesë të reduktuar të transportit publik (drejtohu në entet vendore të transportit publik);
- tabelë dalluese për automjetin që e lejon të parkojë në zona të veçanta (drejtohu në Zyrën e Invalidëve të lagjes ku je rezident);
- proteza (drejtohu në ASL).

NDIHMË PËR PAPUNËSINË

Çfarë ndodh në rast papunësie?

INPS, në rast pushimi nga puna ose dorëheqjeje, jep një dëmshpërblim, me kusht që të jenë derdhur kontribute prej të paktën 2 vitesh, nga të cilët njëri vit para dorëheqjes ose pushimit nga puna.

Kërkesa duhet paraqitur brenda 68 ditësh nga përfundimi i raportit të punës dhe shuma e kontributit derdhet për një periudhe maksimale prej 180 ditësh.

Arka e INPS-it paguan punonjësit në rast se:

- pushohet nga puna;
- kryhet rikonstrukcioni ose rikonvertimi industrial i vendit të punës;
- ka krizë të sektorit në të cilin punon (në këtë rast kontributi nuk mund të jepet më shumë se për 2 vjet).



FORMA TË TJERA PËRKRAHJEJE: ÇEKU (ASSEGNI)

Çfarë është çeku për bërthamë familjare?

Është një shumë të hollash që shkon në ndihmë të punonjësit ose pensionistit për të përballuar shpenzimet familjare. Shuma e këtij çeku varet nga numri i komponentëve familjarë dhe nga të ardhurat e përbashkëta të tyre. Çekun familjar mund ta marrin vetëm ata që kanë familje në ngarkim. Derdhen e tij e bën INPS-i.

Çfarë është çeku shoqëror?

Çeku shoqëror është një shumë që i derdhet personave që plotësojnë disa kërkesa:

- ka moshë mbi 65 vjeç;
- nuk ka të ardhura për vitin e kaluar ose ka të ardhura më të ulta se minimumi i parashikuar me ligj;
- ka nenshtetesi italjane ose lejeqëndrimi BE për banoret me afat te gjate ose është refugjat politik;
- ka rezidencën në Itali.

Duke u nisur nga 1 janari 2009, për të marrë cekun shoqëror, duhet të kesh banuar ligjërisht e në mënyrë të pandërprerë për të paktën dhjetë vjet në territorin kombëtar.

Vini re!: për të përfutuar nga ky shërbim është e nevojshme të banosh efektivisht në Itali. Çeku mund të nderpritet nëse qëndron jashtë shtetit për një periudhë më shumë se një muaj, me përjashtim të rastit kur kjo varet nga motive shëndetsore të rënda e të vërtetuara. Një vit pas ndërprerjes, në bazë të verifikimit të të njëjtës gjendjeje, çeku do të refuzohet.

Çfarë është çeku i shtatzanisë që jepet nga Komuna?

Është një çek që i jepet grave shtatzëna që nuk përfitojnë asnjë kompensim tjetër ose në se përfitojnë një kompensim tjetër ky është më i vogël se ai i Komunës. Në rastin e dytë personi merr diferencën nga Komuna.

A mund ta kërkojë këtë një qytetare e huaj?

Po, në rast se ka kartë qëndrimi ose në rast se ka bërë kërkesë për kartë



qëndrimi. Në këtë rast dhënia e çekut pezullohet deri ne momentin e marrjes së kartës së qëndrimit.

Kur duhet bërë kërkesa?

Brenda 6 muajve nga lindja e fëmijës. Edhe në rast adoptimi, kjo kërkesë bëhet brenda 6 muajve të parë të adoptimit, me përjashtim të rasteve kur minori i adoptuar është më i madh se 6 vjeç. Në rastin e një adoptimi ndërkombëtar, moshë e minorit rritet deri ne 18 vjeç.

Vini re: Çeku mund të kërkohej nga një qytetare e huaj kur minori, edhe pse nuk është i lindur në Itali dhe nuk është qytetar i Bashkimit Europian, figuron i shënuar në lejeqëndrimin BE për banoret me afat të gjatë të njërit prej prindërve.

Sistemi i sigurimeve (INAIL)

Çfarë është aksidentimi në punë?

Aksidentimi në punë është një dëmtim si pasojë e një aksidenti gjatë punës nga i cili, personi mund të humbasë jetën, ose të bëhet i paafte për punë, totalisht, ose pjesërisht, apo shërimi i plotë i tij të zgjasë për një kohë më të gjatë se tre ditë.

Në ç'mënyrë punëdhënësi im më siguron kundër aksidenteve apo sëmundjeve profesionale?

Punëdhënësi duhet të sigurojë punonjësit në INAIL kundër dëmtimeve fizike dhe ekonomike që mund të rrjedhin nga aksidente ose sëmundje të marra në vendin e punës; kjo i heq atij përgjegjësinë civile.

Vini re: Në se punëdhënësi ka shkelur rregullat e higjenes dhe parandalimit të aksidenteve atëherë ai ngarkohet me përgjegjësi civile.

Sa kushton sigurimi INAIL?

Sigurimi është falas për punonjësin, dhe në ngarkim të plotë të punëdhënësit. Punëdhënësi duhet të paraqesë, në fillim të aktivitetit, “deklaratën mbi ushtrimin e aktivitetit” dhe të paguajë për rrezikun që mund të vijë nga aktiviteti.



Cilët punonjës duhet të sigurohen në INAIL?

- Punonjësit e varur ose të pavarur që përdorin makineri, mjete të ndryshme, impjante ose që veprojnë në ambiente ku punohet me këto makineri;
- shtëpiaket, vetëm atëherë kur dëmtimet e përhershme janë të shkallës mbi 33%.

Çfarë duhet të bëj në se aksidentohem?

Denoncimi i aksidentimit në punë duhet të ndjekë këtë procedurë:

- të informosh menjëherë punëdhënësin;
- ti paraqesësh punëdhënësit certifikatën e parë mjeksore (sapo ta marrësh) dhe, në se kurat duhet të zgjaten, certifikatën e mjekut që të ndjek ose të INAIL-it;
- të shkosh, sapo të jesh në gjendje fizike për ta bërë këtë, pranë INAIL-it më të afërt për të vijuar kurat dhe bërë certifikatën mjeko-ligjore.

Në se punëdhënësi im nuk më ka siguruar dhe unë pësoj një aksident ose prekem nga një sëmundje profesionale, çfarë ndodh?

Si punonjës i varur, përfiton të drejtën e shërbimeve që ofron INAIL edhe në rast se punëdhënësi nuk të ka siguruar.

Cilat janë llojet e aksidenteve për të cilat tutelohe nga INAIL?

Për dëmtime që ndodhin gjatë punës dhe që i përgjigjen karakteristikave të mëposhtme:

- janë shkaktuar nga një goditje/përplasje e dhunshme;
- kanë sjellë vdekjen, pa aftësi të përhershme ose të përkohshme që ka sjellë largimin nga puna për më shumë se 3 ditë.

Për dëmtime që kanë ndodhur gjatë rrugës nga banesa e punonjësit në punë me kusht që:

- të ketë ndodhur përgjatë një rruge të paracaktuar midis punëdhënësit dhe punonjësit;
- të ketë ndodhur nga përdorimi i mjetit privat të transportit, si i nevojshëm për të kryer aktivitetin e punës.

Si punonjës, cilat janë detyrimet e mia?

- Të ndjekësh udhëzimet mbi detyrat e tua;
- të sinjalizosh rrezikun (drejtorit, përgjegjësit, etj);



- të respektosh dhe të mos heqësh sinjalizimet e rrezikut;
- t' i nënshtrohesh kontrolleve shëndetësore dhe vizitave mjeksore.

Si punonjës, cilat janë të drejta e mia?

- Mos të vazhdosh punën/mos të punosh në rast rreziku të rëndë dhe të menjëhershëm;
- të largohesh nga vendi i punës ose nga zona e rrezikut në rast rreziku të rëndë dhe të menjëhershëm;
- t' i nënshtrohesh kontrolleve shëndetësore dhe vizitave mjeksore për të mënjanuar rreziqet profesionale.

Çfarë duhet të shkruhet në denoncimin e aksidentimit?

- Të dhënat e punonjësit dhe të dhëna mbi aksidentin: shkaqet dhe rrethanat, ora, data etj.);
- të dhënat në lidhje me të ardhurat e 15 ditëve të fundit para se të ndodhte aksidentimi;
- problemet (në se ka) higjienike ose mungesa të sigurimit teknik në vendin e aksidentimit;
- dëshmitarët në momentin e ngjarjes;
- lloji i dëmtimit dhe vendi ku ka ndodhur ky i fundit.

Çfarë është sëmundja profesionale? Është ndryshe nga aksidentimi?

Sëmundja profesionale, në të kundërt nga aksidentimi, provokohet nga veprime të dëmshme të vazhdueshme të cilat zvogëlojnë aftësinë për punë të personit.

Kam një sëmundje profesionale. Çfarë duhet të bëj?

Në rast se je akoma duke punuar, duhet:

- të njoftosh punëdhënësin tënd për sëmundjen brenda 15 ditëve të para të fillimit të saj;
- t' i paraqesësh punëdhënësit tënd certifikatën e parë mjeksore dhe në rast se do vazhdosh kurat edhe certifikatën e mjekut tënd kurues.

Në rast se nuk punon më, duhet:

- t' i paraqesësh INAIL-it kërkesën që INAIL të njohë sëmundjen tënde profesionale.



Cfarë bën INAIL në rast se unë pësoj aksidentim në punë ose prekem nga një sëmundje profesionale?

Punonjësit i cili pëson një aksident në punë ose që preket nga një sëmundje profesionale INAIL i ofron ndihmë ekonomike dhe mjekësore.

Kur mund të përfitoj ndihmë ekonomike?

Kur momentalisht nuk merr rrogë (të jepet kompensim rroge):

- kur aftësitë e tua për punë zvogëlohen ose i humbet plotësisht ato (njohje e shkallës së paaftësisë së përhershme) për dëmtimet përpara datës 25 korrik 2000;
- kur pëson tjetërsim të integritetit psiko-fizik (dëm biologjik) për dëmtimet përpara datës 25 korrik 2000.

Në rast vdekjeje, të ardhurat i shkojnë familjarëve.

Cfarë është kompensimi i momentit dhe sa është shuma e tij?

Është një kompensim i cili i jepet punonjësit me që ky nuk merr më rrogë, duke filluar nga dita e katërt e aksidentimit ose e manifestimit të sëmundjes profesionale deri në shërimin e tij të plotë klinik.

Shuma e kompensimit është e barabartë me 60% të pagës së tij të plotë deri në ditën e 90-të të mungesës nga puna dhe rritet deri në 75% të pagës pas ditës së 90.

Ndërkohë, sëmundjet që nuk janë drejtpërdrejtë pasojë e punës, janë në kompetencën e INPS-it.

Në se aksidentimi ose sëmundja profesionale nuk janë deklaruar në kohë, a mundet që të përfitoj nga shërbimet e INAIL-it?

Po, brenda 3 vjetësh nga dita kur ka ndodhur aksidentimi ose kur është manifestuar sëmundja, duhet që ti vete, ose nëpërmjet një subjekti tjetër të autorizuar, të denoncosh rastin pranë INAIL.

Cfarë është njohja e shkallës së paaftësisë të përhershme?

Pas shërimit, INAIL fton punonjësin e aksidentuar që të kryejnë një vizitë mjeko-ligjore për të vendosur shkallën e paaftësisë që vjen si rezultat i aksidentimit ose sëmundjes profesionale.



Për dëmtimet përpara datës 25 korrik 2000:

- në se shkalla e paaftësisë është midis 11% dhe 100% punonjësi merr dëmshpërblim;
- në se shkalla e paaftësisë është më e vogël se 11%, punonjësi nuk merr dëmshpërblim.

Për dëmtimet përpara datës 25 korrik 2000:

- në se shkalla e paaftësisë është më e vogël se 6%, punonjësi nuk merr dëmshpërblim;
- në se shkalla e paaftësisë është e barabartë ose më e madhe së 6% por më e vogël se 16% punonjësi merr dëmshpërblim për dëmin biologjik;
- në se shkalla e paaftësisë është e barabartë ose më e lartë se 16% punonjësi ka të drejtë të marrë dëmshpërblim, një kuotë për dëmin biologjik dhe një kuotë si rrjedhim i dëmtimit të pasurisë së tij për shkak të aksidentit.

Çfarë mund të bëj në se gjendja ime shëndetësore përkeqësohet?

Mund t'i kërkoh INAIL rishqyrtimin e shkallës tënde të paaftësisë brenda afateve të mëposhtme:

- 10 vjet prej datës së aksidentimit në punë;
- 15 vjet prej datës së manifestimit të parë të sëmundjes profesionale;
- pa afat në rastin e silikozës dhe asbetozës.

Duhet t'i nënshtrohesh vizitave mjeksore për të konfirmuar rritjen ose zvogëlimin e shkallës së paaftësisë tënde.

Çfarë përmbajnë shërbimet sanitare që ofrohen nga INAIL?

- Kurat mjeksore, kirurgjikale dhe fizike, që ndihmojnë shërimin, jepen gratis nga Shërbimi Shëndetësor Kombëtar dhe nga ambulatorët e INAIL;
- kurat mjeksore riabilituese e protezat për të arritur rekuperimin maksimal të integritetit psiko-fizik të punonjësit dhe të aftësisë së humbur të tij për punë.

Për të përfituar këto shërbime ose për ndihmë gratis, mund t'i drejtohesh edhe Sindikatave.



DETYRIMET E PUNËDHËNËSIT NË RAST DËMTIMI APO SËMUNDJEJE PROFESIONALE TË NJËRIT PREJ VARTËSVE

Çfarë është 626 dhe për çfarë bën fjalë?

Ligji 626 i vitit 1994, i njohur edhe si “ligji mbi sigurimin në punë” përcakton rregullat e higjenës dhe të sigurimit të punonjësve në vendet e punës; pasi është ligji i parë i krijuar për përcaktimin, vlerësimin, eliminim, parandalimin dhe kufizimin e rreziqeve në ambientet e punës duke garantuar kështu siguri maksimale.

Cilat janë detyrimet e punëdhënësit?

- Informimi i punonjësve;
- krijimi i një rregulloreje për mirëmbajtjen e makinerive;
- mbikqyrja për respektimin e rregullave.

Çfarë duhet të bëj në se njëri prej vartësve aksidentohet?

- Paraqit denoncimin pranë INAIL dhe autoriteteve të Sigurimit Publik nëpërmjet një formulari të veçantë, brenda dy ditësh, që nga momenti i informimit;
- dërgoji INAIL-it çertifikatën mjekësore origjinale;
- paguaje të plotë ditën e punës kur ndodhi aksidenti dhe 60% tre ditët e mëtejme.

Në rast shtrimi në spital, ky i fundit do të dërgojë kopjen e çertifikatës pranë INAIL-it dhe punëdhënësit.

Vini re: në rast aksidentimi me pasojë vdekjen, punëdhënësi duhet të bëjë denoncimin, me telegram ose fax, brenda 24 orësh nga aksidenti.

Çfarë duhet të bëj në rast se një vartës imi preket nga një sëmundje profesionale?

- Të informosh INAIL-in brenda 5 ditësh;
- t'i dërgosh INAIL-it, çertifikatat mjekësore origjinale.



zyra e gjendjes civile
zyra e gjendjes civile

Informacione të përgjithshme

Çfarë është gjendja civile?

Gjendja civile është një regjistër në të cilin dokumentohen të dhënat personale të qytetarëve rezident në Komunë.

Zyra e gjendjes civile merret me pasqyrimin në regjistër të ndryshimeve që ndodhin në Komunë.

Çfarë kuptohet me “vendbanim”, “rezidencë”, “vendqëndrim”?

Vendbanimi (thjesht vendbanim ose vendbanim i rastësishëm) është vendi ku personi vendos të qëndrojë provizorisht, në pritje të një sistemimi të qëndrueshëm, për një periudhë kohe të kufizuar.

Rezidenca është vendi ku një person jeton dhe ku ka bërë kërkesën për regjistrim në gjendjen civile.

Kërkon rezidencën kush mendon të qëndrojë gjatë në territor. Vendqëndrimi, është vendi ku personi vendos qëndrën kryesore të interesave dhe biznesit të tij.

Mund të regjistrohem në gjendjen civile?

Po, në se je i pajisur me lejeqëndrim BE për banorët me afat të gjatë, ose një lejeqëndrimi të rregullt me kohë të gjatë, për motive pune, familjare, rezidencë të përzgjedhur, edhe në fazë rinovimi, duke demonstruar ricevutën e kërkesës së rinovimit, mund të drejtohesh në zyrën e gjendjes civile të komunës ku je rezident.

Kur mund të regjistrohem në gjendjen civile?

- Për lindje, në gjendjen civile të komunës së rezidencës së prindërve ose në komunën ku është e regjistruar nëna, në rastin kur prindërit janë regjistruar në komuna të ndryshme;
- kur ndërrohet rezidencën nga një komunë tjetër ose nga jashtë shtetit, në gjendjen civile të komunës ku je rezident.

Regjistrimi dhe kërkesa e ndryshimeve anagrafike mund të kërkojnë verifikime nga zyrat kompetente të bashkive, të kushteve higjieno-shëndetsore të banesës në të cilën kërkuesi ka ndërmend të fiksojë rezidencën e tij, sipas normave shëndetsore në fuqi.



Cfarë është familja sipas gjendjes civile?

Familja sipas gjendjes civile është një grup personash që jetojnë në të njëjtën banesë. Ata me njëri-tjetrin kanë lidhje martesore, farefisnore, adoptimi, mbrojtjeje ose thjesht lidhje interesash.

Kur mund të fshihem nga gjendja civile e komunës së rezidencës?

- Në se ndërron vendin e rezidencës, në një tjetër ose jashtë shtetit;
- në se një person i pastrehë transferohet në një komunë tjetër;
- kur autoritetet kompetente nuk gjejnë personin pranë rezidencës që ka deklaruar.

Vini re: Kur nuk rinovohet deklarata e vendbanimit të zakonshëm: qytetari i huaj paralajmërohet dhe ftohet që të veprojë brenda 30 ditësh.

Përse më shërben dokumenti i rezidencës?

Shërben për të kryer disa praktika të rëndësishme si më poshtë:

- rinovimi i lejeqëndrimit;
- kërkesa për lëshimin e lejeqendrimit BE për banorët me afat të gjatë;
- kërkesa për shtetësi italiane;
- kërkesa për bashkim familiar;
- kërkesa për lëshimin e librezës shëndetësore;
- kërkesa për përfitimin e një shtëpije popullore.

Një qëndër pritjeje mund të konsiderohet si vendbanimi im i zakonshëm?

Kur një i huaj qëndron në një qëndër pritjeje për të paktën 3 muaj, qëndra e pritjes mund të konsiderohet si vendbanimi i tij i zakonshëm.

Është i detyrueshëm rinovimi i rregjistrimit në gjendjen civile? Kur?

Po, sa herë që rinovon lejeqëndrimin, brenda 60 ditësh nga lëshimi i lejeqëndrimit të re (ose lejeqendrimit BE për banorët me afat të gjatë). Gjatë periudhës së rinovimit të lejeqëndrimit (ose të lejeqendrimit BE për banorët me afat të gjatë), rregjistrimi në gjendjen civile nuk skadon. Nëpunësi i gjendjes civile rinovon skedën tënde duke vënë në dijeni kuestorin.

Kur duhet të komunikojë në kuesturë ndërrimin e vendbanimit?

Për të huajt rezident, ndërrimi i vendbanimit mund të komunikohet pranë Zyrës së Gjendjes Civile të Kuesturës.



Të huajt që qëndrojnë rregullisht në Itali por nuk kanë rezidencë duhet të komunikojnë detyrimisht, brenda 15 ditëve, ndërrimin e vendbanimit në Kuesturën kompetente.

Rregjistrimi

Çfarë është “kërkesa për rregjistrim në gjendjen civile” për të huajt?

Është kërkesa nëpërmjet të cilës një qytetar i huaj kërkon të rregjistrohet në Rregjistrin e gjendjes civile. Në se kërkesa pranohet, qytetari konsiderohet rezident në qytetin që ka zgjedhur dhe ku mund të kërkojë certifikatat që i duhen gjatë qëndrimit të tij në Itali.

Çfarë është ndërrimi i rezidencës apo i vendqëndrimit?

Ndërrimi i rezidencës është transferimi i përhershëm i banimit nga një Komunë në një tjetër.

Ndërrimi i vendqëndrimit është transferimi nga një banesë në një tjetër, gjithmonë brenda të njëjtës Komunë.

Mund të bëj kërkesë për ndërrimin e rezidencës apo të vendqëndrimit?

Vetëm në rast se je i rritur dhe ke lejeqëndrim të rregullt.

Ku mund ta paraqes kërkesën për ndërrimin e rezidencës apo të vendqëndrimit?

Në se transferohesh nga jashtë Italisë duhet të drejtohesh në Zyrën e Ndërrimit të Rezidencës së Komunës ku banon, ku do të firmosësh deklaratën e rregjistrimit.

Në se transferohesh nga një komunë tjetër duhet të drejtohesh në Zyrën e Gjendjes civile ku dëshiron të jesh rezident.

Si mund të paraqes kërkesën për ndërrimin e rezidencës apo të vendqëndrimit për gjithë familjen?

Cilido pjesëtar i rritur i bërthamës familiare: duhet të paraqesë lejeqëndrimet e të gjithë familjarëve dhe të premtojë të komunikojë çdo transferim të bërthamës familiare.



Si duhet të vepron në se shkoj të jetoj pranë një familjeje tjetër?

Personi i parë që rezulton në certifikatën e gjendjes familiare të familjes ku qëndron, duhet të të shoqëroj pranë Zyrës së Ndërrimit të Rezidencës ku duhet të paraqesë një kërkesë me shkrim.

Sa është kohëzgjatja e rregjistrimit të ndërrimit të rezidencës?

Qytetarët e huaj duhet të kërkojnë rregjistrimin në Gjendjen Civile brenda 90 ditësh nga hyrja e tyre në Itali.

Qytetarët e huaj duhet të kërkojnë ndërrimin e Rezidencës në Gjendjen Civile brenda 20 ditësh nga transferimi i tyre.

Cilat janë dokumentat që duhet të paraqesësh?

- Pashaportë e vlefshme;
- kodi fiskal;
- lejeqëndrimi i vlefshëm me një kohëzgjatje më të lartë se një vit (në se është hera e parë që të kanë lëshuar lejeqëndrimin, vlefshmëria e këtij të fundit duhet të jetë më gjatë se 3 muaj). Nëse leja e qëndrimit është në fazë rinovimi, mund të paraqitet leja e skaduar së bashku me rrethimin e kërkesës së rinovimit (e lëshuar nga Kuestura ose nga Posta) Sipas bashkive, kërkojnë edhe:
- certifikata e lindjes në gjuhën italiane, ose akte të notifikuar të lëshuara nga autoritetet e vendit të origjinës që dokumentojnë gjendjen familjare;
- një kopje e kontratës së qirasë ose akti i pronësisë së banesës, ose përndryshe, një deklaratë ku pronari i shtëpisë tregon disponueshmërinë e tij për të të strehuar në shtëpinë e tij;
- dokumentat mbi pagesën e taksave të plehërave përpara rregjistrimit të banesës ku do të transferohesh.

Refugjatët politik duhet të paraqesin edhe deklaratën e lëshuar nga Komisarati i Lartë i Kombeve të Bashkuara.

Vini re: Pas rregjistrimit dhe/ose ndërrimit të rezidencës, Komuna dërgon për kontroll policinë komunale, për të provuar qëndrimin tënd në adresën e re, e domosdoshme për plotësimin e praktikës.

Në rast se ndërron vendqëndrimin, përpara se të shkosh në Komunë duhet të shënosh në lejeqëndrim adresën e re, në Kuesturën e zonës ku ndodhet banesa e re. Në se ke patentë italiane, duhet të shkruash adresën e re në këtë dokument.



Personat që qëndrojnë në të njëjtën banesë konsiderohen në të njëjtën certifikatë të gjendjes familiare. Nëse nuk ekzistojnë lidhje farefisnore, mund të kërkohet certifikatë e veçantë mbi gjendjen familiare.

Sa kushton rregjistrimi dhe ndërimi i rezidencës ose i vendqëndrimit?

Janë falas.

Shërbimet e gjendjes civile

Çfarë shërbimesh ofron Gjendja civile për të huajt?

Certifikatat e (nëse ngjarjet janë rregjistruar pranë Komunes):

- lindjes;
- rezidencës;
- rregjistrimit historik pranë gjendjes civile;
- beqarisë;
- gjendjes familjare;
- ekzistencës në jetë;
- vaksinave;
- kontestuale.

Vini re: Për të shfrytëzuar shërbimet që ofron Gjendja civile, duhet të paraqitesh atje me pashaportën (ose me një dokument tjetër të barasvlefshëm me të) dhe lejeqëndrimin ose lejeqëndrimin BE për banorët me afat të gjatë; të dhënat në këto dy dokumenta duhet të jenë të njëjta.

Çfarë është karta e identitetit?

Është një dokument njohjeje personale që mund të përdoret vetëm në Itali. U jepet në momentin që e kërkojnë të huajve banues në Bashkinë e Romës që kanë mbushur 15 vjeç. Është e vlefshme për 10 vjet dhe nuk është e vlefshme për të shkuar jashtë shtetit.

Vini re: Karta e identitetit nuk përbën dokument që lejon qëndrimin e të huajit në territorin e Shtetit, pra duhet të shoqërohet gjithmonë me lejeqëndrimin ose me lejeqëndrimin BE për banorët me afat të gjatë dhe pashaportën.



Kur mund të paraqes kërkesën?

Për lëshimin: në çdo moment.

Për rinovimin: 180 ditë përpara skadencës.

Ku mund të paraqes kërkesën për lëshimin/rinovimin dhe çfarë dokumentash duhet të paraqes?

Duhet të paraqitesh personalisht pranë Zyrës së Kartës së Identitetit në Komunë.

Duhet të paraqesësh dokumentat në vijim:

- tre fotografi në format të posaçëm, të gjitha njësoj, me kokë të zbuluar;
- qytetarët e BE-së duhet të paraqesin një dokument identifikimi të vlefshëm dhe kartën e qëndrimit;
- qytetarët e huaj duhet të paraqesin pasaportën dhe lejeqëndrimin; Nëse leja e qëndrimit është në fazë rinovimi, mund të paraqitet leja e skaduar sëbashku me ricevutën e kërkesës së rinovimit (e lëshuar nga Kuestura ose nga Posta). Duhet të plotësosh një formular të cilin mund ta blesh në arkën e Komunës. Duhet me pas te pagohen te drejtat e sekretarie.

Mund të bëj një kopje të kartës së identitetit?

Rastet e parashikuara për lëshimin e një kopjeje të kartës së identitetit, kur kjo e fundit nuk ka skaduar, janë:

- vjedhje;
- humbje;
- dëmtim.

Kur mund të përdor autoçertifikimin?

Disa dokumenta të cilat paraqiten në Administratën publike apo në zyrat e shërbimeve publike (Enel, Acea, Atac, Poste, etj.) mund të zëvendësohen nga autoçertifikimi, dmth nga një deklaratë e thjeshtë e nënshkruar nga vetë i interesuari, e pa autentifikuar dhe pa pulla.

Një qytetar i huaj, rezident i rregullt në Itali, mund të përdor autoçertifikimin për të çertifikuar:

- gjendje dhe cilësi personale të provuara nga PA;
- fakte të çertifikuara ose të provuara nga subjekte publike italiane, me përjashtim të rasteve të parashikuara nga ligji.



Cfarë është legalizimi?

Legalizimi është një akt nëpërmjet të cilit Autoriteti konsullor italian njeh vlefshmërinë e dokumentit të lëshuar nga Autoritetet e huaja.

Cfarë është autentifikimi?

Është një përkthim – i vulosur – që duhet të vlerësohet nga Gjykata Civile dhe që duhet t'i bashkëngjitet, në rast dokumentash të shkruajtur në gjuhë të huaj, origjinalit dhe kopjes.

Cfarë duhet të bëj nëse do të martohem?

Qytetarët e huaj mund të martohen në Itali, si me ritin civil italian, ashtu edhe me ritin fetar i cili është i vlefshëm si riti civil, sipas feve të pranuara nga Shteti. Në rastin e një qytetari të huaj, ashtu si për qytetarin italian, celebrimi i martesës duhet të paraprihet nga publikimet, që kërkohen pranë Zyrës së Gjendjes Civile të Komunës ku je rezident. Publikimet shërbejnë për të shprehur në mënyrë publike vullnetin e dy personave që dëshirojnë të martohen. Përpara publikimeve, personat që dëshirojnë të martohen, duhet të bëjnë betimin përpara një zyrtari të gjendjes civile.

Cfarë dokumentash duhet të paraqes?

- Lejen e qëndrimit ose deklaratën e prezencës (kur nuk është e detyrueshme të bësh deklaratën e prezencës, është e mjaftueshme të demostrosh faqen e pashaportës mbi te cilën është e dukshme vula e Policisë së Kufirit);
- lejen (Nulla-Osta), të lëshuar nga Autoritetet Konsullore në Itali – në këtë rast firma e Konsullit duhet të legalizohet pranë Prefekturës italiane kompetente – ose pranë Autoritetit kompetent në vendin e origjinës – në këtë rast dokumenti duhet të legalizohet nga Konsullata ose Ambasada italiane në atë vend;
- për qytetarët e huaj të cilët janë rezident në Itali, çertifikatat e beqarisë dhe të rezidencës me pullë, të lëshuara nga zyra e Komunës ku ai është rezident;
- pasaportën ose dokumentin e identifikimit personal;
- akti i lindjes, i lëshuar nga vendi i origjinës, i përkthyer dhe i legalizuar, në rastin kur leja përmban të dhëna mbi lindjen, atësinë, mëmësinë.

Vini re: Në momentin e betimit, duhet të jenë të pranishëm dy dëshmitarë në moshë madhore me dokumenta të vlefshëm (nëse të huaj, duhet të kenë me vete lejeqëndrimin). Nëse i huaji është rezident në Itali, çertifikata e rezidencës lëshohet nga zyra e komunës ku ai është rezident.



TË TJERA ZYRA SHËRBIMESH NË KOMUNË

Çfarë janë shërbimet sociale dhe përsa shërbejnë?

Në çdo komunë ndodhet zyra e Shërbimeve Sociale. Të gjithë rezidentët e komunës, italianë dhe të huaj, mund të drejtohen në këtë zyrë. Asistentët socialë ndihmojnë personat që ndodhen në vështirësi gjatë hyrjes dhe integritimit në Itali dhe ofrojnë informacione të dobishme mbi:

- asistencën shtëpijake për pleqtë, për të miturit, për personat me të meta fizike dhe mendore;
- mbështetjen ekonomike familjes dhe vetë personit;
- asistencën për strehim;
- inserimentin e të miturve në strukturat kompetente;
- adoptimet kombëtare dhe ndërkombëtare;
- librezën e parkimit falas për personat me të meta fizike;
- tarifat më të ulëta për transportin publik;
- autorizimin për mencën sociale dhe/ose strehimin gjatë natës, etj.

Çfarë janë shërbimet edukative?

Në çdo komunë ndodhet zyra e Shërbimeve Edukative që ofron informacione mbi shërbimet e mëposhtme:

- shërbimet e ristoracionit (menca) për shkollën;
- qendrat verore, dimërore dhe në shkolla;
- certifikatat mbi frekuentimin e çerdhes dhe të kopshteve komunale;
- regjistrimin në çerdhe;
- regjistrimin në kopsht, etj.

Çfarë janë shërbimet kulturore, sportive dhe të kohës së lirë?

Në çdo komunë ndodhet zyra e Shërbimeve kulturore, sportive dhe të kohës së lirë që merret me promovimin, organizimin dhe realizimin e nismave kulturore dhe sportive në komunë. Ofron informacione mbi shërbimet e mëposhtme:

- qendrat sportive të Komunave;
- qendrat verore;
- regjistrimet në Urdhërat dhe Shoqatat Kulturore, Sportive dhe ONLUS, etj.



strehimi
strehimi

Garancia e vendbanimit

I huaji, për të qëndruar në Itali, ka nevojë për garancinë e një vendbanimi. I huaji mund të mikpritet në banesën e dikujt, të marrë me qira një banesë vetë ai apo ta blejë atë. Në raste vështirësish, i huaji mund të qëndrojë pranë një Qendre Pritjeje që në këtë rast i shërben atij si banesë.

Qëndroj në banesën e familjarëve/miqve të mij, çfarë detyrimesh kam?

Jo ti, por ai që të mikpret ka detyrime. Personi, cilido qoftë ai, i cili ofron banesën apo mban në shtëpinë e tij, një të huaj, është i detyruar të njoftojë autoritetet e sigurimit publik (akti i komunikimit të vënies në dispozicion të shtëpisë/banesës) në rastet kur:

- i jep me qira banesën apo një pjesë të saj;
- i kalon një të huaji pronësinë e banesës;
- i ofron edhe pjesërisht, me qëllim strehimi, një banesë e cila ndodhet në territorin e Shtetit.

Ky akt është i detyrueshëm për të gjithë qytetarët?

Po, me përjashtim të Kolegjit të Shenjtë dhe të Trupit diplomatik apo konsullor, çdo qytetar ose shoqatë, subjekt privat ose publik, duhet të njoftojë autoritetet e SP, edhe në rastin kur personat, të cilëve i ofron banesën, janë kushërinj apo të afërm.

Si duhet të veprojmë?

Duhet të njoftosh me shkrim brenda 48 orëve. Mund të veprosh edhe nëpërmjet postës, në këtë rast duhet ta dërgosh letrën rekomandë në mënyrë që të të venë në djeni për mbërritjen e saj pranë autoriteteve të sigurimit publik kompetente për territorin. Në letër duhet të përcaktosh përveç të dhënave të tua, të dhënat e të huajit apo të atij paatdhe, të dhënat e pasaportës apo të një dokumenti tjetër identifikimi të tij, adresën e saktë të banesës ku qëndron personi, si edhe motivin për të cilin i ke dhënë banesën.

Vini re: Personat që nuk respektojnë detyrimet e komunikimit dënohen me gjobë.



Kujt duhet t'ja dërgoj?

- Kuesturës në krahinat kryesore të provincave;
- komisarariat të Sigurimit Publik apo Komunave në rastet e tjera.

Çfarë të dhënash duhet të komunikojë?

- Të dhënat personale të atij që ofron banesën (emër, mbiemër, data dhe vendlindja, rezidenca);
- të dhënat personale të të huajit (emër, mbiemër, data dhe vendlindja, rezidenca, lloji i dokumentit të identifikimit, numri i dokumentit, data dhe vendi i lëshimit të dokumentit);
- adresën e saktë të banesës ku do të qëndrojë i huaji;
- titullin e lëshimit të godinës me qëllim strehimin, për shembull, me qera, pa qera, në pronësi, etj; ose të deklarojë thjesht mikpritjen e tij pa qëllim fitimi.

Ligji 94/2009 – Cilido që ofron banim – duke marrë pagesë – ose jep me qera një banesë një të huaji pa leje qëndrimi ose me titull të skaduar dhe të pa rinovuar, ndëshkohet me burgim nga 6 muaj deri në 3 vjet. Pasi dënimi të jetë përfundimtar, banesa konfiskohet, me përjashtim të rastit kur pronari është një person tjetër.

Qeraja e banesës

Si duhet të veprojmë për të marrë një banesë me qera?

Duhet të nënshkruash një kontratë qeraje. Me këtë kontratë, pronari i shtëpisë, detyrohet t'i lëshojë qeramarrësit godinën, me qëllim banimi, për një kohë të caktuar, kundrejt një pagese të caktuar. Qeramarrësi i paguan qiranë, pronarit të banesës, zakonisht një herë në muaj. Qeraja mund të ndryshojë çdo vit sipas treguesve ISTAT duke u rritur në masën 75% të këtyre të fundit.

Çfarë është kapari?

Kapari është shuma që qeramarrësi i jep pronarit të shtëpisë si garanci për çdo dëmtim të shtëpisë. Kapari nuk mund të jetë më i lartë se shuma e qerasë të 3 muajve. Në rast se shtëpia nuk dëmtohet kapari i kthehet plotësisht qeramarrësit në mbyllje të kontratës, duke përfshirë edhe rritjen në interesa.



Çfarë forme duhet të ketë kontrata e qerasë?

Sipas ligjit, kontrata e qirasë duhet të jetë në formë të shkruar sipas llojeve.

Kontrata e qerasë përcakton:

- sa duhet t'i paguajë çdo muaj qeramarrësi pronarit të shtëpisë;
- për sa kohë qeramarrësi mund të qëndrojë në banesë;
- në cilën ditë të muajit duhet paguar qiraja.

Dy llojet kryesore të kontratave të parashikuara nga Ligji 431/98 janë:

- kontrata e lirë, e cila përcaktohet në varësi të zhvillimit të tregut të qerave, sipas ofertës dhe kërkesës. Ka një kohëzgjatje prej 4 vjetësh dhe, në rast se nuk priset 6 muaj përpara përfundimit të saj, rinovohet për 4 vjetë të tjera me të njëjtat kushte të kontratës së parë. Kontrata mund të priset edhe në përfundim të 4 vjetëve, në rast nevojë të qeradhënësit apo të familjarëve të tij, deri në brezin e dytë, apo me qëllim mirëmbajtjen e banesës.
- kontrata e konkorduar përcaktohet në një marrëveshje midis Organizatave Sindakaliste të pronarëve me pjesëmarrjen e Bashkive. Ka një kohëzgjatje prej 3 vjetësh plus 2 vjet të tjera. Me nënshkrimin e kësaj kontrate, si pronari ashtu edhe qeramarrësi, gëzojnë mundësinë e një zbritjeje prej 30% të taksës së rregjistrimit, e zbritjes së taksave mbi të ardhurat si edhe, nga Bashkia, një ulje apo heqjen e taksës bashkiake mbi godinat (ICI).

Rregjistrimi i kontratës është i detyrueshëm?

Po. Sipas ligjit, pronari i shtëpisë duhet të rregjistrojë kontratën e qirasë, brenda 30 ditëve nga nënshkrimi, pranë Zyrës së Rregjistrimit. Taksa e rregjistrimit është sa 2% e qirasë në bazë vjetore. Shpenzimet e rregjistrimit duhet të ndahen në mënyrë të barabartë ndërmjet qiradhënësit dhe qiramarrësit. Rregjistrimi duhet të rinovohet çdo vit. Përsa i përket kontratave shumëvjeçare, taksa e rregjistrimit mund të paguhet në një herë të vetme edhe për vitet në vijim të parashikuara në kontratë. Në këtë rast, parashikohet një zbritje në shpenzimet e rregjistrimit. Përveç kësaj, kur kontrata e qirasë është e rregjistruar në mënyrë të rregullt, mund të marrësh pjesë në garat që publikon Bashkia, si kontribut, në përballimin e shpenzimeve të qirasë, kundrejt personave, të cilët, kanë të ardhura vjetore të ulta.

Vini re: Në rast se kontrata nuk rregjistrohet atëherë nuk është e vlefshme për të treguar që i huaji banon në mënyrë dinjitoze me qëllim rinovimin e lejeqëndrimit.



Blerja e banesës

Mund të blej një apartament?

Të huajt, të pajisur me lejeqëndrim të rregullt për motive pune apo familjare, ose me leje qëndrimi BE për banoret me afat të gjatë, mund të blejnë banesën në kushte të barabarta me qytetarët italianë. Ndërsa të tjerët mund të blejnë shtëpi vetëm nëse ekziston një marrëveshje specifike midis vendit përkates dhe Italisë. Në rastin e blerjes së shtëpisë së parë, ekzistojnë lehtësime mbi taksat e banesës (taksa e rregjistrimit, e hipotekës, e kadastrës).

Çfarë dokumentash duhet të nënshkruaj për të blerë një banesë?

- Propozimin për blerje, me nënshkrimin e të cilit bllokohet çmimi i banesës që është rënë dakort, nënshkruhet një propozim i pakthyesëm blerjeje si edhe derdhet një pjesë e të hollave nga çmimi i banesës;
- premtimin e shitjes apo kompromisin, një marrëveshje paraprake, nëpërmjet të cilit palët impenjohen në nënshkrimin e kontratës së shit-blerjes (rogito), duke caktuar datën, në se nuk është e mundur që të nënshkruhet menjëherë. Me nënshkrimin e kompromisit, zakonisht, pasi nuk është i detyrueshëm, derdhet një pjesë e të hollave nga çmimi i banesës;
- aktin publik të shitjes, i cili ka për qëllim transferimin e pronësisë së banesës. Ky akt, i cili nënshkruhet përpara noterit (rogito notarile), me pjesëmarrjen e shitësit dhe të blerësit, ka vlerën e një akti publik.

Çfarë është kredija?

Në se nuk ke në dispozicion të gjithë shumën e të hollave që të nevojiten për blerje e banesës, mund të kërkosh borxh në një bankë nëpërmjet hapjes së një kredije në bazë hipoteke. Banka, nga ana e saj, për të siguruar kredinë e dhënë, vendos hipotekën mbi banesën e blerë. Në se të ardhurat e blerësit nuk janë të mjaftueshme për të paguar këstin e kredisë, atëherë, banka kërkon garancinë (fideiussione) e një personi tjetër apo të një subjekti, i cili impenjohet personalisht, me të mirat e tij materiale, në shlyerjen e borxhit në se ti nuk mundesh. Hipoteka, është një formulë e cila i lejon bankës, në rastin kur nuk paguhen këstet e kredisë, të pronësojë banesën si edhe ta shesë atë me qëllim nxjerrjen e të hollave të kredisë. Në rastin e blerjes së shtëpisë së parë mund të përfitosh nga një kredi me interesa më të ulta në krahasim me interesat që bankat kanë zakonisht.

Vini re: Në se mendon të marrësh kredi bankare, verifiko me bankën, në



se i plotëson të gjitha kushtet, përpara se të nënshkruash propozimin për blerjen e banesës.

Çfarë kushtesh duhet të plotësosh në mënyrë që banka të të japë kredi?

Banka, për të miratuar kredinë, kërkon disa garanci si për shembull:

- deklaratën e të ardhurave;
- derdhjen çdo muaj të pagës në bankë (në disa raste nuk është e detyrueshme);
- garanci personale ose nëpërmjet të mirave të tua materiale.

Çfarë përcaktohet në një kontratë kredije?

Kushtet kryesore të cilat përcaktohen në një kontratë kredije janë:

- kohëzgjatja e kthimit të kredisë (nga 5 deri në 30 vjet), duke marrë parasysh gjithmonë moshën e atij që kërkon kredinë;
- taksa e interesit të kredisë (tavani i taksës së interesit përcaktohet me ligj i cili ndalon fajdet); taksat e interesave kanë skadencën të ndryshme (muajore, tremujore, etj.) dhe përcaktohen në bazë të treguesve të referimit të cilët publikohen në shtypin e përditshëm (psh. treguesit EURIBOR, EURIRS) duke i shtuar edhe një shumë tjetër të hollash që e vendos banka e cila ndryshon nga një bankë në tjetrën, quhet SPREAD;
- shuma e kështit që duhet paguar si edhe plani i kthimit të të hollave (numri i kësteve); personi i cili kërkon kredinë duhet të ketë të ardhura të mjaf-tueshme për të përballuar këstet e kredisë;
- shuma, në të holla, e dënimit, në se vendos të a mbyllësh kredinë përpara afatit të caktuar.

Kush i përpilon kontratat e kredisë për banesën?

Si kontratën e shit-blerjes së banesës, ashtu edhe kontratën e kredisë e përpilon dhe e rregjistron një noter.

Çfarë shpenzimesh duhet të përballoj në momentin e blerjes së banesës?

- Taksën e rregjistrimit (me kushte lehtësuese për shtëpinë e parë);
- TVSH, në se banesa blihet nga një ndërmarrje;
- taksën e hipotekës;



- taksën e kadastrës;
- shpenzimet e noterit për dy kontratat që ai ka përpiluar dhe rregjistruar.

Çfarë shpenzimesh duhet të përballoj si qiramarrës apo si pronar i banesës?

Duhet të paguash faturat (e gazit, elektrikut, ujit, ngrohjes, telefonit, në se ke instaluar linjën telefonike, si edhe shpenzime të tjera mbi hapsirat dhe shërbimet e përbashkëta të godinës) një herë në muaj apo një herë në dy muaj, si edhe taksën e plehrave një herë në vit.

Qëndrat e pritjes (centri di accoglienza)

Çfarë janë qëndrat e pritjes?

Janë struktura të cilat garantojnë një sërë shërbimesh shoqërore dhe ofrojnë strehim të përkohshëm, me qëllim favorizimin e pavarësisë dhe integritetit shoqëror të të huajve sa më shpejt që të jetë e mundur.

Mund të shkoj në qendrat e pritjes?

Vetëm në rast se je i huaj dhe ke një lejeqëndrimi me një kohë të gjatë ose për motive pune, familiare dhe papunësie, si edhe nuk ke mundësi të tjera strehimi.

Kush nuk ka të drejtë të shkoj në qendrat e pritjes?

- Të huajt pa lejeqëndrimi apo të parregullt, me përjashtim të rasteve të jash-tëzakonshme (të vendosura nga kryetari i bashkisë);
- të huajt me lejeqëndrimi për motive turizmi, studimi, biznesi, kura mjekësore dhe lloje të tjera lejeqëndrimi me kohë të shkurtër.

Strehimi në qendrat e pritjes është falas?

Mund të jetë falas ose me pagesë (qira).

Kam detyrime gjatë qëndrimit në një qendër pritjeje?

Po, duhet të respektosh rregulloren e qëndrës.



SHTËPITË POPULLORE DHE KOOPERATIVAT NDËRTIMORE

Çfarë janë?

Janë banesa në pronësi të subjekteve publike, me qëllim strehimi, që shiten në kushte të veçanta.

Kush mund të përfitojë nga shtëpitë popullore?

Si qytetarët italianë ashtu edhe qytetarët e huaj në zotërim të një leje qëndrimi të paktën dyvjeçare dhe të impenjuar në një aktivitet pune të varur ose autonomo se të një leje qëndrimi BE për banorët me afat të gjatë. Përfitimti i banesës i lejohet gjithashtu titullareve të statusit të refugjatit dhe atyre që gëzojnë të drejtën për ndihmë ekonomike.

Vini re: vendimet lidhur me shtimin e volumit të ndërtimeve rezidenciale publike (neni 11, L.133/2008) parashikojnë masa për rritjen e ofertës për banesa që i destinohen kategorisë së “subjekteve në nevojë”, midis të cilëve përfshihen edhe imigratet e rregullt me të ardhura të ulëta, me kusht që të jenë rezidentë për të paktën 10 vjet në territorin kombëtar, ose të paktën 5 vjet në territorin rajonal.

Gjithashtu, me qëllim që të ndahet fondi kombëtar në mbështetje të marrjes së banesave me qera, ndër kushtet minimale të nevojshme për të përfutur kontribute plotësuese, është parashikuar për imigrantët, pajisja me certifikatën historike të rezidencës për të paktën 10 vjet në Itali, ose të paktën për 5 vjet në Rajon.

Të huajt e rregullt me të ardhura të ulëta, për të përfutur nga shpërndarja e shtëpive të Ndërtesave Rezidenciale Publike, ashtu sikurse dhe qytetarët italianë, duhet të jenë rezidentë për të paktën dhjetë vjet në territorin kombëtar ose për të paktën 5 vjet në të njëjtin Rajon.

Si veprohet për të marrë shtëpi popullore?

Të interesuarit për shtëpi popullore duhet të paraqesin kërkesën pranë Komunitetit të rezidencës, nëpërmjet një formulari që e gjejnë në Komunë, duke e postuar me rekomandë në mënyrë që t’ju konfirmohet mbërritja e letrës në Komunë. Për informacione më të hollësishme mund të drejtoheni



në Zyrën e Marrëdhënieve me publikun ose në Zyrën e Shtëpisë së Komunës.

Çfarë është Kooperativa Ndërtimore?

Kooperativa ndërtimore është një subjekt që ka për qëllim ndërtimin apo blerjen e banesave për llogari të ortakëve që bëjnë pjesë në kooperativë. Ortakët e kooperativës duhet të kenë disa cilësi të caktuara (rezidencë në komunë, të ardhura të ulta, mos të kenë në pronësi objekte të tjera, etj). Blerja e një shtëpije nëpërmjet kooperativës ka në përgjithësi kushte të favorshme sepse kooperativat kanë lehtësira.

Mund të jem ortak në një kooperativë ndërtimore?

Po, qytetarët e huaj mund të jenë ortakë në një kooperativë ndërtimore.



shëndetësia
shëndetësia

Rregjistrimi në Shërbimin Shëndetësor Kombëtar (SSN)

Shërbimi Shëndetësor Kombëtar (SSN) është bashkësia e strukturave dhe e shërbimeve të cilat garantojnë mbrojtjen e shëndetit dhe ndihmë shëndetësore për të gjithë qytetarët, si italianë ashtu edhe të huaj.

Qytetari huaj rezident në Itali me lejeqëndrim të rregullt gëzon të drejtën e ndihmës shëndetësore të ofruar nga SSN, në mënyrë të barabartë me qytetarin italian. Ndihma shëndetësore u garantohet jo vetëm të rregjistruarve por edhe familjarëve që ata kanë në ngarkim të cilët kanë lejeqëndrim të rregullt.

Ku kryhet rregjistrimi?

Rregjistrimi kryet pranë Qendrës Shëndetësore Vendore në territorin ku je rezident ose (në se nuk ke rezidencë) pranë Qendrës Shëndetësore Vendore në territorin ku ke adesën që ke shënuar në lejeqëndrim.

Çfarë është Qendra Shëndetësore Vendore?

Qendra Shëndetësore Vendore (ASL) është bashkësia e spitaleve, ambulancave, konsultoreve dhe zyrave që në një territor të caktuar (për shembull një provincë), kujdeset për shëndetin e popullsisë. Pranë Qendrës Shëndetësore Vendore kërkohet rregjistrimi në Shërbimin shëndetësor kombëtar (SSN) dhe zgjidhet mjeku i familjes.

Mund të rregjistrohem në Shërbimin Shëndetësor Kombëtar?

Rregjistrimi në Shërbimin Shëndetësor Kombëtar është i detyrueshëm për qytetarët e huaj titullarë të:

- Lejeqendrimit BE për banorët me afat të gjatë;
- lejeqendrimit për motive pune të varur;
- lejeqendrimit për motive pune të pavarur;
- lejeqendrimit për motive rregjistrimi në listat e punësimit;
- lejeqendrimit për motive familjare;
- lejeqendrimit për motive strehimi politik;
- lejeqendrimit për motive strehimi humanitar;
- lejeqendrimit për motive pritje adoptimi;
- lejeqendrimit për motive adoptimi;



- lejeqëndrimin për motive marrje Shtetësie.

Nuk humbasin të drejtën, dhe nëse nuk janë regjistruar mund të regjistrohen, të huajt në pritje të lëshimit apo rinovimit të lejeqëndrimin. Këtë të drejtë e gëzojnë edhe familjarët kur janë në ngarkim të personit të regjistruar.

Vini re: Të huajt që hyjnë në Itali për motive kurimi nuk mund të regjistrohen në SSN dhe duhet të paguajnë kurat e kryera; Të huajt refugjatë politik dhe pa shtetësi si dhe bashkëshortët e tyre, kanë të drejta të njëjta si qytetarët italianë në se kanë lejeqëndrim të vlefshëm për strehim politik. Për të miturit, prindërit e të cilëve janë të regjistruar në SSN, garantohet i njëjti trajtim me të miturit e regjistruar, që nga momenti i lindjes.

Kur nuk mund të regjistrohesh në SSN?

Nuk mund të regjistrohesh kur ke një lejeqëndrim të parinovueshme ose në rast dëbimi, me përjashtim të rastit kur mund të provosh apelimin kundër dëbimit.

Çfarë dokumentash duhet të paraqes për t'u regjistruar në SSN?

Lejeqëndrim të vlefshëm; Nëse leja e qëndrimin është në fazë rinovimi, mund të paraqitet leja e skaduar sëbashku me ricevutën e kërkesës së rinovimit (e lëshuar nga Kuestura ose nga Posta):

- certifikatë rezidence (ose deklaratë mbi strehimin në të njëjtin vend adresën e të cilit ke shënuar në lejeqëndrim);
- kodi fiskal;
- deklaratë ku merr përgjegjësinë e komunikimit të çdo lloj ndryshimi të gjendjes së tij.

Përveç këtyre:

- Të papunët, të regjistruar në listat e punësimit duhet të paraqesin auto-certifikatë mbi rregjistrimin e tyre;
- bashkëshortët/bashkëshortet e qytetarëve italianë duhet të paraqesin certifikatën e gjendjes familjare ose auto-certifikatë;
- të miturit e adoptuar ose në pritje të adoptimit duhet të paraqesin deklaratën e Gjykatës së të Miturve ku dëshmohet fakti.

Sa kohë zgjat rregjistrimi në SSN?

Kohëzgjatja është paafat por gjithmonë në varësi të kohëzgjatjes së lejeqëndrimin ose te lejeqenimit BE per banoret me afat te gjate.



Kur mbaron rregjistrimi pranë SSN?

Rregjistrimi pranë SSN mbaron:

- në se skadon lejeqëndrimi, me përjashtim të rastit kur tregon kërkesën për rinovim ose lejeqëndrimin e rinovuar;
- në se skadon lejeqëndrimi të është anuluar ose mohuar, me përjashtim të rastit kur provon apelimin ndaj faktit;
- në rast dëbimi;
- në rastin kur i huaji nuk plotëson kushtet për të bërë pjesë në kategoritë për të cilat parashikohet rregjistrimi i detyruar në SSN (për shembull: përfundimi i bashkëjetesës me familjarët në ngarkim, ndërrimi i motivit të lejeqëndrimit për të cilin nuk parashikohet rregjistrimi i detyruar në SSN, përfundimi i aktivitetit të punës ose i rregjistrimit në listat e punësimit për të huajin që nuk është titullar i një lejeqëndrimi për të cilën nuk parashikohet rregjistrimi i detyruar në SSN).

Cilat janë dokumentat dhe shërbimet shëndetësore që përfitojnë të regjistruarit në SSN?

- Libreza shëndetësore;
- zgjedhja e mjekut të familjes dhe pediatrit për të miturit;
- vizita mjeksore të përgjithshme në ambulancë dhe vizita mjeksore të specializuara;
- vizita mjeksore në shtëpi;
- shtrim në spital;
- vaksinimi;
- analiza gjaku, radiografi, ekografi, etj;
- receta për ilaçe;
- certifikata mjeko-ligjore;
- ndihmë për riaftësim, proteza, etj.

Libreza shëndetësore

Çfarë është libreza shëndetësore?

Është dokumenti që lëshohet në Qendrën Shëndetësore që provon rregjistrimin në SSN. Është e domosdoshme për të përfituar shërbimet shëndetësore.



re. Në librezën shëndetësore është i shkruajtur emri dhe mbiemri i personit si edhe ai i mjekut kurues.

Si të veproni në rast se më humbet librezja shëndetësore?

Duhet të denoncosh humbjen pranë autoriteteve kompetente dhe të kërkoh një të dytë pranë Qendrës Shëndetësore Vendore.

Shërbimet shëndetësore

Cili është mjeku i familjes?

Është profesionisti që siguron kurat e mjeksisë së përgjithshme:

- viziton pacientët në studjon e tij ose në shtëpinë e të sëmurit kur kushtet e këtij të fundit nuk e lejojnë të shkojë tek mjeku;
- lëshon receta për ilaçe, analiza dhe vizita të specializuara;
- propozon shtrimin në spital në se është i nevojshëm;
- lëshon çertifikata.

Cili është pediatri i bazës?

Është mjeku që ndjek fëmijët, i viziton kohë pas kohe, kontrollon rritjen e tyre, lëshon receta për ilaçe, analiza dhe vizita të specializuara, propozon shtrimin në spital në se është i nevojshëm, lëshon çertifikata.

Si mund të zgjedh mjekun e familjes dhe pediatrën?

I huaji i regjistruar në SSN mund të zgjedhë mjekun e familjes dhe pediatrën për fëmijët e moshës nga 0 deri në 14 vjeç të cilët gëzojnë të drejtën e të pasurit falas të mjekut specialist pediatër.

Pranë zyrës ku lëshohen librezat shëndetësore mund të konsultosh një listë mjekësh të disponueshëm. Emri i mjekut të familjes shkruhet në librezën tënde shëndetësore.

Çertifikatat e lëshuara nga mjeku i familjes dhe pediatri janë falas?

Janë falas:

- çertifikatat për mungesë nga puna të prindit në rast se ka fëmijën sëmurë;
- çertifikatat për ushtrimin e aktiviteteve sportive në shkollë;



- çertifikatat në rast sëmundjeje dhe dëmtimi fizik ose motive të tjera shëndetësore që nuk të lejojnë të shkosh në punë.

Nuk është falas:

- çertifikata për ushtrimin e aktiviteteve sportive profesionale;
- çertifikata me qëllim kryerjen e sigurimit;
- çertifikata për kërkesën e invaliditetit.

Mund të kërkoj zëvendësimin e mjekut të familjes në çdo moment?

Po, duhet të plotësosh një formular; në të njëjtën kohë duhet të tregosh mjekun e ri që ke zgjedhur.

Si bëhen vizitat e specializuara?

Për të kryer një vizitë të specializuar është e nevojshme kërkesa nga ana e mjekut të familjes. Me kërkesën e mjekut dhe me librezën shëndetësore duhet të shkosh të prenotosh vizitën në qendrën shëndetësore vendore. Këto shërbime mund të kryhen edhe pranë laboratorëve privatë të konvencionuar.

Vizitat e specializuara janë falas?

Për të kryer vizitat e specializuara, analizat dhe blerjen e ilaçeve, duhet paguar një kuotë e caktuar nga Shteti, fatura (ticket).

Ilaçet nuk i paguajnë:

- invalidët civilë të shkallës 100%, invalidët civilë të shkallës më të lartë se 2/3, ose ata që kanë çekun e shoqërimit, të verbërit dhe shurdhët;
- viktimat e terrorizmit dhe të kriminalitetit të organizuar;
- pacientët të cilët i nënshtrohen kurave të dhimbshme;
- titullarët e pensioneve shoqërore;
- titullarët e pensioneve prej 60 vjetëve e sipër.

Shërbimet e specializuara janë falas për:

- titullarët e pensioneve shoqërore dhe familjarët që kanë në ngarkim;
- të papunët, titullarët e pensioneve prej 60 vjetëve e sipër;
- invalidët civilë të shkallës më të lartë se 2/3, ose ata që kanë çekun e shoqërimit;
- të dëmtuarit në punë dhe të gjitha kategoritë e qytetarëve të parashikuara nga ligji.



Disa shërbime mjeksore, janë falas, edhe nëse qytetari nuk bën pjesë në asnjërën prej kategorive të mësipërme. Ato janë:

- shërbimet për diagnostikimin e parakohshëm të tumoreve (mamografitë, papteste, etj);
- shërbimet e parashikuara për mbrojtjen e gruas gjatë shtatzanisë, për shembull analiza të ndryshme, ekografi, etj;
- shërbimet e parashikuara në kuadrin e dhurimit e gjakut, të organeve, vaksinave jo të detyrueshme për fëmijët deri në moshë 14 vjeç.

Si të veproj për të përfituar shërbimet falas?

Duhet të paraqesësh kërkesën në Qendrën Shëndetësore Vendore të bashkëlidhur me çertifikatën e mjekut specialist ose spitalor, librezën shëndetësore dhe kodin fiskal. Qendra Shëndetësore Vendore lëshon një librezë të posaçme.

Vini re: Ligji mbi shërbimet falas mund të pësojë ndryshime. Për informacione më të hollësishme mbi shërbimet falas në fuqi si edhe mbi dokumentat që duhen paraqitur, mund të drejtohesh tek mjeku i familjes apo pediatri që ke zgjedhur.

Cilat janë shërbimet e urgjencës?

Në rastet e urgjencës (aksidente, dëmtime dhe çdo lloj situatë e rrezikshme për jetën) mund të shkosh në Urgjencën e Spitalit (Pronto Soccorso) ose të kërkohsh ndërhyrjen e mjekut duke telefonuar falas në numrin 118 i cili funksionon 24 orë pa pushim.

Ndihma spitalore është falas?

Shërbimet spitalore janë falas për të gjithë qytetarët të cilët janë rregjistruar në SSN. Ligji financiar 2006 ka parashikuar që duke filluar nga 1 janari i 2007 një pagesë në ndihmën e shpejtë të spitaleve për ndërhyrjet e klasifikuara si jo urgjente (kodi i bardhë).

Çfarë është mjeku i rojes?

Është një shërbim, plotësisht falas, të cilin mund ta thërrasësh në çdo orë, në rastet e nevojshme; ky shërbim të ofron ndihmë mjeksore të menjëherëshme në shtëpi.



Ndihma e infermieres parashikohet në shërbimet e SSN?

Aktualisht ky shërbim nuk parashikohet nga SSN. Në rastet e nevojshme mund të ofrohet, në shtëpi, në se shërbimi shoqëror i Komunës e sinjalizon rastin tek organet shëndetësore.

Mund të detyrohet pacienti të kryejë vizitat dhe shërbimet shëndetësore?

Vetëm në rastet e parashikuara nga ligji (Trajtime Shëndetësore të Detyruara) por gjithmonë duke respektuar dinjitetin dhe të drejtat civile të njeriut. Këto ndërhyje parashikohen nga Kryetari i Bashkisë, me propozim të mjekut, dhe me konvalidimin e mjekut të strukturës shëndetësore kompetente. Pas 48 orësh nga shtrimi, nisma duhet t'i komunikohet Gjykatësit kompetent.

Mund të kundërshtosh një trajtim shëndetësor të detyruar?

Personi që është detyruar t'i nënshtrohet trajtimit shëndetësor, ose kush është i interesuar, mund të paraqesë apelin pranë Gjykatës kundër vendimit të Gjykatësit, cili ka konvaliduar vendimin mbi trajtimin mjekësor.

Çfarë ndodh nëse qytetari i shtruar është i huaj ose pa shtetësi?

Vendimi duhet t'i komunikohet Ministrisë së Brendshme dhe Konsullatës së vendit të origjinës së personit. Komunikimin e kryen Prefekti.

Çfarë janë konsultoret familjare?

Janë shërbime, shoqërore-shëndetësore të territorit, që mbrojnë shëndetin fizik dhe psikik të gruas, fëmijës, çiftit dhe familjes. Shërbimet janë falas dhe për t'i kryer ato duhet të prenotohen më parë. Është një shërbim që u ofrohet edhe qytetarëve të huaj. Në këshillimore gjinden figura profesionale si me kompetenca psikologjike dhe shoqërore: psikologë, asistentë shoqëror, sociologë, ndërmjetës kulturor, ashtu edhe me kompetenca shëndetësore: pediater, gjinekologë, obstetër, infermierë, asistentë shëndetësor.

Mund të drejtohesh në konsultoret familjare për shërbimet e mëposhtme:

- këshilla dhe vizita mbi kontracëptimin;
- për t'u ndjekur gjatë shtatzanisë;
- kurse parapërgatitjeje për lindje;



- këshilla, vizita për ndërprerjen e vullnetshme të shtatzanisë (IVG);
- kontrole periodike gjinekologjike;
- paandalimin e tumoreve tek femrat;
- këshilla dhe asistencë gjatë periudhës së menopauzës;
- ndihmë pediatrike;
- vaksinimi i detyruar (dhe i rekomanduar);
- këshilla mbi probleme shoqërore dhe psikologjike.

Ku ta gjej adresën e konsultores familjare?

Në numratorin telefonik, në zërin «Aziende sanitarie locali» dhe më pas në zërin «Consultori».

Ekzistojnë shërbime të tjera sociale - shëndetësore?

Po, njësitë territoriale të rriaftësimit dhe Qëndrat e higjienës mendore.

Cilat vakcina janë të detyrueshme?

Për fëmijët, në Itali, janë të detyrueshme vaksinat kundër titanozit, difteritit, poliomyelitit dhe hepatitit B. Këshillohen, por nuk janë të detyrueshme, vaksinat kundër lisë së dhurve, kollës së mirë, dhe vetëm për vajzat, kundër rubeolës. Për të rriturit këshillohen vaksinat kundër titanozit dhe hepatitit B viral.

Vaksinat e detyrueshme janë falas?

Po.

Ku mund ta kërkojnë certifikatën e vaksinave?

- Për rregjistrim në shkollën fillore;
- për rregjistrim në kopësht;
- për rregjistrim në çerdhe;
- për rregjistrim në qendrat verore;
- për pjesëmarrjen në aktivitete sportive të nivelit amator, etj.

Kush mund të rregjistrohet vullnetarisht në SSN?

Qytetarët e huaj për të cilët nuk është i detyruar rregjistrimi në SSN, duhet të sigurohen kundër rrezikut të sëmundjeve, të dëmtimeve dhe për shtatzaninë. Mund të sigurohen:



- nëpërmjet një sigurimi privat me një institut sigurimesh italkan ose të huaj, i vlefshëm në teritorin kombëtar;
- nëpërmjet rregjistrimit vullnetar në SSN, duke paguar një kontribut minimal në raport me të adhurat e deklaruarat.

Kanë të drejtë të sigurohen vullnetarisht në SSN (duke paguar një kontribut vjetor):

- studentët;
- personat sipas Marëveshjes së Strasburgut të 24 nëntorit 1969 (e ratifikuar me ligjin e 18 majit 1973 n.304);
- fetarët;
- titullarët e lejeqëndrimit për ezidencë të zgjedhur që nuk punojnë;
- punonjësit e Ambasadave;
- kategori të tjera që mund të mbeten.

Çfarë dokumentash duhet të paraqes për t'u rregjistruar vullnetarisht në SSN?

Lejeqëndrim të vlefshëm; Nese leja e qendrimit eshte ne faze rinovimi, mund te paraqitet leja e skaduar sebashku me ricevuten e kerkeses se rinovimit (e leshuar nga Kuestura ose nga Posta)

- certifikatë rezidence (ose deklaratë mbi vendqëndrimin siç e ke të shkruajtur në lejeqëndrim);
- kodi fiskal;
- fatura e pagesës së kryer.

Duhet të plotësojnë praktikën me dokumenta të tjera:

- studentët (autoçertifikatë regjistrimi në kursin e studimeve);
- studentët të cilët konsiderohen “collocati alla pari” (deklaratë).

Nëse nuk kam lejeqëndrim të vlefshëm, çfarë të drejtash kam?

Qytetarëve të huaj, të cilët kanë hyrë dhe/ose qëndrojnë në mënyrë të parregull në Itali pasi nuk kanë lejeqëndrim ose i ka skaduar prej më shumë se 60 ditësh, u sigurohen, pranë strukturave publike dhe të akredituara, kurat urgjente dhe të domosdoshme ambulatoriale dhe spitalore për sëmundje dhe dëmtime, si edhe ndërhyrje me qëllim parandalimin dhe ruajtjen e shëndetit personal dhe kolektiv, si më poshtë:

- ndërhyrje me qëllim mbrojtjen e shtatzanisë dhe të mëmësisë;



- vaksinime;
- ndërhyrje të profilaksisë ndërkombëtare;
- profilaksi, diagnozë, dhe kurim i sëmundjeve infektive;
- aktivitete me qëllim mbrojtjen e shëndetit mendor.

I huaj përkohësisht në territorin italian (STP)

Qytetarëve të huaj, të cilët ndodhen në mënyrë të parregullt në territorin italian, u lëshohet një kod identifikimi, i quajtur S.T.P. (Straniero Temporaneamente Presente), i vlefshëm për 6 muaj.

Kur qytetari i huaj ka nevojë për shërbimet mjeksore dhe shkon pranë strukturave ku ofrohen këto lloje shërbimesh, strukturat nuk mund të denoncojnë faktin pranë autoriteteve policore, me përjashtim të rasteve kur parashikohet nga ligji.

Mund të përfitoj shërbimet shëndetësore edhe në rast se nuk mund t'i paguaj?

Nëse qytetari i huaj nuk mund të paguaj të gjithë shërbimin, mund të paguaj vetëm një pjesë të tij (quota di partecipazione).

Qytetari i huaj i cili nuk mund të paguaj shumën e parashikuar (situazione di indigenza) mund të mos e paguajë, duke nënshkruar një deklaratë “dichiarazione di indigenza”, e vlefshme për 6 muaj.

Cilat janë shërbimet që mund të përfitoj, edhe nëse nuk kam mundësi për të paguar?

Ashtu si edhe për qytetarët italianë, edhe i huaji, i cili është i parregullt në territorin italian, në kushte pamundësie për të paguar, mund të përfitojë këto shërbime:

- shërbime shëndetësore të nivelit të parë;
- urgjenca;
- shtatzani;
- patologji të përcaktuara;
- subjekte të përjashtura për shkakun e moshës ose për gjendje të rënda invaliditeti.



arsimi
arsimi

Shkollimi dhe formimi: e drejtë dhe detyrim

Në Itali ekziston e drejta – detyra e shkollimit dhe e formimit, e cila fillon në moshën 6 vjeçare.

Sistemi kombëtar i arsimit përbëhet nga shkollat publike dhe private.

Arsimi i detyruar është ndërtuar në dy cikle shkollimi: i pari, përbëhet nga shkolla fillore dhe nga cikli i dytë i nivelit të parë. Cikli i dytë, përbëhet nga sistemi i shkollave të mesme dhe cikli i shkollimit e formimit profesional. Të gjitha drejtimet e ciklit të dytë të lejojnë të vazhdojnë studimet në Universitet.

Çerdhja

Në çfarë moshe mund të rregjistroj fëmijët në çerdhe?

Të miturit mund të rregjistrohen në çerdhe kur mbushin tre muaj deri në tre vjeç.

Sa vjet mund të çoj fëmijët në çerdhe?

3 vjet.

Kush e administron çerdhen?

Komunat ose subjektet private.

Si të veprojmë për rregjistrimin e fëmijës në çerdhen e komunës?

Duhet të bësh kërkesën në periudhat e caktuara nga Komuna. Në kërkesë mund të përcaktosh deri në 4 çerdhe në rradhë sipas pëlqimit, pavarësisht nga zona ku ti banon. Kërkesa do të konsiderohet sipas pikëve që do të fitojë gjithmonë duke patur parasysh kushtet e punës së prindërve, në se ka apo jo fëmijë të tjerë në ngarkim si dhe probleme të tjera shoqërore dhe shëndetësore. Në këtë mënyrë, sipas prioriteteve përcaktohet radha e hyrjes. Sipas rradhës (graduatoria): ka pak vende dhe shumë kërkesa. Për t'u informuar më mirë mund të drejtohesh pranë Komunës së rezidencës meqë kushtet e pranimit ndryshojnë në funksion të rregullave të komunës së referimit.



Sa kushton rregjistrimi në çerdhe?

Pagesa është e ndryshme në bazë të të ardhurave; pagesa në çerdhe private përcaktohet nga vetë struktura. Duke u nisur nga viti shkollor 2007-2008 është krijuar një shërbim i ri që i kushtohet fëmijëve 2 vjeçarë: Seksionet Pranvera. Janë seksione cerdheje që lidhen me shkollat e foshnjërisë private ekuivalente dhe që i drejtohen fëmijëve nga 24 në 36 muaj, të autorizuara për funksionim. Për të përfituar duhet t'i drejtoheni direkt administratorit të shkollës.

Kopshti

Në çfarë moshe mund të rregjistroj fëmijët në kopësht?

Të miturit mund të rregjistrohen në kopësht kur mbushin 3 vjeç brenda datës 30 prill të vitit në vijim.

Sa vjet mund të çoj fëmijët në kopësht?

3 vjet.

Kush e administron kopshtin?

Komunat, Shteti ose privatët.

Ku duhet të drejtohem për t'u informuar më mirë?

Pranë Departamentit të Shërbimeve Shkollore të Komunës tënde për rregjistrimin në kopësht; pranë sekretarisë të shkollës që të intereson, në rastet e tjera. Për të hyrë në kopshtin publik, duhet respektuar rradha.

Sa kushton rregjistrimi në kopësht?

Pagesa është e ndryshme në bazë të të ardhurave. Pagesa në kopshtet private përcaktohet nga vetë struktura.

Cikli i parë

SHKOLLA FILLORE

Në çfarë moshe mund të rregjistroj fëmijët në shkollën fillore?

Për klasën e parë, rregjistrimi është i detyrueshëm në moshën 6 vjeçare, fakultativ në moshën 5 vjeç e gjysëm (mund të rregjistrohen në kopësht të miturit të cilët mbushin 6 vjeç brenda datës 30 prill të vitit në vijim).



Vini re: Ligji, në lidhje me regjistrimin fakoltativ në shkollën fillore në mos-hën 5 vjeç e gjysëm, mund të pësojë ndryshime në të ardhmen. Për informacione më të hollësishme drejtohu në shkollën që ke zgjedhur.

Sa vjet zgjat shkolla fillore?

5 vjet.

Ku duhet të drejtohem për t'u informuar më mirë?

Pranë Drejtorisë së shkollës ose pranë Komunës së rezidencës.

CIKLI I DYTË I NIVELIT TË PARË

Çfarë është?

Është një fazë formimi e menjëhershme pas shkollës fillore.

Sa zgjat?

3 vjet.

Ku duhet të drejtohem për t'u informuar më mirë?

Pranë Drejtorisë së shkollës ose pranë Komunës së rezidencës apo pranë shkollës private.

Cikli i Dytë

Çfarë është?

Cikli i dytë përbëhet nga sistemi i shkollave të mesme si edhe nga sistemi i shkollimit-formimit profesional. Të gjitha drejtimet e ciklit të dytë të lejojnë të vazhdojnë studimet në Universitet.

Vini re: duke u nisur nga viti shkollor 2010/2011, në vijim të aprovimit të reformës që ka modifikuar sistemin shkollor italyan, do të riorganizohen gjimnazet dhe shkollat teknike e profesionale. Do të realizohet nga Ministria kompetente një Fushatë informimi për të ilustruar të rejtat dhe për të orientuar studentet. Çdo informacion gjendet në web site: www.pubblica.istruzione.it

Mund të kaloj nga njëri drejtim tek tjetri?

Po, madje mund të ndërrosh edhe degën brenda llojit që ke zgjedhur, duke ndjekur nisimat didaktike që shkolla të vë në dispozicion; duke filluar nga



15 vjeç, parashikohen mundësi të ndryshme shkollimi:

- studim me kohë të plotë;
- shkollë-punë nëpërmjet praktikës pranë vendeve kulturore, shoqërore dhe prodhuese edhe jashtë Shtetit;
- praktika.

SHKOLLAT E MESME

Cilët janë llojet e shkollave të mesme ku mund të studjohet në Itali?

Artistike, Klasike, Shoqërore e Psico-Pedagogjike, i Gjuhëve të huaja, Shkençor. Shkollat e mesme ndahen në dy pjesë, dyvjeçare e trevjeçare.

Sa zgjat?

5 vjet.

Në fund të shkollës së mesme, duhet të jap provime?

Po, në fund të vitit të pestë, provimin e Shtetit. Shërben për regjistrimin në Universitet si edhe në formimin e mëtejshëm në fushën artistike, muzikore dhe koreografike, në ciclin e shkollimit dhe formimit teknik superior (IFTS).

Shkollimi Teknik dhe Shkollimi Profesional

Shkollimi teknik zgjat 5 vjet dhe i përgjigjet nevojave precize të realitetit produktiv italian, në mënyrë të vecantë në fushën e tregtisë, të turizmit, të industrisë, të transportit, të ndërtimit, të bujqësisë dhe të aktiviteteve të karakterit social (drejtuar personave). Ekzistojnë shumë drejtime dhe nivele të specializimit. Kryesorët janë: llogaritar, teknik tregu, teknik industrial, teknik bujqësor, gjeometër, teknik për turizëm.

Shkollimi profesional zgjat 5 vjet, por parashikon mundësinë e marrjes së kualifikimit profesional pas tre viteve të parë.

Të dy drejtimet përfundojnë me një provim shteti dhe lejojnë hyrjen në të gjitha llojet e formimit të nivelit të tretë (Universitet, AFAM, IFTS).

SHKOLLIM DHE FORMIMI PROFESIONAL (IFP)

Çfarë është?

Flitet për një shkollim prej 3 e 4 vjetësh pas të cilëve mund të marrësh certifikata kualifikimi profesional, të njohura në nivel kombëtar dhe evropian e që mund të shfrytëzohen menjëherë për t'u punësuar.



Më pas, mund të rregjistrohem në Universitet?

Po, por vetem nëse ke një diplomë të pakten 4 vjeçare dhe të kesh frekuentuar vitin e pestë të përgatitjes në provimin e Shtetit, i nevojshëm për rregjistrimin në Universitet si edhe në formimin e larte në fushën artistike, muzikore dhe koreografike. Diploma 4 vjeçare e marrë në përfundim të shkollimit dhe formimit profesional të jep edhe të drejtën për të vazhduar shkollimin dhe formimin teknik të lartë.

Universiteti

Çfarë është Universiteti?

Është një sistem shkollimi, i ndarë në dy nivele, i cili parashikon për çdo fakultet:

- nivelin e parë të shkollimit prej tre vjetësh (Diploma);
- nivelin e dytë të shkollimit prej dy vjetësh (Diploma sipas specialitetit).

Kush mund të rregjistrohet në Universitet?

Personat që janë të pajisur me Diplomën e Pjekurisë të lëshuar nga një shkollë e mesme mund të rregjistrohen në Universitet.

Si të veproj për t'u rregjistruar në Universitet?

Rregjistrimi në Universitetet italjane ndryshon sipas llojit të të huajit:

- qytetarët komunitarë kudo që janë rezidentë ose qytetarët jokomunitarë rezidentë në Itali trajtohen në mënyrë të barabartë me qytetarët italianë në rregjistrim;
- qytetarët e huaj që jetojnë në Itali të pajisur me lejeqëndrim të vlefshëm;
- qytetarët e huaj rezidentë jashtë Shtetit të pajisur me vizë për studime.

Çfarë titulli studimi duhet të kem për t'u rregjistruar në Universitet?

Një diplomë të cilën e ke marrë për një periudhë shkollore prej 12 vjetësh. Nëse periudha e studimeve është më e ulët se 12 vjet, studentët duhet të paraqesin, përveç diplomës origjinale të shkollës së mesme, edhe një certifikatë shkollore që dëshmon kalimin e të gjitha provimeve të parashikuara:

- për vitin e parë të universitetit, në rast se sistemi shkollor i vendit zgjat 11 vjet;
- për dy vjetët e para të Universitetit, në rast se sistemi shkollor i vendit zgjat 10 vjet.



Ku dhe kur duhet të paraqes kërkesën për rregjistrim?

Kërkesa për rregjistrim duhet të paraqitet pranë sportelit të Sekretarisë për Studentët me diplomë të huaj, në afate të njëjta me ato të parashikuara për studentët italianë: zakonisht, ndërmjet Korrikut dhe Shtatorit.

Çfarë dokumentash duhet të paraqes për t'u rregjistruar?

Diplomën, të përkthyer dhe noterizuar nga përfaqësia diplomatike italjane në vendin e origjinës.

Sa është numri i vendeve në Universitet, të caktuara për studentët e huaj rezidentë jashtë Italisë?

Vendet, për studentët e huaj, përcaktohen nga vetë Universitetet për çdo vit shkollor dhe mund të konsultohen në siton Internet të Ministrisë së Arsimit, të Universitetit dhe të Kërkimeve: *www.miur.it*.

Nëse kam një diplomë të gjuhës italjane, ky fakt më ndihmon në rradhën e studentëve të huaj për të hyrë në Universitetet italjane?

Po, sipas Universiteteve, mund të të ndihmojë:

- diploma e gjuhës dhe kulturës italjane pranë Univeriteteve për të huajt të Peruxhas dhe Sienës;
- çertifikata e njohjes së gjuhës italjane e lëshuar nga Universiti i III-të i Studimeve në Romë, ose nga Universiteti për të huajt i Peruxhas dhe Sienës;
- çertifikata e njohjes së gjuhës italjane e lëshuar jashtë Shtetit.

Jam një student universitar. Mund të rinovoj lejeqëndrimin për motive studimi?

Vizat dhe lejeqëndrimet për motive studimi u rinovohen studentëve të cilët:

- në vitin e parë të studimeve kanë kaluar një provim dhe në vitet në vijim të paktën dy provime;
- në rast se studenti ka probleme të rënda shëndetësore, të dokumentuara, lejeqëndrimi mund të rinovohet edhe kur ka kaluar vetëm një provim.

Lejeqëndrimi nuk mund të rinovohet për më shumë se 3 vjet nga data e përfundimit të kursit të studimeve.



Kam ardhur në Itali për të frekuentuar Universitetin. Mund të ndërroj degë?

Po, vetem me autorizim të Universitetit.

Mund të kërkoj rinovimin e lejeqëndrimit për të kryer specializimin apo doktoraturën?

Po.

Sa kushton rregjistrimi në Universitet?

Varet nga Universiteti dhe nga fakulteti që zgjedh. Në çdo rast, shpenzimet e arsimit universitar mund të jenë të larta.

Mund të përfitoj një bursë studimi apo ndihma të tjera ekonomike?

Po, studentët e huaj mund të përfitojnë, ashtu si edhe studentët italianë, shërbime të ndryshme për të ndihmuar studimet: bursa studimi, ndihma ekonomike dhe strehim. Krahinat, mund të lejojnë edhe ndjekjen falas të Universitetit nga studentët e huaj të cilët ndodhen në kushte të rënda ekonomike, të dokumentuara. Për hollësi të mëtejshme mund të drejtohesh në Sekretarinë e Studentëve të Huaj në Universitetin që dëshiron të frekuentosh.

Shkollimi dhe formimi teknik i lartë (IFTS)

Për çfarë shërben?

Janë shkollime të një specializimi të lartë teknik e profesional me kohëzgjatje të ndryshme nga një deri në dy vjet, që përfshijnë edhe praktika prodhuese me afate të gjata. Përgatisin teknikë të nivelit të lartë shumë të kërkuar nga tregu i punës.

Kush e administron?

Formimi IFTS bën pjesë në programin e planit formues të Rajoneve, sipas një plani 3 vjeçar. Aktualisht po përgatitet programi 2007-2009.

Për të njojtur të gjitha llojet e formimeve, shiko sitin http://www.pubblica.istruzione.it/dg_post_secondaria/figure_nazionali.shtml, ose <http://www.bdp.it/ifts/2003/home.php>.



Sa kushton ndjekja e një kursi?

Zakonisht është falas; në disa raste, parashikohet edhe një rimbursim i shpenzimeve.

Çfarë kërkesash duhet të plotësoj për t'u pranuar në një kurs formimi profesional?

- Njohje e mirë e gjuhës italiane;
- Te kesh një diplomë shkolle të mesme ose një diplomë 4 vjecare të shkolimit dhe formimit profesional (IFP).

Njohja titujve të studimeve

Dëshiroj të vazhdoj studimet në Itali. Si duhet të veproj?

Duhet të paraqesësh kërkesën pranë Universitetit ose Institutit që të intereson. Në kuadrin e autonomisë dhe të marrëveshjeve dypalëshe si edhe të konventave ndërkombëtare në këtë fushë, janë ato që vendosin për njohjen e titujve të huaja të studimeve.

Kërkesës i bashkëngjiten dokumentat e mëposhtëm:

- fotokopje e diplomës së pjekurisë e përkthyer, legalizuar dhe e autentifikuar nga përfaqësia diplomatike italiane e vendit;
- fotokopje e diplomës universitare, e përkthyer, legalizuar dhe e autentifikuar nga përfaqësia diplomatike italiane e vendit;
- certifikatë e provimeve universitare, e përkthyer dhe e legalizuar;
- programi i studimeve që ke kryer;
- fotokopje e dokumentit të identitetit apo të lejëqëndrimit.

Çfarë ndodh më pas?

Autoritetet e shkollës marrin në shqyrtim titullin tënd të studimeve, duke e konsideruar të barasvlefshëm të gjithin ose një pjesë të tij me diplomën universitare italiane: në rastin e parë, të njihen të gjitha provimet; në rastin e dytë, vetëm disa prej tyre. Universiteti duhet të vendosë brenda 90 ditësh nga dorëzimi i kërkesës.



Njohja e titujve profesionale

Kam kryer shkollën ku kam marrë një titull profesional. Ku duhet të drejtohem, në Itali, për njohjen e titullit të studimeve?

Për titujt profesionalë duhet t'i drejtohesh Ministrisë kompetente.

Sa kohë zgjat njohja e titujve të studimeve?

Brenda 30 ditësh nga data e marrjes së kërkesës, Ministria përkatëse merr në shqyrtim dokumentacionin.

Brenda 4 muajsh nga paraqitja e kërkesës si edhe plotësimi i saj, Ministria nxjerr një dekret mbi njohjen e titullit tënd të studimeve.

Jam mjek/infermier. Ku duhet të drejtohem, në Itali, për njohjen e titullit të studimeve?

Për titujt në fushën e infermierisë dhe mjeksisë, duhet t'i drejtohesh Ministrisë së Punes, të Shëndetësisë dhe të Politikave Sociale.

Jam avokat/ llogaritar/ biolog/ kimist/ agronom/ gjeolog /inxhinjer/ psikolog/ konsulent pune/gjeometër/gazetar/punonjës i kualifikuar në bujqësi dhe industri. Ku duhet të drejtohem, në Itali, për njohjen e titullit të studimeve?

Ministria kompetente për njohjen e titujve profesional të mësipërm është Ministria e Drejtësisë.

Jam konsulent për pronësinë industriale/ndërmjetës tregëtar. Ku duhet të drejtohem, në Itali, për njohjen e titullit të studimeve?

Ministria kompetente për njohjen e titujve profesional të mësipërm është Ministria e Zhvillimit Ekonomik.

Jam mësues. Ku duhet të drejtohem, në Itali, për njohjen e titullit të studimeve?

Ministria kompetente për njohjen e titujve profesional të mësipërm është Ministria e Arsimit, e Universitetit dhe e Punes Shkencore.



tutelimi i të drejtave
dhe
diskriminimi

tutelimi i të drejtave
dhe
diskriminimi

Tutelimi i të drejtave

Eshtë e mundur për një qytetar të huaj të mbrojë me gjygj të drejtat e tij?

Po, sikurse edhe qytetaret italianë. Po të jesh në pozitë të paligjshme, të veprosh me gjygj për tutelimin e të drejtave tua, nuk e pengon Shtetin të aplikojë largimin tënd nga territori i Shtetit, me përjashtim të rasteve të vecanta.

Në cilat organe mund të tuteloj të drejtat e mia?

Në Gjykatat e sistemit italian nëpërmjet një avokati mbrojtës.

Si është i strukturuar sistemi gjygjësor italian?

Mund të ekzistojnë më shumë se një gjykates para të cilëve të mund të mbrosh të drejtat e tua: gjykatesi civil, penal dhe administrativ, kompetencat e të cilëve janë të përcaktuara nga ligjet e Shtetit italian.

Kush është gjykatësi i paqes?

Eshtë një gjykatës nderi të cilit mund t'i drejtohesh për të zgjidhur mosmarrveshje të vogla administrative që nuk kapërcejnë një vlerë të caktuar (p.sh grindje midis banorëve të pallatit), vendos mbi mosmarrveshjet që lidhen me kodin rrugor, ka kompetenca penale të kufizuara dhe konfirmon vendimet e prefektit në fushën e dëbimit nga territori i shtetit dhe vendimet e shoqërimit në kufi ose të mbajtjes së detyruar në një qendër pritjeje të përkohshme, të nxjerra nga Questori.

Cilit gjykatës duhet t'i drejtohem për çështjet lidhur me titullin tim të qëndrimit?

Gjykatës administrative rajonale dhe po të jetë e nevojshme, mund të cosh në gjygjën e apelit vendimet e këtij gjygtari në Këshillin e Shtetit që i ka zyrat në Romë. Gjykatës civile në fushën e unitetit familjar (psh. bashkimi familjar).

Sa kushton procesi gjygjësor?

Ekzistojnë kosto fikse që lidhen me tipin e mosmarrveshjes që diskutohet dhe që i shtohen koston së mbrojtjes të parapërgatitur nga avokati yt. Në çdo rast shteti italian i garanton të gjithëve të drejtën për t'u mbrojtur dhe për



të tuteluar të drejtat e veta, prandaj, në mungesë të mjeteve ekonomike të nevojshme, mund të përfitohet nga patronazhi falas, me shpenzimet e shtetit, me kushtet e vendosura nga ligjet shtetërore.

Nëse nuk mund të pagoj një avokat, mund të kem një avokat zyre?

Jo, Shteti të garanton mundësinë për t'u përfaqësuar nga një avokat i besuar i zgjedhur nga ti vetë, duke përfituar nga patronazhi falas me shpenzimet e shtetit, edhe pse nuk je present në mënyrë të rregullt dhe nuk kalon kufijtë e të ardhurave të parashikuara nga ligji; është e nevojshme që ti të jesh titullar i të ardhurave vjetore që rezultojnë nga deklarimi i fundit të të ardhurave, jo më shumë se 10.628,16 euro (shtator 2009).

Kam qenë denoncuar dhe nuk njoh një avokat: çfarë mund të bëj?

Në këtë rast mund të të caktohet një avokat zyre, i zgjedhur nga një listë e posacme. Po të kalosh kufijtë e të ardhurave dhe nuk mund të kërkosh të përfitosh nga patronazhi falas, duhet të bësh pagesën e duhur në bazë të tarifave të parashikuara.

Çfarë ndodh nëse nuk arrij të kuptoj vendimet gjyqësore?

Ke të drejtë të caktosh një përkthyes që të përkthejë vendimet gjyqësore në gjuhën time. Kostoja e përkthyesit mund të vihet në ngarkim të shtetit nëse gjendja ime ekonomike më lejon të përfitoj nga patronazhi falas, me shpenzimet e Shtetit italian.

Diskriminimi

Kam dëgjuar që ekziston një ligj që të mbron nga diskriminimi. Po çfarë nënkuptohet me saktë në ligj me akt diskriminimi?

Përbën diskriminim cdo sjellje që direkt ose indirekt, sjell një dallim, përjashtim, kufizim ose preferencë bazuar në razën, ngjyrën, prejardhjen ose origjinën kombëtare ose etnike, bindjet ose praktikat fetare dhe që ka si qëllim ose efekt të shkatërroje ose të kompromentojë njohjen, gëzimin apo ushtrimin, në kushte të barabarta të të drejtave njerëzore dhe të lirive themelo-



re në fushën politike, ekonomike, sociale e kulturele dhe në cdo sektor tjetër të jetës shoqërore.

Si mund të mbrohem përballë akteve diskriminuuese të kryera nga një privat ose nga Administrata Publike?

Mund t'i drejtohesh gjykatës civile, nëpërmjet një avokati, duke kërkuar që gjykatësi të urdhërojë ndalimin e sjelljes me paragjykim dhe të adoptojë cdo vendim tjetër të përshtatshëm, sipas rrethanave, për të eliminuar efektet e diskriminimit.

Jam viktimë e diskriminimit por kam frikë të denoncoj. Cfarë mund të bëj?

Shoqatat e regjistruara në një regjister të posacëm pranë Dipartimentit të Shanceve të Barabarta, nën Presidencën e Këshillit të Ministrave, janë të lejuara me ligj të veprojnë me gjygj në emër, për llogari ose në mbështetje të subjektit pasiv të diskriminimit të bazuar në motive rraziale ose etnike.

Jam viktimë e diskriminimit në punë. Cfarë mund të bëj?

Organizatrat sindakale mund të veprojnë juridikisht për të tuteluar viktimat e diskriminimit kur punëdhënësi kryen një diskriminim të karakterit kolektiv.



deklarata
e të
ardhurave
deklarata
e të
ardhurave

Informacione të përgjithshme

Deklarata e të ardhurave është dokumenti nëpërmjet të cilit Shteti njih kush-tet ekonomike dhe vendos shumën e taksave që duhen paguar.

Deklarata e të ardhurave duhet paraqitur nga të gjithë personat që vitin e mëparshëm kanë patur të ardhura si edhe nga sipërmarrësit, punonjësit e pa-varur me TVSH, edhe në se nuk kanë patur të ardhura. Deklarata e të ardhurave paraqitet sipas modeleve që përgatit Agjencia e taksave (Agenzia delle Entrate). Modelet ndryshojnë sipas titullarit që paraqet deklaratën: person fizik apo shoqëri. Për personat fizikë përdoret modeli Unik (modello Unico) (persona fizikë) ose në se deklaruesi është punonjës i varur, bashkëpunëtor projekti apo pensionist – modeli 730. Modele të tjera janë edhe modeli 770 (për punëdhënësin) dhe Red për pensionistët.

Për çfarë shërben deklarata e të ardhurave?

Për të huajt ka rëndësi të veçantë në këto raste:

- rinovim i lejeqëndrimit;
- kërkesë për kartën e qëndrimit;
- kërkesë për bashkim familjar;
- shtetësi.

Ky model është i rëndësishëm edhe kur:

- duhet të marrësh një kredi bankare;
- duhet të kryesh një blerje me këste;
- duhet të marrësh një shtëpi me qira;
- duhet të qartësosh pozicioni tënd ekonomik me Ministrinë e Financave.

KUDI

Çfarë është Kud-i?

KUD është Çertifikata e Vetme e të Ardhurave nga Puna e Varur si dhe të ardhurave të tjera që duhen deklaruar.

Në KUD bëjnë pjesë:

- të ardhurat e vitit të mëparshëm;
- mbajtjet, mbetjet dhe heqjet;



- të dhënat e sigurimit shoqëror të lidhura me kontributet e derdhura në INPS dhe në INPDAP;
- shuma e kontributeve të sigurimeve shoqërore në ngarkim të punonjësit, e derdhur ose e gatshme për t'u derdhur në Entet e Sigurimit Shoqëror. Punëdhënësit ose Entet publikë ose privat, që parashikojnë shërbime mbi pensionin, duhet t'i dorëzojnë çertifikatën e KUD-it, në dy kopje, punonjësit me kontratë pune të varur, pensionistit, ose personave që marrin të ardhura të tjera të cilat, duhen deklaruar njësoj si të ardhurat e punës së varur.

Modeli 730

Kujt i leverdis modeli 730?

Të leverdis të prezantosh modelin 730 në se je punonjës i varur apo pensionist. Në këtë rast, është punëdhënësi yt apo subjekti që të jep pensionin, apo qendra e ndihmës fiskale (Caaf), ku je drejtuar, që ja kalon deklaratën tënde të të ardhurave administratës financiare.

Mund të paraqesin deklaratën e të ardhurave duke përdorur Modelin e thjesh-të 730 personat që kanë familjarë në ngarkim (burrë, grua, fëmijë) edhe në se këta nuk janë rezidentë në Itali.

Cilat janë avantazhet e Modelit 730?

Nuk ka nevojë të bësh llogari. Në se ke derdhur më shumë para se sa duhet, diferenca do të të derdhet në dokumentin e pagës ose në këstin e pensionit të muajit korrik.

Në se ke derdhur më pak, do të të mbahet direkt nga paga jote ose pensioni shuma që i takon Tatim-taksave.

Çfarë dokumentash duhet të paraqes?

- Deklaratën e të ardhurave të vitit të mëparshëm;
- dokumentin e kadastrës;
- çertifikatën e të ardhurave nga puna e varur, nga bashkëpunimet, nga puna e pavarur e përkohshme, nga kapitalet etj;
- biletat dhe faturat e shpenzimeve që mund të shkarkohen nga taksat (shpenzime mjeksore, interesa pasive, shpenzime varrimi, veterinarie, sigurime



mbi jetën dhe dëmtimet fizike, kontribute vullnetare, kontributet e siguri-
meve shoqërore të detyrueshme, kontribute për persona që shërbejnë në
ambjente shtëpijake, shuma të derdhura për partitë politike, insitutet fetar-
re, shoqëritë ONLUS, shpenzime për aktivitete që kanë të bëjnë me ruajt-
jen e pasurisë ndërtimore etj.);

- certifikatat e shumave të derdhura drejtpërdrejtë.

Cilat janë të ardhurat që duhet të deklaroj?

- Të ardhurat nga puna e varur;
- të ardhurat e ngjashme me ato të punës së varur;
- të ardhurat nga terrenet ose godinat;
- të ardhura nga kapitale;
- të ardhura nga puna e pavarur për të cilat nuk kërkohet TVSH-ja;
- disa të ardhura të ndryshme;
- disa të ardhura që taksohen veçmas.

Si paraqitet deklarata?

Modeli 730 duhet të paraqitet i përpiluar nga punëdhënësi ose enti i pen-
sionit. Dokumentimi i taksave (dokumentat në lidhje me shpenzimet që mund
të shkarkohen) duhet të ruhet për të paktën 5 vjet, sepse administrata mund
ta kërkojë për shqyrtime të mëtejshme.

Personat, të cilët nuk paraqesin deklaratën e të ardhurave brenda kufijve ko-
horë të caktuar nuk rimborsohen për vitet e shkuara. Nëse nuk kanë paguar
taksat, dënohen nga 120% deri në 240% mbi shumën e papaguar.

Si të veprojmë nëse kam bërë një gabim?

Nëse kupton se ke bërë gabime gjatë përpilimit të Modelit, mund t'i kor-
rigjosh nëpërmjet paraqitjes së një deklarate shtesë. Duhet të përdorësh Mo-
delin 730 në të cilin duhet të vësh kryq në kutinë “730 integrativo”, që du-
het të paraqitet brenda kohës së caktuar, pranë një qendre asistence tatimor-
re të autorizuar.



Modeli Unik

Ku ta paraqes Modelin Unik?

Personat fizikë duhet të paraqesin Modelin Unik:

- në bankë ose në postë, në se e paraqesin në letër; kjo mënyrë i drejtohet subjekteve që nuk janë titullarë TVSH-j;
- nëpërmjet transmetimit elektronik; kjo është e vlefshme si për subjektet e detyruara nga ligji për transmetimin nëpërmjet këtij sistemi, ashtu edhe për subjektet/personat që dësherojnë të përdorin Internetin për komoditet.

Për subjektet juridike mënyrat e paraqitjes së Deklaratës janë të njëjta me ato të parashikuara për personat fizikë.

Kush duhet të paraqesë Modelin Unik?

- Personat që nuk kanë KUD dhe që nuk mund të paraqesin modelin 730;
- personat që bëjnë më shumë se një punë (psh. personat që bëjnë 2 punë njëkohësisht, ose që kanë punuar për disa muaj të vitit në një ndërmarrje dhe më pas në një tjetër);
- personat që vitin e shkuar kanë punuar në rregulla por që këtë vit nuk punojnë më;
- bashkëpunëtorë familjarë dhe kujdestarë (Colf dhe badanti).

Çfarë dokumentash duhet të paraqes?

- Deklaratën mbi të ardhurat e vitit të mëparshëm;
- të dhënat e gjendjes civile familjare dhe kodet fiskale të familjarëve në ngarkim;
- KUDI-in e vitit të mëparshëm;
- dokumentat në lidhje me të ardhurat e prodhuara (psh. të gjitha aktivitetet që ke kryer me TVSH);
- fatura etj.

Çfarë dokumentash duhet të paraqesin bashkëpunëtorët familjarë dhe kujdestarët (Colf dhe badanti)?

- Deklaratën e punëdhënësit mbi të ardhurat e vitit të mëparshëm;
- faturat e pagesës INPS;
- faturat e pagesës së IRPEF;



- kontratën e qerasë;
- faturat.

A mund të përfitoj ndonjë zbritje nga taksat?

Po, për disa shpenzime (të ashtuquajturat “oneri deducibili e detraibili”) Shteti të njuh një zbritje nga taksat:

- shpenzime mjeksore, faturat e ilaçeve, syzet, faturat e dentistit dhe shpenzime të tjera shëndetësore;
- taksat shkollore;
- sigurimet e jetës, makinës etj;
- kontributi i sigurimeve shoqërore, faturat INPS për bashkepunëtorët familjarë;
- interesat mbi kredinë e shtëpisë.

Çfarë është taksa Irpef?

Është shuma që duhet të derdhësh paraprakisht për taksat mbi të ardhurat e vitit në vazhdim. Për të përcaktuar në se është e nevojshme apo jo, duhet të mbash parasysh taksat që ke paguar mbi të ardhurat e vitit të shkuar.

Si mund të korrigjoj gabimet e bëra?

Në se në fund të viti kupton se ke derdhur një shumë më të ulët se sa duhej, mund të shfrytëzosh të ashtuquajturin “ravvedimento operoso”, dmth të derdhësh përveç shumës që mungon edhe dënimin prej 6% interesa mbi shumën si edhe interesat prej 3% në vit për çdo ditë vonesë. Gjithshka duhet kryer brenda kufirit të caktuar për deklarimin e të ardhurave: në se nuk e respekton këtë kufi kohor, do të paguash dënimin 30% mbi shumën që nuk ke derdhur përveç interesave.

Ku mund t’ a gjej KUD-in, Modelin 730 dhe Modelin Unik?

Mund t’ i shkarkosh falas nga faqja internet e Ministrisë së Ekonomisë dhe Financave ose nga faqja internet e Agjensisë së taksave.



Modeli 770

Çfarë është Modeli 770?

Modeli 770 i drejtohet vetëm personave të cilët kanë paguar punën e të tjerëve dhe jo atyre që kanë marrë shpërblimin. Ky model përdoret nga subjektet (psh. punëdhënësit) për të deklaruar shpërblimet dhe pagesat e kryera. Prej vitit 2002, deklarata e subjekteve (sostituti d'imposta) ndahet në dy pjesë të cilat konsiderohen dy deklarata të mëvetësishme:

- Modeli 770 i thjeshtë, që ka të bëjë me takstat ndaj vartësve, bashkëpunëtorëve, punonjësve të pavarur, bashkëpunëtorëve të përkohshëm. Ky Model nuk mund t'i bashkëngjitet Modelit Unik por duhet të paraqitet veçmas;
- Modeli 770 i zakonshëm shërben për taksat e tjera. Në këtë rast mund t'i bashkëngjitet e Modelit Unik.

Ku mund t'a paraqes Modelin 770?

Modeli 770 duhet të paraqitet detyrimisht nëpërmjet Internetit, drejtpërdrejtë ose nëpërmjet ndërmjetësit të autorizuar. Njihet si datë dërgimi dita e nisjes nëpërmjet internetit në agjensinë e taksave. Deklaratën nuk mund t'a paraqesësh pranë bankave të konvencionuara apo postave dhe personat që janë jashtë shtetit nuk mund t'a dërgojnë me rekomandë.

Ku gjendet Modeli 770?

Mund ta shkarkosh falas nga faqja internet e Ministrisë së Ekonomisë dhe Financave ose nga faqja e agjensisë së taksave.

Red, ICI, ISEE

Çfarë është RED?

Red është deklarata që duhet të paraqitet nga pensionistët të cilët përfitojnë shërbime të sigurimeve shoqërore përveç pensionit, të ofruara nga INPS sipas të ardhurave. Kjo bëhet me qëllim që, sipas të ardhurave, pensionistët të kenë mundësi të përfitojnë nga këto shërbime.



Çfarë është ICI (Taksa Bashkiake mbi Godinat)?

Është një taksë që duhet paguar nga personat pronarë të terreneve bujqësore, të zonave ndërtimore dhe godinave; paguhet pranë Komunës ku ndodhet godina.

Çfarë është ISEE (Situata Ekonomike e Momentit)?

Është çertifikata mbi të ardhurat e bërthamës familjare, e nevojshme për të përfutuar nga shërbimet shoqërore të Enteve publike (çeku për fëmijën e tretë, çeku për shtatzaninë etj).



banka
banka

Shërbimet bankare

Cilat janë shërbimet bankare që mund të më shërbejnë?

Zakonisht shërbimet më të kërkuara janë librezja e kursimit, llogaria bankare (e nevojshme në se dëshiron të kesh librezë çequesh, kartën bancomat, kartën e kredisë), dërgimi i parave, borxhe dhe kredi bankare për blerjen e banesës.

Çfarë është librezja e kursimit?

Librezja e kursimit është një mekanizëm i thjeshtë dhe me kosto të ulët i cili i vlen më shumë personave që nuk kryejnë lëvizje të shumta të hollash. Mund të jetë “nominativo” dmth në emër të personit fizik apo juridik ose në emër të personit i cili, kur paraqitet në sportel, ka të drejtë të depozitojë apo të tërheq të hollat. Interesat llogariten dhe ngarkohen një herë në vit.

Duhet të hap një librezë kursimi, si të veprojmë?

Zgjidh bankën ku dëshiron të hapësh librezën e kursimit, shko duke marrë me vete:

- kodin fiskal;
- lejeqëndrimin.

Disa banka mund të të kërkojnë edhe:

- busta pagën;
- çertifikatën e rezidencës.

Çfarë është llogaria bankare?

është një llogari ku mund të depozitosh paratë e tua, e cila të jep edhe interese, për paratë e derdhura, të caktuara nga banka. Për të tërhequr paratë duhet të plotësosh një formular pranë sportelit të bankës, mund të lëshosh një çek në emrin tënd “Me medesimo” ose të përdorësh Bankomat-in. Paratë e çeqeve të tua ose të çeqeve që të kanë lëshuar, mund t’i tërheqësh pranë bankës tënde. Disa banka kërkojnë të paguash librezën e çeqeve dhe/ose çeket e lëshuara.

Duhet të hap një llogari bankare, si të veprojmë?

Zgjidh bankën ku dëshiron të hapësh llogarinë bankare, shko duke marrë me vete:

- kodin fiskal;



- lejeqëndrimin.
- Disa banka mund të të kërkojnë edhe:
 - çertifikatën e rezidencës (por nuk është më e detyruar me ligj);
 - garancinë e një klienti tjetër, të huaj ose italian, të njohur nga banka;
 - deklaratën e të ardhurave;
 - derdhjen e një shume të caktuar parash;
 - në ndonjë rast, përpara se të hapi llogarinë bankare, banka i kërkon punëdhënësit një deklaratë që klienti është vartës apo bashkëpunor i tij.

Çfarë është Bankomati?

Bankomati është një kartë manjetike që mund t'a kërkojë pasi ke hapur një llogari bankare. Bankomati është karta kombëtare e kredisë dhe mund të përdoret në të gjitha sportelet automatike bankomat të vendit (në disa raste edhe jashtë Italisë) për të tërhequr të holla (ATM). Mund të paguash me Bankomat edhe në supermerkatot apo dyqanet që ofrojnë këtë shërbim (POS).

Çfarë është Karta e kredisë?

Edhe Karta e kredisë është një kartë manjetike që mund t'a kërkojë pasi ke hapur një llogari bankare. Përveç përparësive që të lejon Bankomati, karta e kredisë të lejon të paguash edhe jashtë Italisë (apo të blesh nëpërmjet Internetit); pranohet në shumë dyqane, hotele, restorante, shpërndarës benzine, posta, etj. Disa banka kërkojnë garanci të tjera, si për shembull vjetërsinë e raportit të punës dhe derdhjen automatike të rrogës në llogarinë tënde bankare apo derdhjen automatike të një të ardhure tjetër (p.sh. pensionin).

Çfarë është dërgimi i të hollave nëpërmjet bankës (bonifico bancario)?

Është sistemi i dërgimit të parave nga njëra bankë në tjetrën. Kostoja e transaksionit është e ndryshme nga njëra bankë në tjetrën.

Mund të dërgoj të holla në vendin tim?

Po, ky është njëri prej shërbimeve që mund t'a kërkojë pranë bankës tënde. Shpenzimet e këtij shërbimi ndryshojnë nga njëra bankë në tjetrën. Ndryshon edhe shuma fikse që kërkon ajo, të cilës, disa banka i shtojnë edhe komisionin: një përqindje e parave që dërgon (ndërmjet 0,5% deri në 2%).



Çfarë dokumentash kërkon banka?

Ndryshojnë nga banka në bankë por zakonisht janë:

- lejeqëndrimi;
- kodi fiskal;
- plotësimi i një formulari në të cilin duhet të përcaktosh të dhënat e tua personale, shumën e parave, emrin e personit që do t'i tërheqë dhe vendin.

Vini re: nëse për të dërguar parà i drejtohesh një agjencie të Money Transfer, kujtohu që duhet të demonstrosh lejen tënde të qëndrimit, përndryshe titullari i agjencisë do t'i komunikojë brenda 12 orëve emrin tënd Policisë, duke lajmëruar për mos paraqitjen e lejes tuaj të qëndrimit.



shërbime
të tjera
shërbime
të tjera

Parathënie

Në këtë seksion do të gjesh informacione të nevojshme mbi kodin fiskal si edhe mbi drejtimin dhe makinat.

Kodi fiskal është një “kod”, i cili identifikon në mënyrë të saktë personat me qëllim pagesën e taksave. Duhet t’ a kërkosh që të mund të punosh si edhe të përfitosh nga disa shërbime të rëndësishme.

Në seksionin mbi drejtimin dhe makinat do të gjesh informacione të nevojshme mbi ndërrimin e patentës së huaj në patentë italjane si edhe disa tregues ligjorë mbi qarkullimin e makinave në Itali.

Kodi fiskal

Çfarë është kodi fiskal?

Kodi fiskal përmban të dhënat personale: emër, mbiemër, data dhe vendlindja e personit. Lëshohet pa pagesë nga Zyra e Taksave (Ufficio delle Imposte dirette) dhe i shërben Ministrisë së Financave për të identifikuar personat për qëllime fiskale.

Vini re: Qytetarët e huaj, të cilët hyjnë në Itali për motive pune, e tërheqin kodin fiskal pranë autoriteteve konsullore në momentin e marrjes së vizës së hyrjes.

Si të veprojmë për t’ a marrë?

Duhet të kesh lejeqëndrim të vlefshëm; Nëse leja e qëndrimit është në fazë rinovimi, mund të paraqitet leja e skaduar sebashku me ricevuten e kërkesës së rinovimit (e leshuar nga Kuestura ose nga Posta):

- fotokopje të pashaportës;
- dokument identiteti të vlefshëm.

Me këto dokumenta duhet të shkosh në Zyrën e Taksave (të Ministrisë së Financave). Duhet të plotësosh një formular dhe librezë do të të mbërrijë direkt në shtëpinë tënde.

Për të sapolindurit mjafton çertifikata e lindjes ose autoçertifikata nga prindi.



Për çfarë më shërben kodi fiskal?

- Për t'u regjistruar në Shërbimin Shëndetësor Kombëtar;
- për të punuar në punë të varur;
- për të ushtruar një aktivitet pune të pavarur;
- për të nënshkruar kontrata të ndryshme;
- për të hapur llogari bankare.

Në rast se më humb?

Mund të kërkosht një tjetër pranë Zyrës së Taksave.

Përndryshe mund t'a kërkosht:

- në njërin prej videoterminaleve self-service të Agjensisë;
- në faqen Internet www.agenziaentrate.it (Shko tek Servizi, zgjidh atje Duplicato Codice Fiscale dhe plotëso hapsirat me të dhënat e tua).

Mbas pak ditësh libreza e re do të të mbërijë në shtëpi me postë prioritare.

Vini re: Në rast se ndërton rezidencë, duhet të shkosh pranë Zyrës dhe të komunikosh të dhënat e reja, me një dokument identifikimi ku shkruhet rezidenca e re ose mund të nënshkruash një autoçertifikatë.

Drejtimi dhe makinat

Mund të drejtoj makinën në Itali me patentën time?

Në rast se patenta të është lëshuar nga njëri prej vendeve jokomunitare, mund t'i japësh makinës gjatë gjithë vitit të parë të rezidencës në Itali.

Në rast se patenta është e shkruajtur vetëm në gjuhë të huaj, duhet të shoqërohet nga një përkthim zyrtar në gjuhën italyane ose nga një dokument i barasvlefshëm me të. Në skadim të vitit të parë të rezidencës në Itali është e nevojshme të kërkosht konvertimin në patentë italyane, pasi leja juaj e drejtimit të makinës, nuk vlen më për të udhëtuar në Itali. Të drejtosh makinën pa bërë konvertimin vlen si krim për drejtim makine pa patentë. Për patentat e lëshuara nga vende komunitare mund të kërkosht menjëherë konvertimin ose njohjen e vlefshmërisë të patentës. Konvertimi parashikon që të të jepet një patentë italyane për të zëvendësuar tjetrën. Në rastin e njohjes së patentës të vlefshme do të të japin një leje që duhet t'a ngjisësh mbi patentën tënde.

Vini re: Patena e makinës të cilën i huaji e ka marrë në Itali nuk përbën dokument identifikimi, për këtë arsye duhet të shoqërohet gjithmonë me lejeqëndrimin dhe pasaportën.



Sa kohë është e vlefshme patenta italiane?

Patenta italiane është e vlefshme:

- 10 vjet për personat ndërmjet 18 vjeç dhe 50 vjeç;
- 5 vjet për personat më të mëdhenj se 50 vjeç;
- 3 vjet për personat më të mëdhenj se 70 vjeç.

Vini re: Patentën duhet ta mbash gjithmonë me vete kur drejton makinën: policia ka të drejtë të të sekuestrojë makinën në rast se ti e drejton atë pa patentë.

Duhet të bëj provime për të konvertuar patentën e huaj në atë italjane?

Në rast se jeton në Itali dhe je i pajisur me patentë nga një vend komunitar ose jokomunitar me të cilin Italia ka kryer marrëveshje për këtë argument mund të marrësh një patentë italjane të barasvlefshme pa dhënë provime plotësuese. Për të marrë vesh në se duhet të japësh provime plotësuese mund të drejtohesh në Motorizzazione Civile të qytetit kryesor të provincës ku banon.

Ku mund t'a bëj kërkesën për konvertimin dhe/ose njohjen e patentës së huaj?

Kërkesa për konvertimin dhe/ose njohjen e patentës së huaj bëhet pranë Zyrave periferike në Departamentin e transporteve tokësore) në Ministrinë e Infrastrukturave dhe të Transporteve, brenda një viti nga data e rezidences.

Çfarë dokumentash duhet të paraqes për konvertimin dhe/ose njohjen e patentës së huaj?

- Pashaportë;
- lejeqëndrimi;
- një dokument identifikimi italian (carta di identità);
- origjinalin e patentës së huaj, të vlefshme, së bashku me fotokopjen (të përkthyer dhe të shoqëruar nga një deklaratë konsulllore, e detyrueshme për patentat mbi B-në, me firmë të ligjëruar në Prefekturë);
- çertifikatë residence (mund të bëhet autoçertifikim);
- 1 çertifikatë mjeksore me fotografi dhe me një pullë (vizitën mjeksore mund t'a kryesh pranë ASL-it, ose pranë shkollës - scuola guida) e lëshuar jo më vonë se 6 muaj nga data e kërkesës;
- autoçertifikim që nuk ke dënime penale;
- 2 fotografi në format të posaçëm (si në librezë) me sfond të qartë dhe me kokë zbuluar, të stampuara në letër jotermike.



Si të veproj në se nuk kam patentë ose patenta ime nuk njihet?

Për t'u pajisur me patentë duhet të drejtohesh në Zyrat e Motorizzazione Civile ose të rregjistrohesh në një shkollë (Scuola Guida) ku mund të japësh provimet e teorisë dhe të praktikës. Për t'u rregjistruar në shkollë është e nevojshme:

- pasaporta;
- lejeqëndrimi;
- çertifikata e rezidencës;
- 1 fotografi.

Si mund të veproj për të bërë një kopje të re të patentës time?

Nëse patentën e humbet, e dëmton ose t'a vjedhin, brenda 2 ditësh nga momenti i konstatimit, duhet të denoncosh faktin në polici, të plotësosh një formular dhe të lësh një fotografi. Policia do të të lëshojë një leje të përkohshme me të cilën mund të qarkullosh për 90 ditë. Nga momenti i lëshimit të lejes së përkohshme patenta jote, edhe në rast se e gjen, nuk është më e vlefshme.

Mund të drejtoj makinën time në Itali?

Sipas ligjit italian, makinat e rregjistruara jashtë shtetit mund të qarkullojnë në Itali për një vit, në se kanë targa të përkohshme. Në se je resident në Itali (e detyrueshme për personat që qëndrojnë për më shumë se 1 vit), duhet t'i vësh targa të reja makinës dhe t'a rregjistrosh atë në Rregjistrin Automobilistik Publik.

Mund të blej makinë në rast se stabilizohem në Itali?

Për të blerë makinë, një i huaj, ose një qytetar i BE-së, duhet të jetë i pajisur me dokumentat e mëposhtëm:

- kodi fiskal;
- lejeqëndrim;
- çertifikatë residence.

Duhet të bëj sigurim për makinën në Itali?

Sigurimi i makinës është i detyrueshëm kur:

- je rezident në Itali dhe ke sjell makinën tënde nga vendi i origjinës në Itali;
- je rezident në Itali dhe ke blerë makinën në Itali.

Për sigurimin e makinës mund të drejtohesh në një Agjensi Sigurimesh.



shoqatat
shoqatat

E drejta për t'u bashkuar në një shoqatë

Liria e shoqërizimit është e mbrojtur me ligj në Itali. Krijimi i grupeve dhe shoqatave është i mundur të bëhet për ato raste që nuk ndalohen nga ligji, dhe në mënyrë të veçantë mundet:

- të krijohet një grupim;
- të merret pjesë në një grupim;
- mos të merret pjesë në një grupim.

Si të themelosh një shoqatë

Cfarë aktivitete mund të zhvillojë një shoqatë?

Çdo lloj aktiviteti i cili nuk ndalohet me ligj.

A promovohen shoqatat?

Shoqatat promovohen kur favorizojnë integrimin e të huajve në jetën e komunitetit lokal: për këtë është krijuar edhe Rregjistri Kombëtar i Shoqatave në Ministrinë e Punës, të Shëndetsisë dhe të Politikave Sociale – Drejtoria e Përgjithshme e Imigracionit.

Cilat janë kushtet që duhen plotësuar për regjistrimin në këtë regjistër?

Mund të regjistrohen të gjitha shoqatat që veprojnë në territorin kombëtar: ato që zhvillojnë aktivitete në të paktën 5 rajone dhe 20 provinca italiane.

Si mund të krijohet një shoqatë?

Krijohet nga një grup personash që kanë të përbashkët një qëllim shoqëror, kulturor, asistencial, ambjentalist etj.

Vini re: Nuk ka një numër të caktuar për personat që mund të formojnë një shoqatë, madje edhe dy vetë mund t'a bëjnë këtë. Aktivitetet tregtare janë të rregulluara me ligj.

Cilët janë elementët e nevojshëm për të krijuar një shoqatë?

Çdo grup vendos rregulla të caktuara për të disiplinuar aktivitetin. Një sho-



qatë mund të krijohet në formën e saj me shkrim ose gojore. Marrëveshja gojore nuk mund të regjistrohet në Regjistrin e Shoqatave, nuk mund të kryejë aktivitete me pagesë, nuk mund të përfitojë nga fondet publike ose private, nuk mund të rregjistrohet në rregjistrat e Organizatave Vullnetare, etj. Në të kundërt, në rast se Shoqata themelohet mbi bazën e një akti të shkruar, mund të përfitojë nga lehtësime fiskale.

Si mund të krijohet një shoqatë në formë të shkruar?

Duhet shkruar nje Kontratë për Grupim. Kontrata ndahet në 2 dokumenta që konsiderohen një akt i vetëm dhe janë:

- statuti;
- akti i themelimit.

Çfarë është statuti?

Është dokumenti qe rregullon jetën e shoqatës duke përcaktuar arsyen shoqërore, rregullat e krijimit të organeve të saj, të zgjedhjes së presidentit, të funksionimit të asamblesë së ortakëve, përpilimin e buxhetit, etj.

Çfarë është akti i themelimit?

Është dokumenti që vërteton lindjen e shoqatës dhe jep “gjeneralitetet e saj” duke shënuar adresën, ortakët themelues, datën e krijimit të saj. Duhet të jetë i firmosur nga ortakët themelues, të cilët deklarojnë që grupohen për të ndjekur një qëllim të ligjshëm.

Çfarë duhet të shkruhet në statut?

- Emri dhe adresa e shoqatës;
- të shënohet në se ka ose jo qëllime fitimi;
- objekti social (natyrë e ndihmës reciproke apo solidariteti);
- kushtet për pranimin e ortakëve;
- rregullat e sjelljes së ortakëve;
- pasuria dhe të ardhurat;
- organet e shoqatës (keshilli drejtues, asambleja);
- normat e funksionimit të organeve të shoqatës (në veçanti ato të keshillit drejtues dhe asamblesë, modalitetet e thirrjes së mbledhjeve, vendim-marrja etj);



- kohëzgjatja e ushtrimit të aktivitetit dhe raportet financiare të tyre;
- modalitetet e prishjes së shoqatës.

Kur bëhet fjalë për akt publik dhe kur për akt privat?

Në se dokumenti bëhet nën mbikqyrjen e një noteri dhe nga ky rregjistrohet në Zyrën e Rregjistrimit, quhet akt publik; në se formulohet nga ortakët quhet akt privat, i cili mund të rregjistrohet nga noteri ose jo.

Cila është diferenca midis rregjistrimit publik dhe krijimit privat të shoqatës?

Diferenca qëndron në faktin se vetëm nëpërmjet një akti publik mund të kërkohet njohja e shoqatës dhe ajo të kthehet në një person juridik.

Çfarë janë shoqatat e njohura?

Ato që kanë një “dekret” njohjeje, i cili është një akt i Shtetit me anë të të së cilit shoqatës i jepet autonomia ekonomike dhe pasurore. Kjo do të thotë që shoqata përgjigjet dhe merr vetë përsipër përgjegjësitë ndaj ligjit e për pasojë kthehet në një person juridik.

Çfarë janë shoqatat e pa njohura?

Janë ato që nuk gëzojnë autonomi të pasurisë para ligjit; do të thotë që në se pasuria e shoqatës nuk është e mjaftueshme për të përmbushur detyrimet e marra, diferencën e paguajnë me pasurinë e tyre, ortakët që bëjnë pjesë në shoqatë.

Cila është praktika për njohjen e shoqatës?

Të interesuarit duhet të paraqesin në prefekturën e provincës ku ndodhet shoqata, një kërkesë nga themeluesi i saj së bashku me aktin themelues të shoqatës.

Konsistenca e pasurisë duhet të tregohet nga dokumentat që i bashkëlidhen kërkesës.

Sa kohë duhet për të bërë njohjen e një shoqate?

Autoriteti qeveritar ka një kohë të caktuar prej 120 ditësh për të vendosur në se një shoqatë do të jetë ose jo e shkruar në zyrën e rregjistrimit. Kjo kohë



mund të shkojë deri në 180 ditë në se Prefektura kërkon dokumenta të tjerë ose kur mungojnë dokumentat që duhen.

Çfarë mund të bëhet në se një shoqatë nuk njihet?

Në se nuk pranohet rregjistrimi i një shoqate atëherë mund të bëhet apel administrativ.

A mund të ketë shoqata një kod fiskal?

Po, në se krijohet një shoqatë, duhet kërkuar pranë Zyrës së taksave hapja e një kodi fiskal.

Për çfarë shërben kodi fiskal?

Kodi fiskal shërben për:

- të blerë mallra me faturë;
- të vënë në emër të shoqates pasuri të patundshme;
- të bërë kontrata qeraje;
- të kërkuar kontribute ose shpenzime pranë institucioneve;
- të paguar shpërblime.

Disa lloje shoqatash

Çfarë janë shoqatat për promovimin social?

Janë shoqata që ndërmarrin aktivitete të vlefshme shoqërore në favor të anëtareve të saj ose të komunitetit.

Cilat aktivitete konsiderohen “të vlefshme shoqërisht”?

Bamirësia, promovimi i kulturës, artit, mbrojtja dhe vlerësimi i ambientit, shkollimi dhe formimi, sporti amator, mbrojtja e të drejtave civile etj. Këto shoqata rregullohen sipas ligjit 383/00.

Çfarë janë organizatat vullnetariatit?

Ligji përcakton si aktivitet vullnetariati ato që nuk kanë qëllime fitimi por që i shërbejnë solidaritetit.

Organizatat e vullnetariatit mund të marrin çfarëdo forme juridike në për-



puthje me qëllimin e tyre shoqëror.

Bazohen tek puna vullnetare megjithëse mund të mbajnë edhe ndonjë punonjës me rrogë nëse kanë nevojë.

Keto organizata rregullohen sipas ligjit 266/91.

Çfarë janë Organizatat jo Qeveritare (OJQ)?

Vepronë në fushën e bashkëpunimit me vendet në zhvillim. OJQ-të, sipas ligjit, mund të marrin çdo lloj forme juridike (shoqatë ose fondacion) porse duhet të kërkojnë njohjen nga ana e Ministrisë së Jashtme për të vepruar në projekte zhvillimi të financuar nga fonde publike.

Keto organizata rregullohen sipas ligjit 49/87.

Çfarë do të thotë Organizatë jo fitim prurëse më rëndësi shoqërore (Onlus)?

ONLUS ka një status fiskal të caktuar. Rregjimi Onlus i aplikohet organizatave vullnetare të regjistruara pranë regjistrave krahinorë ose kooperativave sociale.

Çfarë do të thotë Organizatë NO Profit?

No profit (ose pa fitim) është një organizatë në brendësi të së cilës fitimet nuk mund të ndahen me ortakët por duhet të investohen në aktivitet ose t'u dhurohen atyre që kanë nevojë dhe që janë shënuar në Statutin e organizatës.



Finito di stampare nel mese di settembre 2009
dalla tipolitografia CSR
Via di Pietralata, 157 - 00158 Roma
Tel. 064182113 (r.a.) - Fax 064506671